



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 377 Akti

Nr. 512 Vendimi
Tiranë, më 25.2.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Lulzim Hamitaj	Kryesues
Genta Tafa (Bungo)	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Etmonda Hoxha, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, në datën 23.2.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Shpëtim Reka**, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2015, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Genta Tafa (Bungo), vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Subjekti i rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, aktualisht me funksionin gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, është subjekt i rivlerësimit që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) ka hedhur shortin në datën 16.12.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Alma Faskaj dhe Lulzim Hamitaj. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionerja Genta Tafa (Bungo).
4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 19.12.2019 u caktua me mirëkuptim kryesues z. Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Shpëtim Reka.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt të vlerësimit deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Këto raporte janë administruar nga relatori me fillimin e hetimit administrativ.

10. Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektoratit i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin¹ e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Reka. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues të plotë për të ardhurat;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

11. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin² e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Reka.

12. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport³ të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

13. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: të vlerësimit të pasurisë; të kontrollit të figurës; dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.

14. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 7.2.2022, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit, z. Shpëtim Reka; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit , të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit, po në të njëjtën datë, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë, apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 10.2.2022, ndërsa më 21.2.2022 ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe provave të reja në përgjigje të rezultateve të hetimit.

¹ Me shkresën nr. *** prot., datë 4.2.2019.

² Raporti nr. *** prot., datë 30.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. *** , datë 26.5.2021, të KDZH-së.

³ Me shkresën nr. *** prot., datë 13.10.2021.

16. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore⁴.

II. SEANCA DËGJIMORE

17. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *e-mail*, në datën 21.2.2022.

18. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 23.2.2022, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin.

19. Subjekti i rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Z. Shpëtim Reka ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

20.1. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1. Referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

22. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI me “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c)

⁴ Vendimi i ndërmjetëm nr. 3, datë 21.2.2022.

⁵ “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i papabuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

“Deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

A. VLERËSIMI I PASURISË

23. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI në datën 23.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

24. Apartament⁶ me sip. 70.7 m², ndodhur në rrugën “M.Gj”, Tiranë

24.1. Vlera e deklaruar: 900,000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Subjekti ka deklaruar se e ka fituar këtë pasuri në vitin 2000, dhuruar bashkëshortes F.R nga babai J.A dhe pjesërisht e blerë (përafërsisht 10-12 m).

24.2. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kjo pasuri rrjedh nga ndërtimi mbi truallin e trashëguar dhe kthyer me vendimin nr. **, datë 30.06.1995, të Komisionit të Kthimit të Pronave, shtetasit J.A dhe trashëgimtarëve të tij. Veprimi juridik është pasqyruar në kontratën e shitjes nr. ***, datë 23.6.2000, ndërmjet shtetasit I.A (vëllai i bashkëshortes) dhe blerëses F.R. Vlera e shpenzuar prej subjektit ka qenë 500,000 lekë. Dhurimi i pjesës së apartamentit në natyrë është i padokumentuar, pasi për efekt të dokumentacionit i është bërë z. I.A me kontratën nr. ***, datë 19.1.1998. Kjo pasuri është dhënë si ambient me qira për zyra tek subjekte të ndryshme.

Konstatimi i ILDKPKI-së

24.3. Nuk është e qartë mënyra e ndërtimit të objektit në të cilin shtetasi I.A ka përfituar pasuritë e regjistruara në hipotekë, ku një nga pasuritë është apartamenti i përfituar nga shtetasja F.R. Kontrata e shitjes është për apartamentin me sip. 70.7 m², me vlerë 900,000 lekë, ndërsa subjekti ka deklaruar si shpenzim vlerën 500,000 lekë. Nuk është e qartë diferenca e shumave të deklaruara. Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor (kontrata qiraje) për shtator 2001 dhe periudhën 2008 – shkurt 2012.

⁶ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 12.11.2012, me nr. pasurie ***; (ii) kartelë pasurie në pronësi të shtetasës F.R; (iii) vendim nr. **, datë 30.6.1995, të KKK Pronave; (iv) vërtetim pronësie, datë 19.1.1998, sipas të cilit në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 4.11.1996, në pronësi të shtetasve J. A dhe P.A figurojnë të regjistruar dy troje të lirë me sip. 288 m², secili ku shtetasi J.A zotëron ¼ pjesë; (v) kontratë dhurimi datë 19.1.1998, me palë dhuruese J.A dhe palë pranuese e dhurimit I.A; (vi) vërtetim hipotekor nr. ***, datë 23.6.2000, për garazh me sip. 267 m², ambient shërbimi në katin përdhe, apartament me sip. 70.7 m², me adresë: rr. “M.Gj”, Tiranë, në pronësi të shtetasit I.A; (vii) kontratë shitjeje datë 23.6.2000, me palë shitëse I. A dhe palë blerëse F.R, për pasuritë garazh me sip. 267 m², ambient shërbimi në katin përdhe, apartament me sip. 70.7 m², me adresë: rr. “M.Gj”, Tiranë, i shet këtë të fundit palës blerëse kundrejt çmimit 900,000 lekë.

Hetimi⁷ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

24.4. Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 23.6.2000, bashkëshortja e subjektit ka blerë nga vëllai i saj I.A apartamentin me sip. 70.7 m², ndodhur në rrugën “M.Gj”, Tiranë, me vlerë 900,000 lekë. Bazuar në kartelën e pasurisë në ASHK, apartamenti është i regjistruar në pronësi të bashkëshortes së subjektit, F.R, me nr. pasurie ***, zona kadastrale ***.

24.5. Subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën *Vetting* burimin e përdorur për pjesën e blerë nga ana e saj të apartamentit. Në DVP/2003, si burim për këtë pasuri subjekti ka deklaruar të ardhurat e punës së tij dhe të bashkëshortes.

24.6. Bazuar në dokumentacionin e administruar nga ASHK-ja ka rezultuar se ky apartament ndodhet në objektin e ndërtuar nga shoqëria “M.I” sh.p.k., me përfaqësues ligjor z. I.A, mbi bazën e lejes së ndërtimit nr. ***, datë 29.6.1998, miratuar nga Bashkia Tiranë.

Përmes kontratës së porosisë të datës 28.2.1998, të lidhur me sipërmarrësin Sh.B, shtetasi I. A ka përfituar 17% të apartamenteve të objektit. Nga apartamentet e përfituara ka tjetërsuar në favor të motrës së tij apartamentin me sip. 70.7m², me nr. pasurie ***, z. k. ***.

24.7. Në lidhje me mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie dhe çmimin e saj, në përgjigje të pyetësorit nr. 1 subjekti ka sqaruar se: *“Kjo pasuri rrjedh nga ndërtimi mbi truallin e trashëguar prej bashkëshortes, nga gjyshja e saj dhe kthyer me vendim të Komisionit të Kthimit të Pronave, nr. **, datë 30.6.1995. Këtë truall babai i bashkëshortes ia ka dhuruar djalit I. J.A, me kontratën nr. *** rep., nr. ** kol., datë 19 janar 1998. Që në fillim të veprimeve për dhurimin e truallit dhe përpilimin e dokumentacionit ligjor për kryerjen më pas të ndërtimit, babai i bashkëshortes kishte shfaqur dëshirën që në rast se do realizohej ndërtimi, bashkëshortja do të merrte ¼ e pjesës së tij si banesë. Me mbarimin e ndërtimit është realizuar kontrata e shkëmbimit të truallit në pronësi të ish-pronarëve me ambientet e ndërtuara mbi këtë truall prej sipërmarrësit. Pas regjistrimit përkatës në ZRPP, është realizuar edhe kontrata e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 23.6.2000, ndërmjet shitësit I.A dhe bashkëshortes F. R, si blerëse. Sqaroj se ndonëse kontrata e shitjes është realizuar për apartamentin me sipërfaqe 70.7 m², shuma prej 500,000 (pesëqind mijë) lekësh, e shpenzuar prej meje dhe bashkëshortes për këtë apartament, përfaqëson vetëm vlerën e sipërfaqes prej 10-12 metër që bashkëshortja ka marrë më shumë se sa sipërfaqja e dhuruar nga babai. Pjesa e sipërfaqes që është dhuruar nga babai i bashkëshortes, në prani edhe të vëllait të saj, është e padokumentuar me shkrim, për shkak të marrëdhënies së afërt familjare ndërmjet tyre. Me realizimin e kontratës së shkëmbimit, interesi ynë i përbashkët ishte të përcaktonim si do të bëhej kalimi i pronësisë nga shtetasi I.A tek bashkëshortja dhe për të gjetur mënyrën më të shkurtër dhe më të njohur për të regjistruar pronën në emër të F.R, sikurse ishte edhe dëshira e babait të saj. Për këtë shkak është përpiluar me vullnet të palëve kontrata e shitjes, e cila pasqyron çmimin e apartamentit prej 900,000 lekësh. Vlera e shënuar në kontratë, mesa kujtojmë, ka qenë vlera e përafërt e çmimeve të tregut të apartamenteve në kohën e ndërtimit të këtij objekti. E përfshirë në këtë çmim është edhe shuma prej 500,000 lekësh, të cilën bashkëshortja F i kishte paguar vëllait I.A përpara përpilimit të kontratës, pasi, sikurse u shpjegua, sipërfaqja e apartamentit që ajo ka marrë ishte rreth 10-12 m² më e madhe se sa pjesa që babai kishte mundësi t'i dhuronte”.*

24.8. Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së tij deklaratën noteriale nr. ***, datë 9.3.2020, përmes së cilës shtetasi I.A deklaroi se apartamentin me sip. 70.7 m² e ka kaluar në favor të motrës së tij, duke përmbushur kështu vullnetin e babait, si dhe ka realizuar shitjen e sip. 10-12 m² të këtij apartamentit në favor të motrës së tij F.R.

⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 17.1.2020, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 24.2.2020, e ASHK-së, Tiranë Rurale 2; shkresë nr. *** prot., datë 19.4.2018, e ZQRPP-së, drejtuar ILDKPKI-së.

24.9. Komisioni kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë e subjektit për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 70.7 m² në vitin 2000, pasqyruar në tabelën vijuese:

Tabela nr. 1

	Datë 23.6.2000
Pasuri	-1,311,361.10
Ap 1+1 me sip. 70.7 m ²	900,000.00
<i>Shtesa/pakësime/likuiditete kumulative</i>	<i>-2,211,361.10</i>
Detyrime	0.00
Pasuri neto	-1,311,361.10
Të ardhura	429,396.50
Të ardhurat nga puna e subjektit	213,671.50
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	215,725.00
Shpenzime	216,000.00
Shpenzime jetike	216,000.00
Mundësia për kursime	1,524,757.60

Nga analiza financiare rezulton se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e pasurisë apartament.

24.10. Në përfundim të hetimit për këtë pasuri, Komisioni konstatoi se subjekti nuk ka dokumentuar saktë mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie. Deklarimet e subjektit nuk përputhen me përmbajtjen e kontratës së shitjes, e cila ka shërbyer si akt për përfitimin dhe regjistrimin e pasurisë së paluajtshme. Vlera prej 500,000 lekësh, e deklaruar në deklaratën *Vetting* si shpenzim për përfitimin e kësaj pasurie, nuk përputhet me vlerën e deklaruar në DVP/2003 dhe me përmbajtjen e kontratës së shitblerjes së pasurisë në të cilën pasqyrohet vlera 900,000 lekë.

Në lidhje me këto konstatime, subjektit, me dërgimin e rezultateve të hetimit, iu kërkuan shpjegime.

24.11. Në parashtrimet e tij subjekti u ka qëndruar shpjegimeve dhe provave të paraqitura më parë pranë Komisionit gjatë hetimit administrativ. Ai ka sqaruar se vlera prej 900,000 lekësh tregon vlerën e pasurisë në kohën e blerjes, ndërsa vlera prej 500,000 lekësh tregon vlerën e paguar nga bashkëshortja. Sipas subjektit, të dyja këto shifra janë të vërteta që tregojnë dy variabla të ndryshme. Mospërputhja do të ekzistonte vetëm nëse këto dy shifra do t'i referoheshin të njëjtit tregues.

24.12. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe provat e paraqitura prej tij, vlerëson se pavarësisht se ato mund të konsiderohen bindëse për shkak të marrëdhënies së posaçme mes bashkëshortes së subjektit, në cilësinë e blerësit, dhe shtetasit I.A, në cilësinë e shitësit, këto shpjegime nuk janë të provuara me dokumentacion dhe mbeten në nivel deklarativ.

24.13. Komisioni çmon se subjekti nuk ka pasqyruar saktësisht mënyrën e përfitimit të kësaj pasurie dhe çmimin e blerjes së saj, duke e vlerësuar këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

25. Truall⁸ me sip. 500 m², me vlerë 200,000 lekë, në fshatin V, Bashkia Himarë. Pjesa takuese 50%.

25.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: pasuri e blerë nga bashkëshortja dhe vëllai i saj D. A, në bashkëpronësi, e blerë në datën 5.8.2002, në vlerën 200,000 lekë nga Bashkia Himarë, me

⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) kontratë shitjeje trualli, datë 5.8.2002, me palë shitëse Bashkia Himarë dhe palë blerëse D.A dhe F.A (R), për blerje trualli me sip. 500 m² në V, me vlerë 200,000 lekë; (ii) mandatarkëtimi datë 5.8.2002, sipas së cilit shtetasit D dhe F.A arkëtojnë shumën 200,000 lekë.

kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol. Shpenzimet e kryera prej subjektit janë në vlerën 100,000 lekë. Shuma e shpenzuar është krijuar nga të ardhurat familjare. Kjo pasuri mbetet ende e paregjistruar në regjistrat e ZRPP-së Vlorë dhe e pashfrytëzuar.

Hetimi⁹ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

25.2. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit, bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, kontratën e shitjes nr. ***, datë 5.8.2002, nëpërmjet së cilës bashkëshortja e tij, së bashku me të vëllanë, kanë blerë nga Bashkia Himarë truallin me sip. 500 m², ndodhur në V, me vlerë 200,000 lekë dhe kanë përfituar përkatësisht ½ pjesë të kësaj pasurie. Pagesa e çmimit të blerjes provohet me mandatarkëtimin nr. **, datë 5.8.2002, sipas së cilit shtetasit D dhe F.A kanë paguar shumën 200,000 lekë në favor të Bashkisë Himarë.

Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri në DVP/2003, me përshkrimin “tokë me sip. 250 m², në vijën e verdhë të fshatit V, me vlerë 100,000 lekë, blerë nga seksioni i financës i Bashkisë Himarë dhe burim krijimi të ardhurat e punës së tij dhe të bashkëshortes”.

25.3. Bazuar në përcaktimet e kontratës së shitjes, rezulton se blerësi, në bazë të vendimit nr. **, datë 8.1.2002, të KRRT-së së Prefekturës Vlorë dhe vendimit nr. ***, datë 29.3.2002, të Bashkisë Himarë ka të drejtë të ndërtojë një ambient dykatësh në këtë truall. Bashkëlidhur kontratës gjendet planimetria e sheshit të ndërtimit për objektin “shtëpi banimi” me sip. 120m², miratuar me vendimin nr. ***, datë 29.3.2002, të Këshillit Bashkiak.

25.4. ASHK-ja Vlorë nuk konfirmon pronësinë e kësaj pasurie në favor të bashkëshortes së subjektit dhe vëllait të saj. Në shpjegimet e dhëna nga subjekti dhe bashkëshortja e tij në ILDKPKI në datën 15.4.2015, në lidhje me këtë pasuri, ato kanë deklaruar se kjo pronë nuk është regjistruar prandaj nuk disponojnë certifikatë pronësie. Kjo tokë është blerë në vitin 2002 në vlerën 200,000 lekë dhe sipërfaqja e saj është 500 m². Pala tjetër blerëse është vëllai i bashkëshortes D.A. Subjekti dhe bashkëshortja kanë deklaruar pjesën e tyre takuese, e cila është me sip. 250 m² dhe vlera e paguar prej tyre është 100,000 lekë.

25.5. Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka deklaruar se: “Kjo pasuri mbetet ende e paregjistruar në regjistrat e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe e pashfrytëzuar. Nuk kanë kërkuar dhe nuk janë pajisur asnjëherë me leje ndërtimi për shtëpi banimi. Trualli mbetet në të njëjtën gjendje që ka qenë në momentin e blerjes së tij nga Bashkia e Himarës...”. Subjekti ka paraqitur foto të pasurisë, nga të cilat evidentohet se në këtë truall nuk ka asnjë ndërtim, sipas përshkrimit dhe deklarimit të tij.

25.6. Komisioni kreu analizën financiare në lidhje me aftësinë financiare të subjektit për blerjen në vitin 2002 të pjesës takuese prej 50%, të truallit me sipërfaqe totale 500 m².

Tabela nr. 2

	Datë 5.8.2002
Pasuri	375,961.32
Truall me sip. 500 m ² në fshatin V	100,000.00
Shtesa/pakësime/likuiditete	275,961.32
Detyrime	-
Pasuri neto	375,961.32
Të ardhura	679,877.89
Të ardhurat nga puna e subjektit	275,228.92
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	303,424.33

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2021, drejtuar Bashkisë Himarë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.10.2021, e Bashkisë Himarë; shkresë nr. *** prot., datë 4.2.2020, drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.2.2020, e ASHK-së Vlorë.

Të ardhura nga qiratë	101,224.64
Shpenzime	250,384.00
Shpenzime jetike	250,384.00
TIMS	-
Mundësia për kursime	53,532.57

25.7. Nga analiza financiare më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pjesës takuese të pasurisë truall në vlerën 100,000 lekë.

25.8. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

26. Apartament¹⁰ 3+1, me sip. 146.5 m², ndodhur në Lagjen nr. *, rruga “E.V” (sot rruga “P. E”), kati **, Durrës, me vlerë 70,000 euro. Pjesa takuese: 100%.

26.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: të ardhurat për këtë pasuri janë siguruar nga kredia e marrë në BKT në shumën 31,000 euro, me kontratë kredie bankare datë 17.12.2004, me kredimarrës F.R dhe dorëzanës Shpëtim Reka. Shlyerja e kësaj kredie ka përfunduar në vitin 2015. Të ardhurat për këtë apartament janë siguruar gjithashtu nga shitja e banesës së mëparshme (e blerë nga privatizimi në vitin 1993) me vendndodhje në Lagjen nr. *, Durrës. Çmimi i shitjes së këtij apartamenti është 3,300,000 lekë. Pjesa tjetër e vlerës së apartamentit është siguruar nga të ardhurat nga paga dhe nga qiraja e apartamentit 1+1, me sip. 70.7m², në rrugën “M.Gj”.

Hetimi¹¹ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

26.2. Subjekti dhe bashkëshortja e tij, me kontratën e shitjes me rezervë nr. ***, datë 20.5.2004, kanë blerë nga shoqëria “I.K” sh.p.k., apartamentin me sip. 160 m², ndodhur në rrugën “E.V”, Durrës, me vlerë 70,000 euro.

Sipas nenit 7 të kësaj kontrate, pagesa e çmimit të apartamentit do të kryhej si vijon:

- kësti i parë në vlerën 10,000 euro do të likuidohet në momentin e lidhjes së kontratës;

¹⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 9.11.2012, për apartamentin me nr. pasurie ***/Nd+1-47; (ii) kontratë shitjeje datë 18.11.2011, me palë shitëse “I.K” sh.p.k. dhe palë blerëse Shpëtim e F.R; (iii) vërtetim nga dokumenti hipotekor, datë 29.6.2007, për apartamentin me sip. 146.5 m², në pronësi të shoqërisë “I.K” sh.p.k.; (iv) mandatarkëtimi nr. **, datë 22.5.2004, arkëtuar nga z. Shpëtim Reka për shoqërinë “I.K” sh.p.k., shuma 10,000 euro; (v) mandatarkëtimi nr. **, datë 3.11.2004, arkëtuar nga z. Shpëtim Reka, për shoqërinë “I.K” sh.p.k., shuma 10,000 euro; (vi) mandatarkëtimi nr. **, datë 15.1.2005, arkëtuar nga z. Shpëtim Reka për shoqërinë “I.K” sh.p.k., shuma 25,000 euro; (vii) mandatarkëtimi nr. **, datë 19.8.2005, arkëtuar nga z. Shpëtim Reka për shoqërinë “I.K” sh.p.k., shuma 10,000 euro; (viii) mandatarkëtimi nr. ***, datë 20.12.2005, arkëtuar nga z. Shpëtim Reka për shoqërinë “I.K” sh.p.k., shuma 5,000 euro; (ix) mandatarkëtimi nr. ***, datë 1.6.2006, arkëtuar nga z. Shpëtim Reka për shoqërinë “I.K” sh.p.k., shuma 3,000 euro; (x) mandatarkëtimi nr. *, datë 19.10.2005, arkëtuar nga z. Shpëtim Reka për shoqërinë “I.K” sh.p.k., shuma 20,600 lekë; (xi) kontratë shitjeje me rezervë nr. ***, datë 20.5.2004, për blerje me këste të apartamentit; (xii) planimetri e apartamentit; (xiii) kontratë kredie dhe kontratë hipoteke, datë 17.12.2004, me palë kredidhënëse BKT; (xiv) kontratë shitjeje datë 15.7.2005, me palë shitëse Shpëtim e F.R dhe palë blerëse Sh.R për shitjen e apartamentit me sip. 54.99 m², me vlerë 3,300,000 lekë, e likuiduar totalisht; (xv) vërtetim hipotekor nr. ***, datë 16.8.1993, për apartamentin me sip. 54.99 m² në Durrës; si dhe (xvi) kontratë shitjeje datë 13.8.1993, me palë shitëse Ndërmarrje Komunale Banesa dhe palë blerëse Shpëtim Reka e F.A për blerje apartamenti me sip. 54.99 m².

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2021, drejtuar ASHK-së Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.9.2021, e ASHK-së Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar UKD sh.a.; shkresë kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 23.1.2020, e UKD sh.a.; shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar FSHU sh.a.; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.1.2020, e FSHU sh.a.; shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2021, drejtuar ILDKPKI-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.9.2021, e ILDKPKI-së.

- kësti i dytë në vlerën 35,000 euro do të likuidohet nga blerësi me marrjen e kredisë nga banka;
- kësti i tretë në vlerën 18,000 euro do të likuidohet në maj të vitit 2005;
- kësti i fundit në vlerën 7,000 euro do të likuidohet para dorëzimit efektiv të apartamentit dhe para përfundimit të formaliteteve për kalimin e pronësisë.

Në nenin 5 të kontratës përcaktohet se afati për dorëzimin e apartamentit do të jetë deri në datën 30.6.2005.

26.3. Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 18.11.2011, subjekti dhe bashkëshortja kanë finalizuar blerjen e apartamentit, i cili, sipas kësaj kontrate, rezulton me këto të dhëna: apartament me sip. 146.5 m², me nr. pasurie ***-Nd+*-**, kati **, ap. **.

Në përmbajtje të kontratës përfundimtare të shitjes, palët deklarojnë se çmimi i shitjes së apartamentit në vlerën 70,000 euro është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale dhe se blerësi ka marrë në dorëzim apartamentin. Pala shitëse deklaron se i ka shitur blerësit apartamentin e përshkruar më lart, së bashku me tarracën që ndodhet mbi apartamentin, objekt i kësaj kontrate, dhe dalja në tarracë është realizuar me shkallë të brendshme nga ambienti i apartamentit.

26.4. Subjekti, i pyetur nga Komisioni lidhur me arsyen e mosdeklarimit të tarracës në deklaratën *Vetting* dhe në deklarimet vjetore, ka sqaruar se *tarraca në fjalë është pjesë përbërëse e apartamentit dhe nuk ka asnjë shkak për deklarim të specifikuar të saj. Tarraca është përshkruar qartë në kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.11.2011, shitës shoqëria "I.K", blerës Shpëtim Reka dhe F.R. Në dijeninë e tij, të gjithë banorët e katit të sipërm në pallatin ku banon kanë blerë apartamentin së bashku me tarracën që ndodhet mbi secilin apartament dhe dalja në tarracë është e realizuar me shkallë të brendshme nga ambienti i apartamentit.*

26.5. Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së tij kopje të kontratës së shitjes, datë 28.1.2015, lidhur mes shoqërisë "I.K" sh.p.k. dhe shtetasit H. K., për blerjen e një apartamenti në të njëjtin godinë me subjektin e rivlerësimit, me nr. pasurie ****/Nd+*-**. Në këtë kontratë evidentohet përshkrimi i ngjashëm i të drejtave të blerësit mbi tarracën e ndodhur mbi apartament.

A) Në lidhje me momentin e deklarimit të pasurisë "apartament"

26.6. Gjatë hetimit ka rezultuar se subjekti nuk e ka deklaruar këtë pasuri në vitin e blerjes së saj në DVP/2004, por e ka deklaruar në vitin vijues, në DVP/2005, me përshkrim "blerë një apartament 3+1, ndodhur në Lagjen nr. *, Durrës. Pasuria është ende e paregjistruar".

26.7. Lidhur me këtë fakt, në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021, subjekti ka sqaruar se *nuk ka pasur ndonjë arsye për mosdeklarim të pasurisë apartament në DVP-në e vitit 2004, pasi në atë DVP është deklaruar qartë kredia në shumën 31.000 euro për blerje apartamenti. Apartamenti ka përfunduar dhe është bërë i banueshëm në vitin 2005, kohë në të cilën edhe e është deklaruar imtësisht në DVP-në përkatëse.*

26.8. Në përfundim të hetimit, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës lidhur me mosdeklarimin e blerjes së apartamentit në deklarimin periodik vjetor të vitit 2004.

26.9. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka parashtuar se *është i vërtetë fakti se në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2004 nuk ka deklaruar blerjen e këtij apartamenti, pasi në vitin 2004 ishte lidhur me subjektin ndërtues vetëm kontrata e shitjes me rezervë dhe në këtë moment ai dhe bashkëshortja kishin paguar vetëm 1/3 pjesë të vlerës së apartamentit, për rrjedhojë, sikurse është konceptuar prej tyre në atë kohë, mbështetur edhe në nenet 746-749 të Kodit Civil, nuk e kanë konsideruar se kanë pasur detyrim për deklarim, pasi akoma nuk kishin fituar pronësinë mbi këtë pasuri, duke qenë se pasuria ishte në formën e një sendi të ardhshëm, pronësia mbi të cilin kalon vetëm pasi të materializohet... Apartamenti ka përfunduar dhe është*

bërë i banueshëm në vitin 2005, kohë në të cilën është deklaruar në DV, si nga subjekti ashtu edhe nga bashkëshortja.

26.10. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se bazuar në përcaktimet e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publike” subjekti ka pasur detyrim të deklarojë pasurinë e blerë përmes kontratës së shitblerjes me rezervë, datë 20.5.2004, në deklaratën vjetore të pasurisë të vitit 2004. Në këndvështrim të ligjit të sipërcituar, detyrimi për deklarim nuk lidhet me momentin e kryerjes së pagesave dhe finalizimit të marrëdhënies kontraktore mes subjektit deklarues dhe shitësit të pasurisë së paluajtshme, por me momentin që subjekti deklarues nënshkruan një akt përmes së cilit merr përsipër të drejta dhe detyrime me karakter pasuror.

Për sa i përket pasaktësive në deklaratat periodike, Komisioni, në mbështetje të qëndrimit të mbajtur nga Kolegji në çështje të ngjashme, e cila përbën tashmë jurisprudencë të konsoliduar të tij¹², vlerëson se një deklarim i pasaktë në deklaratimet e mëparshme periodike të interesave nuk mund të konsiderohet se është bërë në kundërshtim me përcaktimin e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë, nuk është element i mjaftueshëm për t’u konsideruar si një shkak i vetëm dhe i veçuar, që prodhon situatën e deklarimit të pamjaftueshëm.

B) Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie

26.11. Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar si burim për blerjen e këtij apartamenti: (i) kredi nga BKT-ja; (ii) të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në Lagjen nr. *, Durrës; (iii) të ardhurat nga qiradhënia e apartamentit me sip. 70.7 m² në Tiranë; si dhe (iv) të ardhurat nga paga.

26.12. Në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në datën 15.4.2015, në lidhje me burimin për blerjen e këtij apartamenti, subjekti ka deklaruar se *kësti i parë për blerjen e apartamentit është likuiduar nga kursimet familjare, ndërsa si burim për likuidimin e pjesës tjetër kanë qenë të ardhurat nga shitja e automjetit, shitja e apartamentit, si dhe kredia në “Alpha Bank”.*

26.13. Komisioni ka konstatuar mospërputhje mes deklarimit të kryer nga subjekti në deklaratën *Vetting* dhe shpjegimeve të dhëna në ILDKPKI lidhur me të ardhurat e ligjshme të cilat kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit.

26.14. Në lidhje me këtë mospërputhje, në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021, subjekti ka sqaruar se *nga ana e tij nuk konstatohet ndonjë ndryshim në deklaratimet e dhëna përpara ILDKPKI-së dhe atyre në deklaratën Vetting, pasi për të kursimet familjare janë rrjedhojë e të ardhurave nga paga dhe qiradhënia e apartamentit 1+1, me sipërfaqe 70.7 m², në rrugën “M.Gj”, Tiranë, pra janë e njëjta gjë. Subjekti pretendon se të gjitha shumat e disponuara prej familjes së tij deri në vitin 2003, si dhe kursimet (e të ardhurave) të viteve 2004 e 2005, kredia bankare e marrë pranë BKT-së në vlerën 31,000 euro, të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në vlerën 3,300,000 lekë, janë shpenzuar totalisht për pagesat e kryera për banesën e blerë nga shoqëria “I.K” dhe arredimin e saj.*

26.15. Bazuar në konstatimin e mësipërm, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, me arsyetimin se ka deklaruar burime të ndryshme për këtë pasuri në deklaratën *Vetting* dhe në shpjegimet e dhëna në ILDKPKI në vitin 2015, pasi në deklaratën *Vetting* nuk ka cituar si burim për blerjen e kësaj pasurie të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit.

26.16. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ka një mospërputhje në lidhje me deklarimin e burimit të kësaj pasurie midis deklaratës *Vetting* dhe deklarimeve të

¹² Vendimet e Kolegjit nr. 9/2020 (JR), datë 26.6.2020; nr. 16/2020 (JR), datë 13.7.2020; nr. 31/2020 (JR), datë 18.11.2020.

subjektit në ILDKPKI. Kjo mospërputhje nuk mund të klasifikohet si deklaram i pasaktë në kuptim të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të automjetit (200,000 lekë), si dhe faktin se nga ana e subjektit nuk rezulton të jenë deklaruar si burim për blerjen e këtij apartamenti të ardhurat nga automjeti në asnjë prej deklarameve periodike, por as në deklaratën *Vetting*, për rrjedhojë, nuk jemi përpara një deklarimi të pasaktë.

27. Komisioni ka analizuar burimet e deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting* për blerjen e kësaj pasurie, si vijon:

i) Kredia e marrë në vlerën 31,000 euro në BKT

27.1. Nga hetimi¹³ ka rezultuar se në datën 17.12.2004 bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e kredimarrëses, dhe subjekti, në cilësinë e dorëzanësit, kanë lidhur kontratë kredie bankare nr. *** me BKT-në, për vlerën 31,000 euro, me afat 10 vjet. Nga përmbajtja e kontratës rezulton se kjo kredi është marrë me qëllim “blerje shtëpie”. Garantimi i kredisë bankare është bërë përmes hipotekimit të pasurisë apartament me sip. 70.7 m², ndodhur në rrugën “M.Gj”. Referuar lëvizjeve bankare, kredia në vlerën 30,380 euro është lëvruar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit në datën 13.1.2005, e cila ka kryer tërheqje *cash* të shumës 30,000 euro në datën 14.1.2005. Sipas konfirmimit të BKT-së, kredia bankare është shlyer në datën 13.1.2015.

Referuar mandatpagesave të paraqitura nga subjekti, bashkëlidhur pyetësorit standard, rezulton se pas lëvrimit të kredisë ka paguar vlerën 25,000 euro në favor të shoqërisë “I.K” sh.p.k., sipas mandatpagesës datë 15.1.2015.

ii) Të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit në lagjen nr. *, Durrës, në vlerën 3,300,000 lekë

27.2. Referuar përgjigjes së ASHK-së¹⁴ rezulton se në datën 13.8.1993 subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij kanë lidhur kontratën e shitblerjes me ish-Ndërmarrjen Komonale të Banesave për blerjen e apartamentit me sip. 54.93 m², në vlerën 15,631 lekë.

Subjekti i rivlerësimit, me anë të kontratës nr. ***, datë 15.7.2005, ia ka shitur këtë pasuri shtetases Sh.R në vlerën 3,300,000 lekë, e cila deklarohet e likuiduar jashtë zyrës noteriale. Me mandatarkëtimin nr. ***, datë 18.7.2005, subjekti ka paguar pranë ZVRPP-së tatimin për kalimin e të drejtës së pronësisë në vlerën 33,000 lekë.

iii) Të ardhurat nga qiradhënia e apartamentit me sip. 70.7 m², në Tiranë

27.3. Të ardhurat e përfituara nga qiradhënia e apartamentit në rrugën “M.Gj”, Tiranë, janë trajtuar në pikën 54 të këtij vendimi.

iv) Të ardhurat nga paga

27.4. Komisioni ka përfshirë në analizë financiare të ardhurat nga paga e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes për periudhat kohore të segmentuara në përputhje me mandatpagesat e paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ.

27.5. Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me likuidimin e pagesave të apartamentit

Subjekti ka paraqitur, bashkëlidhur deklaratës *Vetting*, mandatarkëtimet si vijon:

- mandatarkëtimi nr. **, datë 22.5.2004, sipas së cilit z. Shpëtim Reka arkëton në favor të shoqërisë “I.K” sh.p.k. shumën 10,000 euro;

¹³ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.1.2020, e BKT-së.

¹⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 24.9.2021, drejtuar ASHK-së Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.10.2021, e ASHK-së Durrës.

- mandatarkëtimi¹⁵ nr. **, datë 3.11.2004, sipas së cilit z. Shpëtim Reka arkëton në favor të shoqërisë “I.K” sh.p.k. shumën 10,000 euro;
- mandatarkëtimi nr. **, datë 15.1.2005, sipas së cilit z. Shpëtim Reka arkëton në favor të shoqërisë “I.K” sh.p.k. shumën 25,000 euro;
- mandatarkëtimi nr. **, datë 19.8.2005, sipas së cilit z. Shpëtim Reka arkëton në favor të shoqërisë “I.K” sh.p.k. shumën 10,000 euro;
- mandatarkëtimin nr. **, datë 20.12.2005, sipas së cilit z. Shpëtim Reka arkëton në favor të shoqërisë “I.K” sh.p.k. shumën 5,000 euro;
- të gjitha mandatet kanë përshkrimin “pagesë pjesore për blerje apartamenti”;
- mandatarkëtimi nr. *, datë 19.10.2005, sipas së cilit z. Shpëtim Reka arkëton në favor të shoqërisë “I.K” sh.p.k. shumën 20,600 lekë, me përshkrimin “cash – kontrata nr. **”;
- mandatarkëtimi nr. **, datë 1.6.2006, sipas së cilit z. Shpëtim Reka arkëton në favor të shoqërisë “I.K” sh.p.k. shumën 3,000 euro, me përshkrimin “pagesë pjesore për blerje apartamenti”.

27.6. Në DVP/2005¹⁶ subjekti ka deklaruar: *“Blerë një apartament 3+1, ndodhur në Lagjen nr. *, Durrës. Pasuria është ende e paregjistruar. Nga vlera e plotë prej 70,000 euro janë shlyer 60,000 euro”*.

Në DVP/2011 subjekti ka deklaruar: *“Pasuria apartament 3+1, ndodhur në Lagjen nr. *, Durrës, është regjistruar në ZVRPP-në Durrës në regjistrin hipotekor nr. ***, datë 1.12.2011, në pronësi të Shpëtim dhe F.R. Vlera 70,000 euro e shlyer tërësisht sipas deklarimeve të mëparshme”*.

27.7. Sipas mandateve të mësipërme, rezulton se subjekti ka paguar në favor të shoqërisë “I.K” sh.p.k. shumën totale prej 63,000 euro. Nga kjo shumë, vlera prej 60,000 euro është shlyer deri në muajin dhjetor të vitit 2005, në përputhje me deklarinimin e kryer nga subjekti në DVP/2005. Diferenca prej 3,000 euro është shlyer në janar të vitit 2006. I pyetur nga Komisioni lidhur me datën e pagesës së këstit të fundit të çmimit të blerjes prej 7,000 euro, subjekti ka sqaruar: *“Në lidhje me pagesën e këstit të fundit për apartamentin e blerë nga shoqëria ‘I. K’ sh.p.k. kemi respektuar të gjitha kushtet e shënuara në kontratën e shitblerjes me rezervë, nr. ***rep., nr. *** kol., datë 20.5.2004, ku në pikën 7 parashikohet se: ‘Blerësi detyrohet t’i paguajë shitësit këstin e fundit prej 10% të vlerës së përgjithshme të apartamentit (7,000 euro) para dorëzimit efektiv të apartamentit dhe para përfundimit të formaliteteve për kalimin e pronësisë’. Formalitetet për kalimin e pronësisë kanë përfunduar në vitin 2011, me realizimin e kontratës së shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 18.11.2011. Ne kemi kryer pagesën e këstit të fundit në lidhje me apartamentin përpara përpilimit të kontratës së shitjes, pra përpara datës 18.11.2011, fakt ky i pasqyruar qartë edhe në kontratën e sipërcituar, ku në faqen 2 të saj, në rubrikën ‘çmimi i shitjes’ është shënuar se: ‘Pala shitëse deklaron se apartamentin me sip. 146.5 m² ia shet palës blerëse për çmimin 70,000 (shtatëdhjetë mijë) euro, shumë e cila është likuiduar plotësisht nga pala blerëse jashtë kësaj zyre noteriale”*.

27.8. Komisioni, bazuar në deklarinimet e subjektit, duke qenë se e kishte të paqartë momentin e likuidimit të këstit të fundit prej 7,000 euro, i kaloi subjektit barrën e provës, pasi nuk kishte dhënë shpjegime lidhur me momentin e kryerjes së pagesës së këstit të fundit, nuk provoi me dokumentacion likuidimin e këtij këstit në favor të shoqërisë “I.K” sh.p.k., si dhe nuk ka deklaruar në DPV-të e viteve 2006 - 2010 detyrimin ndaj kësaj shoqërie në vlerën 7,000 euro.

Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka parashtruar të njëjtat pretendime si gjatë hetimit dhe ka pohuar se nuk disponon dokumentacion që përcakton saktësisht kohën e shlyerjes për pjesën e mbetur prej 7,000 euro, por deklaroi me përgjegjësi se kjo shumë është shlyer pjesë-

¹⁵ Mandati nr. **, si dhe mandatet vijues nuk rezultojnë të nënshkruara nga blerësi/subjekti i rivlerësimit.

¹⁶ Në DVP/2005 bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit ka kryer deklarinim të njëjtë me subjektin lidhur me pagesat e kryera për këtë apartament.

pjesë, tek subjekti në mirëbesim, gjatë viteve 2006 - 2010, pra, përpara datës 18.11.2011. Subjekti i ka bashkëlidhur parashtrimeve të tij korrespondencën me *e-mail* me administratorin e shoqërisë "I.K" sh.p.k., z. P.T, i cili shprehet se subjekti ka shlyer totalisht pagesën ndaj shoqërisë dhe mbi bazën e tyre është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes.

27.9. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në prova, por mbeten në nivel deklarativ. Subjekti nuk ka depozituar asnjë dokumentacion për të provuar pretendimin e tij se pagesat janë kryer gjatë periudhës 2006 - 2010. Gjithashtu, subjekti nuk rezulton të ketë deklaruar shlyerjen e kësaj shume në DPV-të e vitve 2006 – 2010, të cilat përbëjnë provë bazuar në nenin 32/5 të ligjit nr. 84/2016. Në lidhje me shlyerjen e kësaj shume, Komisioni vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pamjaftueshëm, duke e vlerësuar këtë defekt dhe peshën e tij në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij. Në analizë financiare shuma 7,000 euro do të konsiderohet e shlyer në vitin 2011, përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes.

27.10. Në lidhje me gjendjen e konfliktit të interesit, Komisioni ka administruar informacion nga institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, të cilët kanë informuar si më poshtë vijon:

- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁷ informon se subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar çështjen gjyqësore me kërkuar shoqëribë "I.K" sh.p.k., me objekt "lëshimin e urdhrin të ekzekutimit" për vendimin nr. ***. Me vendimin datë 25.7.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuar "I.K" sh.p.k.

- Vendimi gjyqësor nr. ***, për të cilin subjekti ka lëshuar urdhrin e ekzekutimit, rezulton se ka pasur si objekt gjykimi "detyrimin e të paditurve të përmbushin detyrimin kontraktor, duke mundësuar lidhjen e kontratës së shkëmbimit të truallit për pasuritë e paluajtshme nr. ***-Nd+*_*_, nr. ***-Nd+*_*_ etj."

Referuar numërtimit të pasurive, objekt gjykimi, rezulton se ndodhen në të njëjtën godinë me apartamentin e blerë nga subjekti pranë shoqërisë "I.K" sh.p.k.

27.11. Apartamenti i blerë nga subjekti referuar vërtetimit hipotekor datë 29.6.2007, të paraqitur nga prej tij së bashku me deklaratën *Vetting*, rezulton se ka qenë i regjistruar pranë ASHK-së me regjistrim të përkohshëm, i vlefshëm deri në përfundimin e regjistrimit fillestar të pasurisë. Në seksionin "barrë mbi pasurinë" të këtij vërtetimi evidentohet shënimi "*Të mos kryhen veprime pa realizuar kontratën e këmbimit. U realizua kontrata e këmbimit*".

Në analizë të ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme" (ligji i kohës kur janë kryer veprimet hipotekore), në nenin 45 të tij përcaktohet se: "*Sa kohë që një kufizim mbetet i regjistruar, nuk duhet të regjistrohet asnjë dokument që nuk pajtohet me të, pa urdhrin e regjistruesit ose vendimin e gjykatës*".

Në kushtet e vendosjes së urdhrin të kufizimit mbi apartamentin e blerë nga subjekti, ky i fundit do ta kishte të pamundur përfundimin e regjistrimit fillestar të pasurisë dhe pajisjen me certifikatë pronësie për këtë apartament, pa u zgjidhur paraprakisht marrëdhënia mes investitorit dhe pronarëve të truallit përmes nënshkrimit të kontratave përfundimtare të shkëmbimit, si dhe pa u lëshuar urdhri i ekzekutimit për vendimin e gjykatës që detyronte pronarët e truallit ku ndodhej edhe apartamenti i subjektit për të lidhur kontratën e shkëmbimit me shoqërinë "I.K" sh.p.k.

Në nenin 72, pikat 1 dhe 6 të Kodit të Procedurës Civile, përcaktohen "rastet e përjashtimit të gjyqtarit", ku parashikohet se: "*1. Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështjeje konkrete kur ka interes në çështje ose në një mosmarrëveshje tjetër që ka lidhje me*

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 2.11.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të cilën subjekti i rivlerësimit e ka paraqitur në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021.

atë në gjykim. 6. Në çdo rast tjetër kur vërtetohen, sipas rrethanave konkrete, arsye serioze njëanshmërie”.

Lëshimi i urdhrimit të ekzekutimit për zbatimin e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe zgjidhja e marrëdhënies së pronarëve të truallit me shoqërinë ndërtuese vlerësohet si një veprim në mbështetje të interesave pasuror të vetë subjektit të rivlerësimit, me qëllim pajisjen e tij me dokumentacion pronësie për apartamentin e blerë nga shoqëria “I.K” sh.p.k. Ky vlerësim bazohet edhe në faktin që pak muaj pas lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit datë 25.7.2011, në datën 18.11.2011 subjekti ka mundur të lidhë kontratën përfundimtare të shitjes, si dhe është pajisur me certifikatë pronësie për këtë apartament.

Bazuar në analizën e mësipërme, duket se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pranimin e kërkesës së shoqërisë “I.K” sh.p.k. për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit, në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe në kushtet e konfliktit të interesit të parashikuar nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile.

Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

27.12. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: *“Nuk është e vërtetë që në kohën e gjykimit (datë 25.7.2011) me objekt ‘lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit’, kam pasur detyrime të pashlyera ndaj shoqërisë ‘I.K’ sh.p.k. Detyrimet e mbetura prej 7,000 euro janë shlyer pjesë-pjesë tek subjekti në mirëbesim, gjatë periudhës 2006 – 2010, pra, përpara datës 18.11.2011. Vendimi i dhënë prej meje është vendim për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit referuar parashikimeve të nenit 510 e vijues të Kodit të Procedurës Civile, për një vendim gjyqësor të formës së prerë, që përbën titull ekzekutiv dhe përmban detyrime për t’u ekzekutuar. Në këto kushte, vendimi për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit nuk zgjidh çështje në themel, por merret vetëm me verifikimin e kushteve formale që janë ekzistenca e një vendimi që zgjidh mosmarrëveshjen në themel, si dhe fakti që ky vendim është ose jo i formës së prerë. Në këto kushte, gjykimi për lëshimin e urdhër ekzekutimit nuk është një gjykim që i nënshtrohet parimeve të përgjithshme të Kodit të Procedurës Civile, pasi me anë të tij vihet në ekzekutim një titull ekzekutiv, i cili në rastin konkret ka qenë vendim gjykate. Gjyqtari, në gjykim për lëshimin e urdhër ekzekutimit, nuk është në konflikt interesi me asnjë nga palët ndërgjyqëse, pasi ai nuk gjykon mosmarrëveshjet e palëve, por, si të thuash, kryen një veprim administrativ për të lejuar ekzekutimin e një vendim gjykate, që është kthyer në titull ekzekutiv. Në rastin konkret nuk kam pasur asnjë interes në lidhje me lëshimin ose jo të urdhrimit të ekzekutimit, pasi vendimi ishte marrë nga një tjetër gjyqtar. Nuk kam pasur mosmarrëveshje me ndonjë person për këtë urdhër ekzekutimi, gjithashtu nuk ka pasur shkak për arsye njëanshmërie në lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit, pasi vendimi gjyqësor ishte me formë të prerë”.*

27.13. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Lidhur me pretendimin e subjektit se në kohën e lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit ai nuk ka pasur detyrim të pashlyer ndaj shoqërisë “I.K” sh.p.k., Komisioni vlerëson se ky pretendim mbetet në nivel deklarativ dhe i paprovuar me dokumentacion. Por, edhe nëse ky fakt do të rezultonte i provuar, subjekti do të gjendej sërish në të njëjtën situatë, për shkak të një marrëdhënieje interesi pasuror ende të pafinalizuar me palën kërkuese, për aq kohë sa kontrata përfundimtare e shitjes me këtë shoqëri është lidhur në datën 18.11.2011, pra, pas datës së dhënies së vendimit për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit.

27.14. Lidhur me pretendimin e subjektit se vendimi i dhënë prej tij ka qenë vendim për lëshimin e urdhrimit të ekzekutimit dhe se ai nuk gjykon mosmarrëveshjet mes palëve, por është një veprim administrativ, Komisioni vlerëson se neni 72 i Kodit të Procedurës Civile nuk përcakton natyrën e çështjes gjyqësore nga e cila gjyqtari duhet të heqë dorë nga gjykimi, në

rastet kur vërtetohen rrethanat e përcaktuara në këtë nen të cilat mund të shfaqin arsye serioze njëanshmërie. Si pasojë, gjykimet e një natyrë të posaçme si ato të “lëshimit të urdhrimit të ekzekutimit” nuk e përjashtojnë gjyqtarin nga detyrimi për të zbatuar përcaktimet e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, neni 3.1 parashikon se: “*Konflikt i interesit është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa private, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike*”. Në vlerësim të pengesave ligjore të përcaktuara në ligj, nuk është e nevojshme të provohet nëse veprimi apo pasoja ka ardhur, por mjafton vetëm “mundësia” e veprimit kundër parimit të paanësisë dhe të objektivitetit për të vënë në lëvizje detyrimin e subjektit dhe pasojën juridike të moszbatimit të tij.

Në përfundim të kësaj analize, Komisioni vlerëson se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, i cili duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

C) Në lidhje me aftësinë financiare të subjektit për blerjen e apartamentit

28. Komisioni kreu analizën financiare mbi mundësitë e subjektit për kryerjen e pagesave të dokumentuara, për blerjen e apartamentit, pasqyruar në tabelën vijuese:

Tabela nr. 3

	20.5.2004	3.11.2004	15.1.2005	19.8.2005	20.12.2005	1.6.2006	17.11.2011
Pasuri	8,320,664.91	132,642.98	14,757.03	-51,371.40	99,084.02	68,452.35	-204,350.02
Apartament 146.5 m ²	8,871,800.00						
<i>Shtesa/pakësime/likuiditete</i>	<i>-551,135.09</i>	<i>132,642.98</i>	<i>14,757.03</i>	<i>-51,371.40</i>	<i>99,084.02</i>	<i>68,452.35</i>	<i>-204,350.02</i>
Detyrime	7,604,400.00	1,267,400.00	639,854.56	1,361,274.50	-845,627.71	506,218.04	1,283,971.32
Pasuri neto	716,264.91	1,400,042.98	625,097.53	1,309,903.10	944,711.73	574,670.38	1,079,621.31
Të ardhura	839,862.13	839,862.13	167,000.08	4,495,250.58	2,549,099.00	872,208.00	2,381,095.58
Shpenzime	156,606.67	156,606.67	70,587.27	494,110.86	1,057,933.18	650,556.36	1,030,659.88
Mundësia për kursime	-33,009.45	-716,787.52	721,510.34	2,691,236.63	546,454.09	353,018.74	270,814.40

28.1. Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kryerjen e pagesave të datave 20 maj 2004, 3 nëntor 2004 dhe 1 qershor 2006. Pamundësia totale e subjektit për kryerjen e pagesave për blerjen e apartamentit nga shoqëria “I. K” sh.p.k. rezulton në vlerën 1,102,815.72 lekë. Subjektit iu kalua barra e provës për këtë mungesë të ardhurash.

28.2. Në parashtrimet e tij, subjekti ka pretenduar se në analizën e kryer nga Komisioni nuk janë llogaritur të gjitha pakësimet e gjendjes *cash* dhe pakësimet e likuiditeteve që ai dhe bashkëshortja kanë pasur të depozituara në “Alpha Bank” dhe BKT. Ai evidenton se në datën 14.5.2004 bashkëshortja e tij ka tërhequr nga llogaria e saj në BKT shumën 6,150 USD, ekuivalente me 642,060 lekë. Kjo vlerë, sipas subjektit, është përdorur totalisht për pagesat e kryera në vitin 2004, por nuk është pasqyruar si pakësim në asnjë nga tabelat e analizës financiare.

28.3. Së bashku me parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur aktekspertimi financiar të përgatitur në datën 15.2.2022, nga eksperti I.D. Në përmbajtje të aktekspertimit, kërkohet që Komisioni të marrë në konsideratë faktin që në DVP/2003 subjekti ka shënuar vlerën 1,500,000 lekë dhe jo vlerën 1,000,000 lekë *cash*, sikurse është konsideruar nga Komisioni. Sipas subjektit, kjo

vlerë nuk është konsideruar si vlerë “cash” që duhet pakësuar në funksion të shpenzimeve të kryera, por është mbajtur e pandryshuar përgjatë periudhave të deklarimit, duke mos pasqyruar saktë aftësinë financiare të tij për të mbuluar shpenzimet e mëpasshme.

28.4. Pasi analizoi parashtrimet e subjektit, Komisioni vlerëson se pretendimi i tij në lidhje me vlerën e likuiditeteve “cash”, të deklaruar në DVP/2003, është trajtuar dhe qartësuar gjatë hetimit administrativ përmes administrimit të deklarimit vjetor të këtij viti nga ILDKPKI-ja. Nga DVP/2003 rezultoi se gjendja *cash* e deklaruar nga subjekti në deklarimin e këtij viti është në vlerën 1,000,000 lekë. Për këtë arsye, pretendimi i tij nuk qëndron, pasi nuk mbështetet në dokumentacionin e administruar.

28.5. Lidhur me pretendimin e subjektit mbi përlogaritjen e pakësimit të gjendjes *cash* si burim për shlyerjen e pagesave ndaj shoqërisë “I.K” sh.p.k., Komisioni vlerëson se ky pretendim mbetet në nivel deklarativ dhe nuk gjen pasqyrim në deklarimet vjetore të kryera nga subjekti në ILDKPKI, në të cilat nuk cituar pakësim të gjendjes *cash*. Qëndrimi i subjektit bie në kundërshtim me metodologjinë e plotësimit të deklarimeve periodike vjetore, ku tepricat apo pakësimet jashtë sistemit bankar deklarohen si ndryshime të gjendjes *cash* në banesë dhe në rastin e subjektit nuk kanë rezultuar deklarime të ndryshimit të gjendjes *cash* ndër vite. Në këtë vlerësim, kërkesa e subjektit për të mbartur pakësimet ndër vite si pakësim të kursimeve *cash* në DVP/2003 nuk mund të pranohet¹⁸.

28.6. Lidhur me pretendimin e subjektit, për përfshirjen në analizën financiare të likuiditeteve që ai dhe bashkëshortja kanë pasur të depozituara në “Alpha Bank” dhe BKT, Komisioni vlerëson të përfshijë në analizë financiare gjendjen e likuiditeteve të pretenduara nga subjekti, duke kryer edhe një herë analizat e pjesshme financiare për blerjen e apartamentit, pasqyruar në tabelën vijuese:

Tabela nr. 4

	22.5.2004	3.11.2004	15.1.2005	19.8.2005	20.12.2005	1.6.2006	17.11.2011
Pasuri	8,320,664.91	134,641.98	-47,671.97	1,664,188.60	577,259.83	40,417.11	-250,261.42
Apartamenti 146.5 m ²	8,871,800.00						
<i>Shtesa/pakësime/likuiditete</i>	<i>-551,135.09</i>	<i>134,641.98</i>	<i>-47,671.97</i>	<i>1,664,188.60</i>	<i>577,259.83</i>	<i>40,417.11</i>	<i>-250,261.42</i>
Detyrime	7,604,400.00	1,267,400.00	639,854.56	1,361,274.50	-845,627.71	-506,218.04	1,283,971.32
Pasuri neto	716,264.91	1,402,041.98	-687,526.53	3,025,463.10	1,422,887.54	546,635.14	1,033,709.91
Të ardhura	839,862.13	839,862.13	167,000.08	4,495,250.58	2,549,099.00	872,208.00	2,381,095.58
Shpenzime	156,606.67	156,606.67	70,587.27	494,110.86	1,057,933.18	509,888.93	1,030,659.88
Mundësia për kursime	-33,009.45	-718,786.52	783,939.34	975,676.63	68,278.28	-184,316.08	316,725.80

28.7. Nga analiza financiare rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme për kryerjen e pagesave të datave 22 maj 2004, 3 nëntor 2004 dhe 1 qershor 2006. Pamundësia totale e subjektit për kryerjen e pagesave për blerjen e apartamentit nga shoqëria “I. K” sh.p.k. rezulton në vlerën 936,112.05 lekë.

Në përfundim, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për blerjen e apartamentit në shumën 936,112.05 lekë, sipas përcaktimeve të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, por duke marrë në konsideratë se subjekti në vitin 2004 ka pasur gjendje *cash* në shumën 1,000,000 lekë, si dhe ka një rezultat pozitiv në vitin 2005 në shumën 2,411,229.82 lekë, Komisioni vlerëson se këto fakte mund të tregojnë për pasaktësi në deklarimet periodike vjetore të kursimeve *cash* në vite të subjektit, për pasojë, konkludohet se nuk është e

¹⁸ I njëjti qëndrim është mbajtur nga Kolegji në vendimin nr. 27 (JR), datë 22.10.2020 dhe vendimin nr. 332 (JR), datë 12.1.2021.

mjaftueshme për t'u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, por që do të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

29. Apartament¹⁹ me sip. 109.50 m², në rrugën “A.F”, në të cilin bashkëshortja e subjektit zotëron ¼ pjesë takuese

29.1. Apartamenti ka qenë banesa e prindërve të saj që nga viti 1965. Në këtë apartament është ndërtuar shtesë anësore dhe një ambient me sipërfaqe 19 m², e paregjistruar në regjistrat publikë. Nga nëna e bashkëshortes V.A në datën 13.9.2006 është aplikuar për legalizim. Aktualisht, pas vdekjes së saj, legalizimi për këtë pronë do të kalojë në emër të bashkëpronarëve si më sipër, ku bashkëshortes F. R i takon ¼ pjesë e saj.

29.2. Burimi sipas deklaratës Vetting: pasuria është fituar prej bashkëshortes me trashëgimi, në bazë të dëshmisë së trashëgimisë nr. ***, datë 11.5.2016.

Hetimi²⁰ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

29.3. Me kontratën e shitjes datë 15.7.1993, shtetasit J, V, I, V dhe E.A kanë blerë nga Ndërmarrja Komonale Banesa apartamentin me sip. 109.5 m², ndodhur në rrugën “M”, Tiranë, për çmimin 40,648 lekë. Sipas mandatpagesave bashkëlidhur kontratës, rezulton se pagesa e çmimit të blerjes është kryer nga shtetasi J.A²¹. Pronarët e sipërcituar kanë përfituar përkatësisht nga 1/5 pjesë takuese në këtë pasuri.

29.4. Me kontratën e dhurimit datë 23.10.1994, shtetasja E.A²² i ka dhuruar pjesën e saj takuese në këtë pasuri shtetasit J.A, i cili, pas këtij dhurimi, është bërë pronar i 2/5 pjesë takuese të kësaj pasurie. Më tej, me kontratën e dhurimit datë 19.1.1998, dy nga bashkëpronarët e apartamentit, I dhe V.A, kanë dhuruar pjesët e tyre takuese në favor të dy bashkëpronarëve J dhe V.A. Në këtë mënyrë, shtetasit J e V.A bëhen bashkëpronarë të apartamentit me sip. 109.5 m².

29.5. Në datën 12.8.2000 shtetasi J.A ka ndërruar jetë dhe në datën 7.11.2000 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore, sipas së cilës trashëgimtar ligjor të tij janë njohur bashkëshortja V.A dhe fëmijët D, E, I dhe F.A/R. Bazuar mbi këtë dëshmi trashëgimie bashkëshortja e subjektit ka përfituar 1/10 pjesë takuese të apartamentit me sip. 109.5 m², ndodhur në rrugën “A. F”.

29.6. Në datën 6.12.2000 shtetasit D, E, I dhe F.A/R, përmes kontratës së shitjes nr. ***, kanë shitur²³ pjesët e tyre takuese në favor të bashkëpronares V.A, e cila u bë pronare e vetme e apartamentit, duke u pajisur me certifikatë pronësie datë 27.4.2015. Në datën 25.5.2015 shtetasja V.A ka ndërruar jetë dhe në datën 11.5.2016 është lëshuar dëshmia e trashëgimisë testamentare dhe ligjore, përmes së cilës apartamenti është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve D.A, I.A, F.R, M.K dhe E.I.

¹⁹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetim pronësie datë 14.6.20116, për apartamentin me sip. 109.5m², me nr. pasurie ***+*.**, z. k. ***, në bashkëpronësi të shtetasve F.R, D.A, E.I, I.A dhe M.K; (ii) kërkesë për rivlerësim pasurie, datë 16.2.2010, nga shtetasi D. A; (iii) dëshmi trashëgimie datë 11.5.2016, ku caktohen trashëgimtarët ligjorë të shtetasve V.A; vetëdeklarim datë 13.9.2006, për legalizim shtese anësore në godinë banimi, me sipërfaqe ndërtimi 19 m + praktika, nga shtetasja V.A.

²⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.2.2020, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug; shkresë nr. *** prot., datë 24.9.2021, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 29.9.2021, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug; shkresë nr. *** prot., datë 4.11.2021, drejtuar ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 10.11.2021, e ASHK-së, Drejtoria Vendore Tirana Jug.

²¹ Babai i bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit.

²² Motra e z. J.A.

²³ Çmimi i shitjes së pjesëve takuese është 600,000 lekë në total. Kjo vlerë është ndarë midis 4 bashkëpronarëve të cilët kanë shitur në favor të nënës së tyre 4/10 pjesë takuese të pasurisë.

29.7. ASHK-ja konfirmon se bashkëshortja e subjektit rezulton e pajisur me leje legalizimi për objektin “shtesë anësore” nr. ***, datë 31.3.2017, ndërtuar në pasurinë e mësipërme.

Nga dokumentacioni i administruar në lidhje me legalizimin e sipërfaqes së shtesës së këtij apartamenti rezulton se trashëgimlënësja V.A ka paraqitur pranë ALUIZNI-t, “vetëdeklarim” nr. *** prot., datë 13.9.2006, për përfshirje në procedurat e legalizimit të sipërfaqes së shtesës anësore 19 m² të ndërtuar në apartamentin në rrugën “A.F”, Tiranë.

29.8. Pasi shtetasja V.A ka ndërruar jetë, trashëgimtarët ligjorë të së ndjerës kanë nënshkruar dhe depozituar pranë ALUIZNI-t deklaratën noteriale nr. ***, datë 20.9.2016, përmes së cilës kanë dakordësuar që procesi i legalizimit të shtesës anësore të vijojë në favor të shtetases F. R, e cila përfiton 2/8 pjesë dhe shtetases E.I, e cila përfiton 6/8 pjesë të shtesës anësore.

29.9. Në datën 8.3.2017 shtetaset E. I dhe F.R kanë nënshkruar kontratën e kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore me ALUIZNI-n, përmes së cilës kanë marrë në pronësi parcelën ndërtimore me pjesë takuese 4.12 m². Pagesa e parcelës ndërtimore në vlerën 14,450 lekë rezulton të jetë kryer nga shtetasi D. A në “Credins Bank”, në datën 3.6.2015.

29.10. Në datën 31.3.2017 është miratuar leja e legalizimit nr. ***, për shtesën me sip. 23.3 m², në favor të shtetaseve E.I e F.R, pasuri e cila është regjistruar në ASHK me nr. pasurie ***+*-*, vol. **, f. **.

29.11. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë pasuri të subjektit. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

30. Automjet²⁴ tip “M-B” (D.C), me targa AA * ER, përfituar përmes kontratës së shitblerjes datë 20.8.2012, në emër të djalit E.R, me vlerë 1,300,000 lekë**

30.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kjo pasuri është siguruar pjesërisht nga kursimet dhe të ardhurat familjare dhe pjesërisht nga shitja e automjetit tip “O.C”, i regjistruar në DPSHTRR-në Durrës.

Hetimi²⁵ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

30.2. Me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 20.8.2012, djali i subjektit E.R ka blerë automjetin tip “M-B” (vit prodhimi 2006) në shumën 1,300,000 lekë. Sipas përmbajtjes së kësaj kontrate, pagesa e çmimit të shitjes në favor të shitësit D.K është likuiduar jashtë zyrës noteriale.

30.3. Me kontratën e shitjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.12.2019, E.R ka tjetërsuar këtë automjet në favor të shtetasit S.Sh, me çmim shitjeje 650,000 lekë. Referuar nenit 2 të kësaj kontrate, çmimi i shitjes do të paguhet në llogarinë bankare të shitësit pranë “Alpha Bank”. Nga nxjerrja e llogarive bankare të shtetasit E.R në “Alpha Bank”, evidentohet kreditimi i llogarisë së tij në datën 11.12.2019, me shumën 650,000 lekë, transfertë në mbërritje nën komentin “Për kontratë shitjeje automjeti nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.12.2019, në favor të E.R nga S.Sh”.

30.4. Sipas dokumentacionit të administruar nga DPSHTRR-ja, rezulton se shtetasi D.K e ka blerë këtë automjet në Itali nga shoqëria “O.s”, sipas faturës së shitjes datë 19.7.2012, në vlerën 11,570 euro²⁶ dhe sipas deklaratës doganore Import *, ka paguar detyrime tatimore në shumën

²⁴ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) leje qarkullimi për automjetin me targa AA ** ER, në pronësi të E. R; (ii) kontratë shitjeje datë 20.8.2012, me palë shitëse D.K dhe palë blerëse E.R, për blerje automjeti tip “M-B ML ** CDI”, vlera 1,300,000 lekë; (iii) kontrate shitjeje datë 16.8.2012. Ky automjet është deklaruar edhe nga djali i subjektit E.R.

²⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 17.9.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.9.2021.

²⁶ Kursi i këmbimit të monedhës euro në lekë sipas deklaratës doganore është përlllogaritur 138.170.

481,800 lekë. Pra, në total shtetasi D.K ka paguar shumën 2,080,426 lekë për blerjen e këtij automjeti.

30.5. I pyetur nga Komisioni lidhur me arsyen përse shitësi i këtij automjeti e ka shitur në favor të djalit të subjektit në vlerën 700,000 lekë më pak se çmimi i blerjes, vetëm një muaj pas blerjes së tij, subjekti ka deklaruar se nuk ka informacion lidhur me çmimin e blerjes së automjetit nga shitësi dhe se nuk ka asnjë njohje me të. Ai i ka bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit datë 25.10.2021, shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përmes së cilës informohet se subjekti i rivlerësimit nuk e ka gjykuar shtetasin D. K.

30.6. Në përfundim në lidhje me këtë automjet, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, pasi duket se është e paqartë dhe jo në përputhje me parimin e fitimit në aktivitetin tregtar fakti që shtetasi D.K e ka blerë këtë automjet në vlerën 2,080,426 lekë dhe vetëm një muaj më pas ia ka shitur djalit të subjektit në vlerën 1,300,000 lekë.

30.7. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti prapësoi se me kontratën e shitblerjes së automjetit nr. ***, datë 20.8.2012, djali i subjektit E. R ka blerë nga shtetasi D.K automjetin tip “M-B” (vit prodhimi 2006) në shumën 1,300,000 lekë.

Fakti se sa ka qenë çmimi i blerjes së automjetit në Itali, nuk i është bërë i njohur nga shitësi dhe as nuk kanë marrë dijeni për të në aktet që janë dorëzuar nga shtetasi D.K, në kohën e përpilimit të kontratës së shitjes. Djali i subjektit nuk ka bërë kërkime për të ditur se sa ka qenë çmimi i blerjes së këtij automjeti në Itali, pasi i është prezantuar me çmimin e shitjes në pikën e shitjes.

Në këto kushte, në lidhje me vlerën e automjetit të blerë nga djali E.R, nuk ka pasur asnjë arsye të dyshonte apo të pyeste në lidhje me çmimin e shitjes së tij prej shtetasit D.K, për më tepër që nuk ka pasur asnjë lloj dijenie apo *indicie* se sa ka qenë çmimi i blerjes nga shtetasi D. K. Automjeti është prezantuar në pikën e shitjes ku ka ushtruar aktivitet shtetasi D.K dhe është blerë nga djali i subjektit në formën e kërkuar ligjore, me çmimet e tregut në kohën e blerjes së tij.

Aktualisht ky automjet i është shitur në vitin 2019 shtetasit S.Sh në vlerën 650,000 lekë, për të cilin është përpiluar kontrata e shitjes nr. ***, datë 10.12.2019, të cilën subjekti ia ka vënë në dispozicion Komisionit. Sipas deklarimeve të subjektit *shtetasin D.K nuk e kanë njohur dhe nuk e njohin. Nuk kanë hetuar dhe gjykuar procedime me palë shtetasin D.K, fakt te cilin e provojnë me shkresat bashkëlidhur.*

Subjekti, pas kalimit të barrës së provës, ka depozituar dokumentacionin si vijon:

- kontratë shitjeje automjeti nr. ***, datë 10.12.2019;
- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.11.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas së cilës subjekti nuk ka gjykuar çështje me palë shtetasin D.K;
- shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.11.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatë së Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas së cilës bashkëshortja e subjekti nuk rezulton të ketë hetuar procedime në ngarkim të shtetasit D.K.

30.8. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, duke marrë në konsideratë faktin se ai dhe bashkëshortja nuk gjenden në kushtet e konfliktit të interesit me shitësin e automjetit, pavarësisht vlerës së ulët të çmimit të blerjes, vlerëson se nuk jemi në kushtet e fshehjes së pasurisë apo të një deklarimi të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë nuk u arrit të provohej se djali i subjektit ka paguar një shumë më të lartë se vlera e caktuar në kontratë.

Në lidhje me hetimin e kryer nga Komisioni për automjetin tip “O.C”, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer si burim për blerjen a automjetit tip “M-B”

30.9. Në DVP/2008 subjekti ka deklaruar blerjen e automjetit tip “Opel” në vlerën 5,000 euro, duke cituar si burim për krijimin e kësaj pasurie “të ardhurat nga kursimet familjare në pronësi dhe përdorim të familjes”.

30.10. DPSHTRR-ja konfirmon se subjekti i rivlerësimit ka blerë këtë automjet në datën 10.6.2008 nga shoqëria koncesionare “L” në Brindisi, Itali, në vlerën 4,600 euro dhe ka paguar detyrimet doganore në vlerën 182,653 lekë. Me kontratën e shitjes datë 16.8.2012, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e kanë shitur këtë automjet në favor të shtetasit I.E, me çmim shitjeje 2,800 euro.

30.11. Lidhur me kursimet familjare, të cilat kanë shërbyer pjesërisht për blerjen e automjetit “O” në vlerën 5,000 euro, Komisioni ka kryer analizën financiare të subjektit, pasqyruar në tabelën vijuese:

Tabela nr. 5

	Datë 10.6.2008
Pasuri	527,600.57
Automjet “O.C”	569,480.00
<i>Shtesa/pakësime/likuiditete</i>	<i>(41,879.43)</i>
Total likuiditete në bankë	260,640.13
Detyrime	-147,374.31
Kredi në BKT 31,000 euro	
Pagesa principal	-147,374.31
Pasuri neto	674,974.88
Të ardhura	892,865.00
Të ardhurat nga puna e subjektit	403,544.00
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	489,321.00
Shpenzime	840,625.15
Shpenzime jetike	273,240.00
TIMS	95,519.41
Pagese interesa për kredinë në BKT	164,212.74
Shpenzime shkollimi	125,000.00
Shpenzime doganore	182,653.00
Mundësia për kursime	-622,735.04

30.12. Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit në shumën 622,735.04 lekë, duke i kaluar barrën e provës subjektit.

30.13. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka arsyetuar se Komisioni nuk ka konsideruar si vlerë që duhet pakësuar në funksion të shpenzimeve të kryera vlerat e deklaruara *cash* nga ana e tij në vitin 2003 si të mbartura nga periudhat e mëparshme, por është mbajtur e pandryshuar përgjatë viteve 2004 e në vijim, duke mos pasqyruar saktë aftësitë e tij financiare në të gjitha periudhat vijuese. Ai ka pretenduar gjithashtu se Komisioni nuk ka marrë në konsideratë të ardhurat nga qiratë të cilat, në disa raste, janë arkëtuar mbi bazë 6-mujori në avancë.

30.14. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se pretendimi i tij lidhur me mbartjen e vlerave *cash* të deklaruara prej tij në vitin 2003 mbetet në nivel deklarativ dhe nuk gjen pasqyrim në deklaratimet vjetore të kryera nga subjekti në ILDKPKI, në të cilat nuk cituar pakësim të gjendjes *cash*. Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga qiradhënia e apartamentit me sip. 70.7 m², Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka mundur t’i dokumentojë këto të ardhura, të cilat janë trajtuar gjerësisht në pikën 54 të këtij vendimi. Nëse si burim për këtë automjet do të merrej në konsideratë pakësimi i gjendjes *cash* që subjekti ka pasur deri në datën 10.6.2008,

ai do të kishte të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e automjetit, por për sa kohë nuk ka deklaruar pakësime të gjendjes *cash* në fund të vitit rezultatit mbetet negativ.

30.15. Në përfundim, rezulton se subjekti ka mungesë të burimeve të ligjshme për mbulimin e shpenzimeve në vitin 2008 në shumën 622,735.04 lekë. Komisioni ka vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së subjektit, në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij, duke marrë në konsideratë edhe faktin që bashkëshortja e subjektit mund të ketë përfituar të ardhura nga qiraja, për të cilat nuk u depozituan kontrata, si dhe nuk u provua pagimi i detyrimeve tatimore.

Analiza financiare për blerjen e automjetit tip “M-B”

30.16. Referuar deklaramentit të subjektit dhe dokumentacionit të administruar, Komisioni ka kryer analizën financiare për blerjen e automjetit tip “M-B”, në të cilën janë konsideruar: (i) të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “O.C”, në vlerën 2,800 euro; (ii) të ardhurat nga kursimet familjare në vlerën 300,000 lekë; si dhe (iii) të ardhurat familjare nga pagat dhe qiradhënia. Shpenzimet jetike janë përlllogaritur për 4 persona.

Tabela nr. 6

	Datë 20.8.2012
Pasuri	1,368,956.98
Automjet “M-B”	1,300,000.00
<i>Shtesa/pakësime/likuiditete</i>	68,956.98
Detyrime	-267,126.01
Kredi në BKT 31,000 euro	
Pagesa principal	-267,126.01
Pasuri neto	1,636,082.99
Të ardhura	2,240,000.00
Të ardhurat nga puna e subjektit	696,653.33
Të ardhurat nga puna e bashkëshortes së subjektit	971,330.67
Të ardhura nga shitja e pasurive të luajtshme	391,216.00
Të ardhura nga qiratë	180,800.00
Shpenzime	730,889.91
Shpenzime jetike	372,128.00
TIMS	235,525.38
Pagesë interesa për kredinë në BKT	72,589.20
Siguracione dhe komisione për disbursim kredie në BKT	4,657.33
Shpenzime shkollimi	45,990.00
Mundësia për kursime	-126,972.90

30.17. Nga analiza financiare rezulton se subjekti dhe personat e lidhur me të nuk kanë pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit në shumën 126,972.90 lekë, duke i kaluar barrën e provës subjektit.

30.18. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka arsyetuar se Komisioni nuk ka përfshirë në analizë financiare pakësimin e gjendjes *cash* në vlerën 300,000 lekë, të deklaruar prej tij. Nëse do të konsiderohej kjo vlerë, subjekti do të rezultonte me mundësi financiare për të përballuar këtë blerje.

30.19. Komisioni analizoi shpjegimet e subjektit dhe vlerëson se pretendimi i i tij nuk qëndron, pasi pakësimi i gjendjes *cash* në vlerën 300,000 lekë është pasqyruar në analizën financiare për blerjen e automjetit, në zërin “shtesa/pakësime/likuiditete”.

30.20. Në përfundim, trupi gjykues, duke marrë në konsideratë vlerën e ulët të mungesës së burimeve të ligjshme, vlerëson se nuk klasifikohet si deklarament i pamjaftueshëm për të shërbyer si shkak autonom për shkarkimin e subjektit nga detyra.

31. Automjet²⁷ tip “M-B”, në pronësi të vëllait të bashkëshortes I.A, e cila është përdorur në periudha të shkurtra kohore prej subjektit dhe bashkëshortes. Automjeti është i regjistruar në DPSHTRR-në Tiranë, me targa TR *** M, me datë 28.7.2006.

31.1. Burimi sipas deklaratës Vetting: nuk kam kryer shpenzime për këtë automjet.

31.2. Konstatimi i ILDKPKI-së: subjekti ka deklaruar përdorimin me raste të automjetit të vëllait të bashkëshortes nga familjarët e tij. Nuk ka paraqitur kontratë përdorimi të automjetit.

Hetimi²⁸ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

31.3. Me kontratën e shitjes datë 26.7.2006, shtetasi I.A ka blerë nga shtetasi I.Z automjetin tip “D.C. E*** CDI”, për çmimin 500,000 lekë. Shitësi I. Z rezultoi ta ketë blerë këtë automjet në shtetin gjerman në datën 1.10.2005, për çmimin 7,000 euro dhe sipas deklaratës doganore Import *, ka paguar detyrimet doganore në vlerën 488,091 lekë.

31.4. Nga të dhënat e AMF-së rezultoi se subjekti i rivlerësimit është policëmbajtës i policave të sigurimit për këtë automjet për periudhat 1.8.2008 – 31.7.2009; 31.8.2009 – 30.8.2010; 6.9.2010 – 5.9.2011; 21.9.2012 – 20.9.2013; 5.9.2015 – 4.9.2016; 5.11.2016 – 4.11.2017; 2.10.2018 – 1.10.2019.

Gjithashtu, rezultoi se pronari i automjetit I.A është policëmbajtës i policave të sigurimit për këtë mjet për periudhat 1.8.2008 – 31.7.2009; 31.9.2009 – 30.8.2010; 6.9.2010 – 5.9.2011; 21.9.2012 – 20.9.2013; 30.6.2014 – 29.6.2015; 5.9.2015 – 4.9.2016; 5.11.2016 – 4.11.2017; 2.10.2018 – 1.10.2019; 13.1.2020 – 12.1.2021; 31.3.2021 – 30.3.2022.

31.5. Nga të dhënat e administruara nga sistemi TIMS, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka kryer daljet e mëposhtme me këtë automjet:

- datë 13.9.2009, dalje nga pika kufitare Qafë Morinë;
- datë 14.1.2011, dalje nga pika kufitare Murriqan;
- datë 30.7.2011, dalje nga pika kufitare Qafë Botë;
- datë 20.7.2013, dalje nga pika kufitare Qafë Botë;
- datë 27.3.2015, dalje nga pika kufitare Murriqan;
- datë 16.1.2016, dalje nga pika kufitare Murriqan.

31.6. Gjithashtu, nga të dhënat e administruara nga sistemi TIMS rezultoi se pronari i automjetit I. A nuk ka kryer asnjë udhëtim jashtë vendit me automjetin me targa TR *** M.

31.7. Lidhur me përdorimin e këtij automjeti, në përgjigje të pyetësorit standard subjekti ka deklaruar se: *“Në disa raste, për periudha të ndryshme kohore nga viti 2009 e në vijim, kemi përdorur familjarisht automjetin Benz, pronë e vëllait të bashkëshortes F. R”.*

Ndërsa, në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021, subjekti ka sqaruar: *“Automjeti tip ‘M-B’, me targa TR *** M, pronë e vëllait të bashkëshortes I.A, është përdorur kryesisht në dispozicion të nënës së tij. Kjo ka qenë arsyeja kryesore për të cilën unë dhe bashkëshortja apo djali ynë E.R kemi përdorur automjetin, për t’i shërbyer znj. V.A sa herë kishte nevojë për vizita mjekësore, pushime në qytetin e Durrësit apo edhe në udhëtime jashtë shtetit me këtë automjet. Gjithashtu, ky automjet është përdorur prej meje dhe bashkëshortes në periudha të shkurtra kohore, sa herë që e kemi pasur të nevojshme dhe me mirëkuptim të pronarit. Ky automjet është përdorur brenda dhe jashtë Shqipërisë në disa raste. Fakti që nuk disponojmë aktualisht kontratë huapërdorjeje të këtij mjeti është marrëdhënia e posaçme familjare dhe mirëbesimi për përdorimin e tij. Vetë Kodi Rrugor nuk kërkon autorizimin për përdorimin e mjetit, kur*

²⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: leje qarkullimi nr. TR***, për automjet tip “M-B E*** CDI”, me targa TR*** M, në pronësi të shtetasit I.A.

²⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 24.9.2021, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.10.2021, e DPSHTRR-së.

drejtuesi nuk është pronar i tij. Nuk më rezulton e vërtetë që unë jam policëmbajtës i vetëm i policave të sigurimit për këtë automjet për periudhën 2008 e në vijim. Për këtë, kam mundur të siguroj kopje të policave të sigurimit që i përkasin viteve 2012, 2013, 2014, 2020 dhe 2021, të cilat jua vë në dispozicion”.

31.8. Subjekti ka depozituar:

- TPL-në nr. ***, datë 21.9.2012, në emër të shtetasve I.A dhe Shpëtim Reka;
- siguracion “Kartoni Jeshil” nr. ***, datë 18.7.2013, në emër vetëm të shtetasit I.A²⁹;
- TPL-në nr. ***, datë 30.6.2014, në emër të shtetasve I. A dhe Shpëtim Reka;
- kontratë sigurimi e kompanisë “I”, datë 13.1.2020, vetëm në emër të shtetasit I.A;
- kontratë sigurimi e kompanisë “I”, datë 31.3.2021, vetëm në emër të shtetasit I.A.

31.9. I pyetur nga Komisioni lidhur me të ardhurat e ligjshme të shtetasit I.A, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti, në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021, subjekti ka deklaruar se pronari i këtij automjeti, z. I.A është administrator dhe ortak i shoqërisë “M. I” sh.p.k., e themeluar nga 18.5.1994, si edhe ortak dhe administrator i shoqërisë “M.I.A”, e themeluar më 22.2.2000, prej të cilave, nëpërmjet punës së tij, prej vitesh ka siguruar të ardhura të ligjshme që kanë shërbyer edhe për blerjen e këtij automjeti.

Për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme të pronarit të automjetit I.A, subjekti ka paraqitur ekstrakte nga regjistri tregtar për shoqëritë e zotëruara nga ky shtetas.

31.10. Nga hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me të ardhurat e ligjshme të shtetasit I.A, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti, ka rezultuar si më poshtë vijon:

- a) Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me shkresën nr. *** prot., datë 22.10.2021, ka vendosur në dispozicion të Komisionit informacion, sipas të cilit shtetasi I. J.A ka punuar si:
 - inxhinier stazhier në Repartin Ushtarak G, për periudhën 17.8.1978 – 1.5.1979;
 - inxhinier mekanik teknik në Repartin Ushtarak G, për periudhën 1.7.1979 – 16.1.1986;
 - shef sektori armatim-municion, I.S.P.* Tiranë, për periudhën 17.1.1986 – 30.6.1992;
 - inxhinier mekanik, I.S.P.* Tiranë, për periudhën 1.7.1992 – 15.9.1992.
- b) Drejtorja e Arkivit Qendror ISSH, me shkresën nr. *** prot., datë 18.10.2021, sqaron se nuk mund të konfirmojë periudhën e kontributeve apo pagat për periudhën 1994 – 2012.
- c) Instituti i Sigurimeve Shoqërore, në shkresën nr. *** prot., datë 15.10.2021, ka paraqitur të dhënat mbi pagat bruto dhe pagat neto, si dhe kontributet e deklaruara nga punëdhënësi apo vetëpunësimi për shtetasin I.A për periudhën 2012 – gusht 2021.
Nga dokumentacioni i paraqitur nga ISSH-ja nuk evidentohen të ardhurat e përfituara nga shtetasi I.A nga punësimet e tij deri në momentin e blerjes së automjetit në datën 26.7.2006.
- d) Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve, përmes shkresës nr. ***prot., datë 21.10.2021, informon se shtetasi I.J.A rezulton të jetë:
 - aksioner me 25% dhe administrator i shoqërisë “M.I.A” sh.p.k. me NIPT K***, themeluar më 22.2.2000. DPT-ja informon gjithashtu për detyrimet në kohë reale dhe deklaratat e tatimit mbi fitimin për vitet 2002 - 2020;
 - administrator i subjektit “M.I” sh.p.k. me NIPT J***N, me status “pasiv” nga data 27.7.2012. DPT-ja informon gjithashtu për detyrimet në kohë reale dhe deklaratat e tatimit mbi fitimin për vitet 2002 - 2011;
 - shtetasi I.J.A është subjekt deklarimi individual i të ardhurave. DPT-ja ka vënë në dispozicion deklaratat individuale vjetore të të ardhurave për vitet 2012 - 2020 dhe ekstraktin historik të punonjësit.

²⁹ Nga sistemi TIMS rezulton që shtetasi I. A nuk ka udhëtuar jashtë vendit pas pajisjes me këtë siguracion. Ndërsa subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar jashtë vendit me këtë automjet në datën 20.7.2013, nga pika kufitare e Qafë Botës.

31.11. Nga hetimit rezulton se nuk u evidentuan të dhëna të mjaftueshme për të ardhurat e ligjshme të shtetasit I.A, të cilat kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti në datën 26.7.2006. Në përfundim, duke analizuar në harmoni provat e administruara gjatë hetimit, u konstatua se:

- i. Ky automjet është përdorur dhe zotëruar në vazhdimësi nga subjekti i rivlerësimit.
- ii. Në vazhdimësi ky automjet është përdorur për udhëtime jashtë vendit nga subjekti dhe familja e tij dhe asnjëherë nga pronari i tij I.A.
- iii. Subjekti ka vijuar të jetë policëmbajtës i policave të sigurimit për këtë automjet edhe pasi shtetasja V.A ka ndërruar jetë, pra në vitet 2016, 2017, 2018 dhe 2019, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit se automjeti është përdorur kryesisht në funksion të nevojave të kësaj shtetaseje, nuk qëndron.
- iv. Ky automjet është blerë nga shtetasi I.A në një vlerë gati 3-fish më të ulët se vlera e blerjes nga ish-pronari I. Z, vetëm 9 muaj më parë.

31.12. Si rrjedhojë e konstatimeve të mësipërme, Komisioni ngriti dyshimin e arsyeshëm se ky automjet ka qenë në zotërim të subjektit të rivlerësimit dhe jo thjesht i përdorur prej tij në periudha të shkurtra kohore dhe i kërkoi subjektit të japë shpjegime lidhur me këto konstatime.

31.13. Në shpjegimet e tij, subjekti u shpreh se ky automjet është pronë e vëllait të bashkëshortes, shtetasit I.A. Ai pohoi se automjeti është përdorur prej tij dhe bashkëshortes si brenda edhe jashtë vendit në periudha të shkurtra kohore, nga viti 2009 e në vijim.

31.14. Për të vërtetuar të ardhurat e ligjshme të pronarit të automjetit I.A, subjekti ka vënë në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm:

- Kontratë shitjeje pasurie të paluajtshme, datë 13.4.2002, përmes së cilës shtetasi I.A ka shitur pasuritë “apartament” me vlerë totale 8,200,000 lekë.
- Kontratë shitblerjeje pasurie të paluajtshme truall dhe objekt, datë 31.12.2005, përmes së cilës shtetasi I. A, së bashku me tre persona të tjerë, kanë blerë pasurinë “truall” me sip. 1100 m², si dhe pallatin e ndërtuar mbi të në vlerën 2 500 000 euro. Vërtetimi bankar për pagesën e vlerës 525,000.00 (pesëqind e njëzet e pesë mijë) euro nga shtetasi I.A.
- Vërtetim i regjistrimit në Regjistrin e Barrëve Siguruese, për periudhën e sigurimit 21.6.2002 – 21.6.2004, ku vërtetohet se shtetasi I.A (së bashku me tre bashkëpronarë të tjerë) përfitojnë qira mujore prej 2,500.00 (dymijë e pesëqind) USD/muaj nga kontrata e qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 12.9.2000, ndërmjet barrë dhënësve/qiradhënës dhe BKT-së.
- Leje ndërtimi për subjektin ndërtues “M.I.A” sh.p.k. Sipas subjektit, fillimi i punimeve në këtë objekt të ndërtuar në Kashar ka qenë edhe shkaku i blerjes së automjetit tip “M-B” nga shtetasi I.A.
- Akti noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 17.9.2009, “amendament nr. * i kontratës së qirasë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 22.5.2006”. Në këtë akt pasqyrohet fakti se midis palëve I.A etj., me cilësinë e qiradhënësit dhe V.A sh.a., me cilesinë e qiramarrësit, nga data 22.5.2006 e në vijim ekziston një marrëdhënie qiraje për pasurinë nr. **.
- Shkresë nr.***prot., datë 15.2.2022, nga Drejtoria Vendore e Policisë Durrës, ku konfirmohet se shtetasja V.A në datën 25.3.2015 ka udhëtuar me automjetin me targa TR *** M, në dalje të territorit të Republikës së Shqipërisë, në pikën kufitare të Murriqanit.

31.15. Në parashtrimet e tij, subjekti nuk ka dhënë shpjegime lidhur me konstatimin e Komisionit për përdorim dhe zotërimin e vazhdueshëm të këtij automjeti, por është përqendruar në dokumentimin e mundësive financiare të pronarit të automjetit për blerjen e tij.

31.16. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se duhet të kishte saktësuar në deklaratën *Vetting* faktin që ky automjet përdorej prej tij prej vitit 2009 e në vijim. Duke marrë në konsideratë se shtetasi I.A ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme, nuk ngrihen dyshime për fshehje pasurie për rrjedhojë dhe nëse ky automjet është në zotërim apo në

përdorim të subjektit është një pasaktësi e cila nuk mund të klasifikohet si shkak autonom për shkarkim.

32. Llogari bankare nr. * në “Alpha Bank”³⁰, me gjendje 16,819.87 lekë, e krijuar në datën 19.12.2006 në emër të bashkëshortes F. R dhe fëmijëve E dhe J. Reka**

32.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim për këtë llogari.

Hetimi³¹ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

32.2. Bazuar në shkresën e “Alpha Bank”, llogaria bankare në emër të shtetasve F, J dhe E. R rezulton me gjendje në datën 23.1.2017, në vlerën 16,819.87 lekë.

32.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari. Subjekti ka kryer deklaram të saktë në përputhje me ligjin, si dhe ka burime të ligjshme financiare në lidhje me këtë pasuri.

33. Depozitë³² nr. * në “Alpha Bank”, me vlerë 266,611.49 lekë, në emër të bashkëshortes F. R dhe fëmijëve E dhe J.R**

33.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim për këtë depozitë.

Hetimi³³ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

33.2. Nga nxjerrja e llogarisë në “Alpha Bank” rezulton se gjendja e depozitës në datën 23.1.2017 është 266,611.49 lekë.

33.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë depozitë.

34. Llogari nr. * në “Alpha Bank”, me gjendje 16,016.15 lekë, e krijuar në datën 27.11.2001 në emër të subjektit dhe të bashkëshortes**

34.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim për këtë llogari.

Hetimi³⁴ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

34.2. Nga nxjerrja e llogarisë në “Alpha Bank” rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është 16,016.15 lekë.

34.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

35. Llogari nr. * në “Alpha Bank”, me gjendje 658.51 euro, e krijuar në datën 18.8.2005, në emër të subjektit dhe të bashkëshortes**

35.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim për këtë llogari.

Hetimi³⁵ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

³⁰ Pasuri e deklaruar edhe nga e bija e subjektit J.R në deklaramin e saj.

³¹ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

³² Pasuri e deklaruar edhe nga e bija e subjektit J.R në deklaramin e saj.

³³ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

³⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

³⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

35.2. Nga nxjerrja e llogarisë në “Alpha Bank” rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është 658.5 euro.

35.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

36. Llogari nr. * në “Alpha Bank”, me gjendje 702.34 euro**

36.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim për këtë llogari.

Hetimi³⁶ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

36.2. Nga nxjerrja e llogarisë në “Alpha Bank” rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është 702.34 euro.

36.3 Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

37. Llogari nr. * në BKT, me gjendje 9 euro, në emër të bashkëshortes së subjektit**

37.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim për këtë llogari.

Hetimi³⁷ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

37.2. Nga nxjerrja e llogarisë në BKT rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është 9 euro.

37.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

38. Llogari rrjedhëse për lëvrim page në “Alpha Bank”, me gjendje 476 lekë, në emër të subjektit

38.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: llogari page.

Hetimi³⁸ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

38.2. Nga nxjerrja e llogarisë në “Alpha Bank” rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është 476 lekë.

38.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

39. Llogari rrjedhëse për lëvrim page në “Raiffeisen Bank”, me gjendje 86 lekë, në emër të bashkëshortes F.R

39.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: llogari page e bashkëshortes.

Hetimi³⁹ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

39.2. Nga nxjerrja e llogarisë në “Alpha Bank” rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është 86 lekë.

39.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

40. Llogari rrjedhëse për lëvrim page në “Tirana Bank”, me gjendje 0 (zero) lekë, në emër të bashkëshortes F.R

40.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: llogari page.

³⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.2.2020, e BKT-së.

³⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

³⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.1.2020, e “Raiffeisen Bank”.

Hetimi⁴⁰ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

40.2. Nga nxjerrja e llogarisë në “Alpha Bank” rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është 0 (zero) lekë.

40.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

41. Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar, në vlerat 7,000 euro dhe 100,000 lekë

41.1. Lidhur me gjendjen *cash*, Komisioni ka kryer verifikimet e deklaratave periodike vjetore të subjektit. Bazuar në këto deklarata, ka rezultuar se në DVP/2003 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në vlerën 1,000,000 lekë. Në deklaratimet vjetore të viteve 2004 - 2016 ka deklaruar në total shtesa dhe pakësime në vlerën 1,600,000 lekë. Si rezultat, është konstatuar mospërputhje e gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *Vetting* me atë të deklaruar ndër vite.

41.2. Lidhur me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021, subjekti ka sqaruar: *“Në DVP/2003 kam deklaruar si likuiditete vlerën prej 5,000 (pesë mijë) USD dhe 1,500,000 lekë. Këto likuiditete kanë qenë si në BKT, ‘Alpha Bank’ dhe në cash, pa u specifikuar konkretisht vlera në secilën prej tyre. Gjatë viteve 2004 – 2016 kam deklaruar në total shtesa apo pakësime për secilin vit, pa specifikuar faktin se këto kursime janë mbajtur në cash apo në bankat ku kemi patur llogaritë përkatëse. Dua të sqaroj se shumat e deklaruara si cash në banesë apo edhe në bankë janë shpenzuar ose shtuar me kursimet vjetore sipas rastit në çdo vit. Nga ana jonë në deklaratat vjetore, ashtu sikurse është konceptuar në atë periudhë se si funksiononte ai proces, kemi pasqyruar vlerën monetare që kemi mundur të kursejmë vetëm nga të ardhurat tona të vitit përkatës referues. Ndërsa vlerat që kishim deklaruar të kursyera ndër vite në DVP/2003 i kemi konceptuar se do llogariteshin me totalet dhe deklarimin e shpenzimeve nga autoriteti përgjegjës. Sa sipër, në referencë edhe të pyetjes tuaj, kursimet e para vitit 2003 janë konsumuar tërësisht për shpenzime të ndryshme për blerjen dhe kompletimin e banesës, përgjatë viteve, deri afërsisht vitit 2008 - 2009. Aktualisht konstatoj se ky fakt, si nga ana ime edhe e bashkëshortes, gabimisht, nuk është pasqyruar kryesisht në DVP/2004 dhe DVP/2005. Kjo situatë është saktësuar me deklaratën *Vetting*, ku nga ana jonë janë dhënë sqarime për likuiditetet e mbetura jashtë sistemit bankar. Deklarata *Veting*, në ndryshim nga deklaratimet e mëparshme, ka pasur të specifikuar vlerën e disponuar në secilën llogari bankare dhe në cash në banesë. Vlera e deklaruar në *Vetting* prej 7,000 euro rezulton afërsisht 980,000 lekë dhe është konvertuar gradualisht ndër vite, për shkak të udhëtimeve jashtë shtetit. Likuiditetet cash, se bashku me shumën e vlerave që ndodhen në banka sipas deklaratës *Vetting*, kanë një vlerë të përafërt me 1,380,000 lekë. Për sa sipër, vlera e mbetur nga mospërputhja e deklaratimeve është thjeshtë konsum, për arsye të ndryshme dhe të papërcaktuara”*.

41.3. Nga analiza e kryer nga Komisioni rezulton se të ardhurat e realizuara nga subjekti dhe familjaret e tij mundësojnë krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar.

42. Lidhur me pasuritë e deklaruara nga vajza e subjektit të rivlerësimit, znj. J. R

42.1. Apartament⁴¹ me sip. 57.1 m², ndodhur në NB F.Durrës, i regjistruar në ZVRPP-në Durrës me nr. pasurie ***, z. k. ***, me vlerë 13,000 euro. Apartamenti është blerë me kontratën nr. ***, datë 16.7.2015.

⁴⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Tirana Bank”.

⁴¹ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: (i) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 23.9.2015; (ii) deklaratë noteriale datë 19.9.2015, ku shtetasi E. H deklaroi se kësti i dytë prej 6,000 është depozituar në datën 17.9.2015 pranë “Alpha Bank” Durrës, në llogarinë e noteres M. N për tjetërsim pasurie; (iii) kontratë shitjeje me rezervë, datë 16.7.2015, me palë shitëse E.H dhe pale blerëse J.R, për blerje apartamenti me sip. 57.1 m²; (iv) depozitë në arkë në “Alpha Bank”, datë 16.7.2015, ku shtetasja J.R derdh shumën prej 7,000 euro për llogari të noteres M. N, për tjetërsim pasurie; (v) certifikatë për vërtetim pronësie, datë 22.8.2013, në emër të shtetasit E.H.

42.2. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kursimet e familjes së prindërve Shpëtim dhe F.R.

42.3. Konstatimi i ILDKPKI-së: vlerë e dyshimtë e blerjes së apartamentit me sip. 57.1 m², ndodhur në NB F.Durrës, nga vajza e subjektit në vitin 2015, në vlerën 13,000 euro, krahasuar me çmimet e tregut në qytetin e Durrësit në vitin 2015.

Hetimi⁴² dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

42.4. Me kontratën e shitjes me rezervë nr. ***, datë 16.7.2015, vajza e subjektit ka blerë nga shtetasi E.H apartamentin me sip. 57.1 m², me vendndodhje në lagjen “NB F” Durrës, me çmim 13,000 euro. Në datën 23.9.2015 shtetasja J.R është pajisur me certifikatë pronësie nga ZVRPP/ASHK Durrës.

Sipas përmbajtjes së kontratës së shitjes, çmimi i blerjes së apartamentit është 13,000 euro, nga i cili vlera prej 7,000 euro është likuiduar në datën e nënshkrimit të kontratës, ndërsa diferenca prej 6,000 euro do të likuidohet deri më 30.9.2015. Në kontratë citohej se në momentin e kryerjes së këtij transaksioni në apartament nuk janë kryer punime elektrike, hidraulike, shtrim i pllakave, vendosje dyersh e dritarësh dhe se blerësi merr përsipër që këto punime t’i realizojë me shpenzimet e tij.

42.5. Sipas mandateve bankare, bashkëlidhur kontratës së shitjes, rezultojnë se:

- Në datën 16.7.2015 shtetasja J.R ka derdhur në llogarinë bankare të noteres M. N në “Alpha Bank”, shumën 7,000 euro.
- Në datën 17.9.2015 shtetasja J.R ka derdhur në llogarinë bankare të noteres M. N në “Alpha Bank”, shumën 6,000 euro.

42.6. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar këtë pasuri në DVP/2015 në rubrikën “të dhëna konfidenciale”, me përshkrim “Është blerë apartamenti 1+1, me sip. 57 m², me vlerë 13,000 euro në emër të vajzës J.R”. Në deklarinë e këtij viti, subjekti deklaroi gjithashtu “pakësim të kursimeve familjare në vlerën 1,000,000 lekë”.

42.7. I pyetur nga Komisioni lidhur me shpenzimet e kryera nga vajza e subjektit për punimet e realizuara në apartament dhe momentin e kryerjes së këtyre punimeve/shpenzimeve, si dhe vlerës së shpenzuar për mobilimin e tij, subjekti ka sqaruar: *“Punimet për rregullimin dhe përshtatjen e këtij apartamenti për banim janë kryer gjatë periudhës maj – dhjetor 2019. Punimet kanë filluar pas lejes përkatëse të miratuar nga Bashkia Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 19.4.2019. Punimet e brendshme dhe më pas mobilimi janë bërë nga ana jonë dhe nga vajza J. R bashkërisht me të fejuarin e saj. Apartamenti është bërë i banueshëm rreth muajit maj - qershor 2020. Vajza J.R është larguar nga banesa prindërore në muajin korrik 2020, pas celebrimit me shtetasin B.E. Apartamenti përdoret për banim nga vajza J, bashkëshorti i saj B dhe djali, i datëlindjes 5.10.2020. Vlera e përafërt për instalimet elektrike, hidraulike, dyer, shtrim dhe mobilim, e shpenzuar prej nesh dhe vajzës J. R gjatë vitit 2019, është në shumën rreth 700,000 lekë”.*

42.8. Për të provuar deklarinë e tij në lidhje me punimet e kryera gjatë vitit 2019 dhe vlerën e tyre, subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit dokumentacionin si vijon:

- kopje të shkresës nr. ***, datë 19.4.2019, të Bashkisë Durrës në lidhje me kërkesën për njoftim punimesh;
- kopje të faturave përkatëse në lidhje me shpenzimet për blerjen e pajisjeve të instalimeve elektrike, instalimeve dhe pajisjeve hidraulike, dyer të brendshme, pllaka dhe parket.

⁴² Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.202, drejtuar ASHK-së Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.9.2021, e ASHK-së Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar UKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. ** prot., datë 23.1.2020, e UKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar FSHU-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.1.2020, e FSHU-së; shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2021, drejtuar FSHU-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.10.2021, e FSHU-së.

Subjekti deklaron se vlera totale e materialeve dhe pajisjeve elektrike, hidraulike, pllaka, parket, dyer të brendshme dhe vetratë durali, sipas faturave të bashkëlidhura, është përafërsisht 580,000 lekë;

- fotografi që tregojnë gjendjen e apartamentit gjatë kryerjes së punimeve dhe kohën e kryerjes së tyre.

42.9. Komisioni kreu analizën financiare për blerjen e këtij apartamenti, nga e cila rezultoi se vajza e subjektit dhe familjarët e saj kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e kësaj pasurie.

Në përfundim, bazuar në sa më lart, Komisionit i rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të kësaj pasurie, në përputhje me ligjin nr. 84/2016.

43. Llogari bankare⁴³ nr. * në “Alpha Bank”, me gjendje në datën 23.12.2016, në vlerën 5,835 lekë, e personit fizik “J.R”**

43.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim për këtë llogari.

Hetimi⁴⁴ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

43.2. Bazuar në shkresën e “Alpha Bank”, gjendja e kësaj llogarie në datën e depozitimit të deklaratës *Vetting* (23.1.2017) rezulton në vlerën 5,835 lekë.

43.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

44. Llogari bankare⁴⁵ nr. * në “Alpha Bank”, me gjendje në datën 23.12.2016, në vlerën 72.11 lekë, në emër të shtetases J. R**

44.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burim për këtë llogari.

Hetimi⁴⁶ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

44.2. Gjendja e kësaj llogarie në datën e depozitimit të deklaratës *Vetting* rezulton në vlerën 72.11 lekë.

44.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

45. Llogari rrjedhëse⁴⁷ nr. * në “Credins Bank”, me gjendje në datën 23.12.2016, në vlerën 1,142 lekë, në emër të shtetases J.R**

Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

45.1. Gjendja e kësaj llogarie në datën e depozitimit të deklaratës *Vetting* rezulton në vlerën 1,142 lekë.

45.2. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

46. Depozitë⁴⁸ nr. * në “Credins Bank”, me gjendje në datën 4.1.2017, në vlerën 500.05 lekë, në emër të shtetases J.R**

⁴³ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës nxjerrje llogarie datë 23.12.2016, e “Alpha Bank” për “J.R”, person fizik.

⁴⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

⁴⁵ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogarie “Alpha Bank”, datë 23.12.2016, për J.R; shkresë nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

⁴⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

⁴⁷ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogarie “Credins Bank”, datë 23.12.2016, për J.R; shkresë nr. *** prot., datë 26.2.2020, e “Credins Bank”.

⁴⁸ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogarie “Credins Bank”, datë 4.1.2017, për J.R.

Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

46.1. Gjendja e kësaj depozite në datën e depozitimit të deklaratës *Vetting* rezulton në vlerën 500.05 lekë.

46.2. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

47. Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në vlerën 5,000 lekë

47.1. Nga analiza e kryer nga Komisioni rezulton se të ardhurat e realizuara nga vajza e subjektit mundësojnë krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar.

48. Hetimi⁴⁹ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni lidhur me aktivitetin tregtar të shtetasës J.Reka

48.1. Qendra Kombëtare e Biznesit konfirmon regjistrimin e “J.R” si person fizik, me NIPT L***B, me datë regjistrimi 25.8.2015 dhe fushë veprimtarie “tregti me pakicë e produkteve kozmetike” dhe vend të ushtrimit të aktivitetit Lagjia nr. *, rruga “S”, Durrës.

48.2. DRT-ja Durrës informon se shtetasja J.R rezulton e regjistruar me NIPT L***B. Nga verifikimet e kryera nga ky institucion rezulton se ky tatimpagues ka deklaruar si më poshtë vijon:

- Për periudhën 15-A: të ardhura 491,199 lekë, shpenzime 582,946 lekë, humbje 91,747 lekë.
- Për periudhën 16-A: të ardhura 879,614 lekë, shpenzime 1,671,969 lekë, humbje 792,355 lekë.
- Nga data 23.12.2016 ky subjekt rezulton i pezulluar dhe nuk rezultojnë detyrime të pashlyera ndaj DRT-së.

48.3. ISSH-ja konfirmon kontribute të paguara mbi pagën nga shtetasja J.R, për periudhën gusht 2015 – gusht 2021.

48.4. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me aktivitetin tregtar të vajzës së subjektit të rivlerësimit J.R.

49. Lidhur me pasuritë e deklaruara nga djali i subjektit të rivlerësimit, z. E.R

49.1. Apartament⁵⁰ me sip. 51 m², ndodhur në Lagjen nr. **, Durrës, me vlerë të papërcaktuar. Pjesa takuese: 100%.

49.2. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: kjo pasuri është fituar me anë të dëshmisë së trashëgimisë testamentare nr. *** rep., nr. *** kol., të testamentlënësës V.A (gjyshja nga ana e nënës), me datë 11.5.2016. Testamenti i regjistruar me nr. regj. **, datë 31.7.2008.

Hetimi⁵¹ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

49.3. Nëna e bashkëshortes së subjektit, me kontratën e shitblerjes nr. ***, datë 5.6.2008, ka blerë nga shoqëria “K” sh.p.k. apartamentin me sip. 51 m², ndodhur në Lagjen nr. ** Durrës,

⁴⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.10.2021, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2021, e ISSH-së; shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar DPT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.1.2020, e DRT-së Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar QKB-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.1.2020, e QKB-së.

⁵⁰ Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës: certifikatë për vërtetim pronësie me nr. pasurie ***/ND+*-** dhe kartelë pasurie; testament nr. ** regj., datë 31.7.2008, e testatorës V. A.

⁵¹ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.6.2020, e ASHK-së Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 5.10.2021, drejtuar Agjencisë Shtetërore të Kadastrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.1.2021, e ASHK-së Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar UKT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 23.1.2020, e UKT-së; shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar OSHEE-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.1.2020, e OSHEE/FSHU; shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2021, drejtuar FSHU-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.10.2021, e FSHU-së.

për çmimin 3,450,000 lekë. Sipas përcaktimeve të kontratës së shitjes, kjo shumë është likuiduar plotësisht jashtë zyrës noteriale. Apartamenti rezulton të jetë regjistruar në ASHK, në pronësi të blerëses V.A, në datën 16.6.2008.

49.4. Një muaj nga regjistrimi i kësaj pasurie në ASHK në datën 31.7.2008, shtetasja V. A, me anë të testamentit nr. ** regj., i ka lënë djalit të subjektit të rivlerësimit këtë apartament. Pas vdekjes së saj në datën 25.5.2015, djali i subjektit E.R ka kërkuar lëshimin e “dëshmisë së trashëgimisë testamentare dhe ligjore” për trashëgimlënësen, bazuar në procesverbalin noterial nr. *** rep., nr. *** kol., datë 11.5.2016.

49.5. Në datën 11.5.2016 noterja M. N ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë testamentare dhe ligjore nr. *** për trashëgimlënësen V.A, duke përcaktuar si trashëgimtar të vetëm testamentar z. E.R, i cili trashëgoi apartamentin me sip. 51 m², me nr. pasurie ***, regjistruar në ZVRPP-në Durrës në datën 31.8.2008.

Referuar përmbajtjes së dëshmisë së trashëgimisë testamentare dhe ligjore, rezulton se përmes testamentit të datës 28.1.1999 trashëgimlënësja V.A ka caktuar si trashëgimtar testamentar bashkëshortin e saj J.A, duke i lënë ½ pjesë të apartamentit të tyre në rrugën “A.F”. Duke qenë se shtetasi J.A ka ndërruar jetë përpara trashëgimlënësës V.A, si i paravdekur në raport me trashëgimlënësen, bazuar në nenet 374 dhe 320 të Kodit Civil, ai nuk ka pasur zotësi për të trashëguar dhe për të fituar me testament. Për pasojë, për pasurinë e disponuar me testament në favor të J.A është zbatuar trashëgimia ligjore. Në këto kushte, e vetmja pasuri e disponuar me testament nga e ndjera V.A rezulton të jetë apartamenti në Lagjen nr. **, Durrës.

49.6. Duke qenë se ky apartament është blerë në vitin 2008 nga nëna e bashkëshortes së subjektit gjatë periudhës që subjekti dhe bashkëshortja kanë kryer detyrën e gjyqtarit dhe prokurores, duke marrë në konsideratë faktin se ky apartament, gati një muaj pas blerjes dhe regjistrimit nga e ndjera V.A i është lënë me testament djalit të subjektit, duke përjashtuar nga trashëgimia fëmijët e saj, Komisioni ka kryer një hetim të plotë në lidhje me aftësinë financiare të kësaj shtetaseje bazuar në dyshimin e arsyeshëm se kemi të bëjmë me një pasuri të fshehur të subjektit.

A) Në lidhje me të ardhurat e ligjshme të znj. V.A

49.7. ISSH-ja informon se znj. V.A ka përfituar pension pleqërie për periudhën shkurt 1983 – 2015, në masën mujore 21,087 lekë dhe pension suplementar për periudhën korrik 2009 – maj 2015, në masën mujore 7,959 lekë. Ndërsa Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informon se znj. V.A dhe bashkëshorti i saj J.A nuk rezultojnë të kenë pasur aktivitet ekonomik të regjistruar në emër të tyre.

49.8. Lidhur me të ardhurat e ligjshme të znj. V.A, në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021, subjekti ka deklaruar: *“Fakti që nëna e bashkëshortes V.A ka lënë testament në lidhje me këtë pasuri, dëshmon një nga të drejtat e ligjshme të çdo shtetasi për të disponuar pasurinë me testament. [...] mendoj se edhe vetë data e përpilimit të testamentit të dytë prej saj, data 31 korrik, që përkon me datën e lindjes së djalit E.R, shpreh qartë se ajo ka dashur t'i bëjë nipit E.R jo vetëm një testament, por më tepër një dhuratë në ditën e lindjes së tij, sikurse ka vepruar edhe me fëmijët e tjerë të familjes, në forma të ndryshme. Nëna e bashkëshortes aktualisht ka ndërruar jetë dhe ne nuk mund të dimë saktësisht dëshirat e saj, apo ‘cila ka qenë arsyeja e blerjes së një pasurie të paluajtshme në qytetin e Durrësit në moshën 76 vjeç ndërkohë që ishte me banim në Tiranë’, por di të them se këtë apartament ajo e shfrytëzoi për të pushuar gjatë periudhës së verës deri në gjallinë e saj. Apartamenti në fjalë nuk është përdorur dhe as përdoret nga djali dhe as nga pjesëtarët e tjerë të familjes time [...]. Në lidhje me mënyrën e ligjshme të krijimit të kësaj pasurie nga ana e nënës së bashkëshortes time, dua të shpjegoj se prindërit e saj, gjatë gjithë jetës së tyre, kanë jetuar në mënyrë të thjeshtë dhe të ndershme, në të njëjtën banesë 4+1 që nga viti 1965. Ata, pas daljes në pension, kanë pasur të ardhura të mjaftueshme për të jetuar normalisht. Aktualisht, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, me*

shkresën nr. *** prot., datë 23.8.2019, jemi vënë në dijeni në lidhje me pensionet që prindërit e bashkëshortes J.A dhe V.A kanë përfitur në periudhën nga viti 1995 deri në datën e ndërrimit të jetës. Gjithashtu, dua të shpjegoj se nëna e bashkëshortes V.S.A (N) ka lindur në L të Francës në vitin 1932, gjatë kohës që familja e saj ka qënë në emigracion. Ajo, së bashku me trashëgimtarët e tjerë, kanë trashëguar nga i ati S. N një pasuri me vendndodhje në D, L, Francë, e cila u ka siguruar të ardhura qiraje për vite të tëra, deri në momentin e shitjes (pas vitit 1998). Aktualisht, të gjithë trashëgimtarët e radhës së parë të gjyshit nga nëna, e bashkëshortes, z. S.N, kanë ndërruar jetë vite më parë, ndaj bashkëshortja dhe unë nuk kemi dijeni të saktë për pronat që znj. V.A dhe motra e vëllezërit e saj kanë disponuar [...]. Me sa kam dijeni, këto prona janë shitur pas vitit 1998 dhe përpara vitit 2000, për rrjedhojë, nëna e bashkëshortes V.A si trashëgimtare ka përfitur të ardhura. Nuk kemi asnjë dokument që lidhet me shitjen apo shumat e përfituara prej saj, sepse në atë kohë bashkëshortja nuk ishte ende trashëgimtare ligjore e prindërve”.

49.9. Për të vërtetuar sqarimet e dhëna në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021, subjekti ka paraqitur:

- shkresë nr. *** prot., datë 23.8.2019, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, përmes së cilës vërtetohen të ardhurat nga pensioni i pleqërisë së të ndjerës V.A për periudhën 1.1.1995 – 25.5.2015;
- certifikatë vdekjeje e znj. V.A dhe dëshmi trashëgimie nr. ***, datë 22.3.1994, për trashëgimlënësin S.N, ku nëna e bashkëshortes se subjektit V.A është përcaktuar si trashëgimtare e ¼ pjesë të pasurisë trashëgimore;
- prokurë e posaçme nr. *** rep., nr. ***kol., datë 25.3.1994, me anë të së cilës trashëgimtarët e S.N, ndërmjet të cilëve edhe nëna e bashkëshortes së subjektit V.A, kanë autorizuar z. C.Dh, banues në Francë, për të kryer të gjitha veprimet për shitjen e shtëpisë që kanë pasur trashëgim nga i ati S.N, e cila ndodhet në Francë;
- pasqyrë e llogarive për pagesat e qirave për periudhën 1.1.1998 – 4.6.1998;
- pasqyrë e administratorit të ndërtesave për ndërtesën *** J,***A.J.J, *** D, e titulluar “H Q” për periudhën 1.1.1998 – 4.6.1998”;
- korrespondenca të vitit 1998 të z. K.N (trashëgimtar i S.N) me noterin C, përmes së cilës njoftohet dërgimi i dokumentacionit të nevojshëm për shitjen e pronës së shtetasit S.N në D dhe marrjen e masave për të dorëzuar shumat e qirave të vitit 1996 tek përfaqësuesi i trashëgimtarëve, z. C.Dh, si dhe të përfaqësimit të interesave të trashëgimtarëve.

Nga analizi i dokumentacionit të dërguar nga subjekti i rivlerësimit për të vërtetuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të nënës së bashkëshortes për blerjen e apartamentit, rezulton se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me të ardhurat e përfituara nga e ndjera V.A nga shitja apo qiradhënia e pasurisë së trashëguar nga babai i saj S.N.

49.10. Bazuar në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ, si dhe në përgjigjet e subjektit, Komisioni kreu analizën financiare për blerjen e apartamentit nga nëna e bashkëshortes. Në analizë janë marrë në konsideratë të ardhurat e saj të dokumentuara deri në datën e blerjes së apartamentit. Shpenzimet jetike janë konsideruar ato për dy persona deri në vitin 2000, e më pas për një person, pasi në këtë vit bashkëshorti i znj. V.A ka ndërruar jetë.

Tabela nr. 7

	Periudha 31.12.1994 – 31.12.2004	Periudha 1.1.2005 – 5.6.2008
Pasuria	2,183,688.81	2,358,588.93
Apartament (blerë pjesë takuese më 6.12.2000)	600,000.00	
Apartament	0.00	3,450,000.00
Shtesë në apartament		479,978.00
Detyrime	0.00	0.00

Pasuria neto	2,183,688.81	2,358,588.93
Të ardhura	924,892.00	367,484.00
Të ardhurat nga pensioni i pleqërisë 1983 – 2015	410,718.00	367,484.00
Të ardhurat e bashkëshortit	514,174.00	0.00
Shpenzime	764,910.22	389,822.00
Shpenzime jetike	764,910.22	389,822.00
TIMS	0.00	0.00
Mundësia për kursim	-440,018.22	-3,952,316.00
Mundësia kumulative për kursim	-440,018.22	-4,392,334.22

49.11. Nga analiza financiare rezulton se nëna e bashkëshortes se subjektit nuk ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme në shumën 4,392,334.22 lekë, për blerjen e apartamentit.

B) Në lidhje me përdorimin e apartamentit nga znj. V.A

49.12. UKD-ja informon se shtetasi E. Shpëtim.R disponon kontratë për furnizimin me ujë të pijshëm nr. ***, për pasurinë me vendndodhje “Shkëmbi i Kavajës”, e lidhur në datën 26.1.2018.

49.13. FSHU-ja informon se shtetasi E.Shpëtim.Reka disponon kontratë për furnizimin me energji elektrike për pasurinë me vendndodhje “Shkëmbi i Kavajës”.

Sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga FSHU-ja rezulton se në datën 23.5.2017 shtetasi E.R ka paraqitur kërkesë për ndryshim të emrit të abonentit nga V.A në emrin e tij.

Nga verifikimi i historikut të pagesave rezulton se nga momenti i lidhjes së kontratës së furnizimit me energji elektrike (korrik 2008) e deri në shtator të vitit 2020 është paguar vetëm tarifa bazë në vlerën 340 lekë, fakt që provon se ky apartament nuk rezulton të jetë përdorur nga nëna e bashkëshortes së subjektit.

C) Në lidhje me hetimin e kryer nga Komisioni mbi gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit

49.14. Komisioni ka mbajtur korrespondencë⁵² me institucionet punëdhënëse të subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, të cilët, në përgjigjet e tyre, informojnë si më poshtë vijon:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës informon se nga verifikimi i kryer rezultojnë 7 (shtatë) çështje gjyqësore të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, me palë ndërgjyqëse “K” sh.p.k. Këto çështje gjyqësore datojnë nga viti 2011 e në vijim, si vijon:

- i. Çështja gjyqësore me paditës shoqërinë “K” sh.p.k., me objekt “marrje e masës së sigurimit të padisë” për bllokimin e anijes “G*”, regjistruar në datën 8.3.2011. Me vendimin datë 8.3.2011 subjekti i rivlerësimit ka vendosur “pranimin e kërkesës së paditësit”. Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur “ndryshimin e vendimit dhe rrëzimin e kërkesës së paditësit ‘K’ sh.p.k.”.
- ii. Çështja gjyqësore me paditës shoqërinë “K” sh.p.k., të paditur “Z.g.F.K.T” sh.a., me objekt “detyrimi i të paditurit t’i paguajë paditësit shumën prej 60,000 dollarësh amerikanë dhe marrjen e masës për sigurimin e padisë, duke bllokuar anijen e të paditurit”, regjistruar në datën 23.3.2011. Me vendimin datë 1.12.2011 subjekti i

⁵² Shkresë nr. *** prot., datë 5.10.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 8.10.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; shkresë nr. *** prot., datë 20.10.2021, drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.10.2021, e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

rivlerësimin ka vendosur “pushimin e gjykimit”, për shkak se paditësi nuk është paraqitur në seancë gjyqësore.

- iii. Çështja gjyqësore me kërkues Drejtoria Rajonale e Inspektoratit të Punës Durrës, me objekt “lëshimi i urdhrin të ekzekutimit për vendimin me gjobë në masën 100,000 lekë ndaj kundërvajtësit ‘K’ sh.p.k.”, regjistruar në datën 19.12.2012. Me vendimin datë 26.12.2012 subjekti ka vendosur “rrezimin e kërkesës”, për shkak se vendimi për dënimin me gjobë nuk i është komunikuar subjektit në fjalë.
- iv. Çështja gjyqësore me paditës A, L e Y.K dhe të paditur shoqërinë “K” sh.p.k., me objekt “detyrimin e të paditurit të dorëzojë pasuritë e përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes, të kryejë regjistrimin e tyre në regjistrat hipotekorë në emër të paditësve etj.”, regjistruar në datën 5.11.2014. Në këtë gjykim subjekti ka pasur cilësinë e kryesuesit të trupës gjyqësore, e cila, me vendimin datë 10.3.2017, ka vendosur “rrezimin e kërkesëpadisë” si të pambështetur në prova dhe në ligj. Ky vendim rezulton të jetë prishur nga Gjykata e Apelit Durrës.
- v. Çështja gjyqësore me kërkues “S.P.D”, me objekt “emërim përfaqësuesi ligjor për shoqërinë ‘K’ sh.p.k.”, regjistruar në datën 23.4.2020. Me vendimin datë 22.7.2020 subjekti ka vendosur “pushimin e gjykimit të çështjes”, pasi kërkuesi nuk është paraqitur në seancë gjyqësore.
- vi. Çështja gjyqësore me paditës B, M e R.L dhe të paditur shoqëria “K” sh.p.k., me objekt “shpërblim dëmi pasuror shkaktuar nga mospërbushja në afat e detyrimit kontraktual, sipas kontratës së sipërmarrjes”, regjistruar në datën 13.11.2017. Me vendimin datë 12.4.2019, subjekti ka vendosur “rrezimin e kërkesëpadisë”.
- vii. Çështja gjyqësore, me objekt “sigurim padie, lirim dhe dorëzim sendi” me palë paditëse shoqëria “K” sh.p.k., e cila aktualisht është në shqyrtim nga subjekti i rivlerësimit.

49.15. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës⁵³ informon se nga verifikimi i kryer rezulton se kjo prokurori ka regjistruar procedimin penal nr. ***, datë 1.6.2016, në lidhje me shtetasin R.K. Në datën 3.6.2016 ky procedim i ka kaluar me vendim zëvendësimi bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, e cila ka paraqitur memorie, duke kërkuar që çështja të hetohet nga një tjetër prokuror. Me vendimin datë 27.7.2016 është vendosur zëvendësimi i prokurorit.

49.16. Nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se:

- a. Në datën 21.11.2011 subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar së bashku me shtetasin R.K, administrator i shoqërisë “K” sh.p.k., me automjetin me targa AA***AL të regjistruar në pronësi të këtij shtetasi, ndërkohë që nga data 23.3.2011 po gjykonte çështjen gjyqësore me paditës shoqërinë “K” sh.p.k. dhe të paditur “Z.g.F.K.T” sh.a., me objekt “detyrimi i të paditurit t’i paguajë paditësit shumën prej 60,000 dollarësh amerikanë dhe marrjen e masës për sigurimin e padisë, duke bllokuar anijen e të paditurit”, për të cilën në datën 1.12.2011 ka vendosur “pushimin e gjykimit”, për shkak se paditësi nuk është paraqitur në seancë gjyqësore.
- b. Në datën 27.9.2015 subjekti ka udhëtuar së bashku me shtetasin R.K, administrator i shoqërisë “K” sh.p.k., me automjetin me targa AA *** CU të regjistruar në pronësi të këtij shtetasi, ndërkohë që nga data 5.11.2014 po gjykonte çështjen gjyqësore me paditës A, L e Y. K dhe të paditur shoqërinë “K” sh.p.k., me objekt “detyrimin e të paditurit të dorëzojë pasuritë e përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes, të kryejë regjistrimin e tyre në regjistrat hipotekorë në emër të paditësve etj.”. Në këtë gjykim subjekti ka pasur cilësinë e

⁵³ Shkresë nr. *** prot., datë 29.9.2021, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.10.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

kryesuesit të trupës gjykuese, e cila, me vendimin datë 10.3.2017, ka vendosur “rrezimin e kërkesëpadisë” si të pambështetur në prova dhe në ligj. Ky vendim rezulton të jetë prishur nga Gjykata e Apelit Durrës.

49.17. Nga dokumentacioni i administruar rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kryer udhëtime jashtë vendit me administratorin e shoqërisë “K” sh.p.k. gjatë kohës që këtë shtetas e ka pasur palë ndërgjyqëse në çështje të ndryshme gjyqësore.

49.18. Në përfundim në lidhje me këtë apartament, konstatohet se: (i) znj. V.A nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e pasurisë apartament; (ii) znj. V.A e ka blerë këtë apartament në datën 5.6.2008 dhe në datën 31.7.2008 ka përpiluar testament në favor të nipit të saj E.R, një muaj pas blerjes së tij, duke përjashtuar nga trashëgimia të gjithë trashëgimtarët e saj ligjorë; (iii) znj. V.A ka banuar vazhdimisht në Tiranë dhe ka qenë në moshën 76-vjeçare në kohën e blerjes së apartamentit, duke mbetur e paqartë arsyeja e investimit në një pasuri të paluajtshme në qytetin e Durrësit; (iv) subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij jetojnë në Durrës; (v) sipas dokumentacionit të administruar nga FSHU-ja, rezulton se në këtë apartament ka pasur konsum energjie nga muaji shtator 2020 e në vijim, pra pasi znj. V.A ka ndërruar jetë, për rrjedhojë, deklarimi i subjektit se e ndjera e ka shfrytëzuar këtë apartament për të pushuar në muajt e verës, nuk qëndron; (vi) subjekti ka gjykuar disa çështje ku palë ka qenë shoqëria “K” sh.p.k. nga viti 2011 e në vijim dhe nga shqyrtimi i të cilave rezulton që vendimmarrja e subjektit të ketë qenë në çdo rast në favor të shoqërisë “K” sh.p.k. apo administratorit/ortakut të saj; si dhe (vii) subjekti ka udhëtuar së bashku me administratorin e shoqërisë “K” sh.p.k. R.K, me automjetet në pronësi të këtij të fundit, pavarësisht se e kishte palë në gjykim.

49.19. Si rrjedhojë e konstatimeve të mësipërme, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës, bazuar në dyshimin e arsyeshëm se kjo pasuri ka qenë në pronësi të fshehur të tij dhe se subjekti ka gjykuar çështjet gjyqësore me palë shoqërinë “K” sh.p.k. apo administratorin e saj, në kushtet e konfliktit të interesit.

49.20. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti pretendoi së përmes dokumentacionit të depozituar gjatë hetimit, ka provuar në mënyrë indirekte faktin se znj. V.A ka trashëguar pasuri të paluajtshme në shtetin francez. Ai konfirmon se nuk disponon asnjë dokument që lidhet me shitjen dhe shumat e përfituara prej saj. Subjekti sqaron se përmes provave të paraqitura është provuar se në banesën e trashëguar kanë jetuar persona deri në momentin e shitjes dhe janë paguar qira ndër vite. Ai pretendon se janë dokumentuar të ardhura nga qiraja në vlerën totale 19,571.83 franga.

Lidhur me arsyen e disponimit të kësaj pasurie përmes testamentit nga djali i subjektit E.R, subjekti shpjegon se djali i tij ka fituar pronësinë e kësaj pasurie në mënyrë të ligjshme dhe se znj.V.A gjatë jetës së saj i ka trajtuar nipat dhe mbesat në mënyrë të barabartë.

Për të provuar këtë fakt, ai ka vënë në dispozicion të Komisionit deklarata noteriale të nënshkuara nga mbesat e znj. V.A, të cilat shprehen lidhur me dhuratat e ndryshme që kanë marrë nga gjyshja e tyre.

Lidhur me konstatimin e Komisionit se në këtë apartament nuk ka pasur konsum energjie nga ana e znj. V.A, subjekti ka paraqitur librezën e pagesave të energjisë elektrike në emër të kësaj shtetaseje. Në këtë librezë janë pasqyruar pagesat e kryera për konsumin e energjisë elektrike nga prilli i vitit 2009 deri në dhjetor të vitit 2014, ku evidentohen pagesat në vijim: maj 2009 në vlerën 240 lekë; qershor 2009 në vlerën 8821,600 lekë; korrik 2009 në vlerën 1,066 lekë; gusht 2009 në vlerën 1,008 lekë; shtator 2009 në vlerën 756 lekë; tetor 2009 e në vijim në vlerën 240 lekë; korrik 2010 në vlerën 267 lekë; gusht 2010 në vlerën 1,071 lekë; shtator 2010 e në vijim tarifa bazë.

Lidhur me konstatimin se subjekti ka gënjyer shoqërinë “K” sh.p.k. në kushtet e konfliktit të interesit, subjekti ka argumentuar se znj. V.A e ka blerë apartamentin nga shoqëria “K” sh.p.k. në datën 5.6.2008, ndërsa gjykimet e zhvilluara prej tij me palë ndërgjyqëse këtë shoqëri, datojnë nga viti 2011 e në vijim. Ai pretendon se blerja e apartamentit dhe i ashtuquajtura “konflikt interesi” nuk ekzistojnë në të njëjtën kohë dhe as nuk janë të lidhura në logjikën që parashtron konstatimi.

49.21. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se, pasi shqyrtoi përmbajtjen e akteve shkresore të administruara në proces, arriti në konkluzionin se subjekti dështoi të provojë të gjitha faktet e deklaruara prej tij në lidhje me këtë çështje. Nga analiza e të dhënave që rezultuan prej akteve të administruara, konstatohet se ka gjurmë që tregojnë se:

- znj. V.A ka trashëguar pasuri të paluajtshme në Francë;
- këto pasuri të paluajtshme janë dhënë me qira, duke përfutur edhe të ardhura të cilat nuk janë dokumentuar plotësisht;
- bashkëpronarët e këtyre pasurive kanë shprehur vullnetin për t’i shitur ato.

Këto fakte provohen nga prokura e posaçme nr. *** rep., nr. *** kol., datë 25.3.1994, pasqyra e llogarive për pagesat e qirave për periudhën 1.1.1998 – 4.6.1998, pasqyra e administratorit të ndërtesave për ndërtesën *** J, *** A.J.J, *** D, e titulluar “H.Q” për periudhën 1.1.1998 – 4.6.1998”, korrespondenca e vitit 1998 të z. K.N (trashëgimtar i z. S. N) me noterin C, përmes së cilës njoftohet dërgimi i dokumentacionit të nevojshëm për shitjen e pronës së z. S.N në D dhe marrjen e masave për të dorëzuar shumat e qirave të vitit 1996 tek përfaqësuesi i trashëgimtarëve Ch.Dh, si dhe përfaqësimin e interesave të trashëgimtarëve. Bazuar në dokumentacionin e mësipërm, në mënyrë indirekte provohet që znj. V.A mund të ketë përfutur të ardhura nga këto pasuri, por që nuk mund të përfshihen në analizë financiare, për sa kohë nuk është arritur të provohet shuma e përfutur, si dhe pagimi i detyrimeve tatimore. Për rrjedhojë, nuk provohet burimi i ligjshëm i të ardhurave të znj. A për blerjen e kësaj pasurie. Komisioni, duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, provat indirekt në lidhje me të ardhurat e mundshme të znj. V. A, si dhe faktin që burimi primar i kësaj pasurie është trashëgimia, vlerëson se nuk jemi përpara një pasurie të fshehur.

Në konkluzion të kësaj analize, Komisioni arrin në përfundimin se pasuria “apartament” afektohet në ligjshmërinë e burimeve të krijimit të saj për shkak të defektit të mungesës së burimeve të ligjshme, duke e vlerësuar të konsiderojë peshën e këtij defekti në drejtim të ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së djalit të subjektit, në përfundim të kontrollit të kriterit të pasurisë në të gjitha elementet e tij.

Lidhur me konfliktin e interesit me shoqërinë “K” sh.p.k., ai është trajtuar gjerësisht në pikën 64 të këtij vendimi.

50. Llogari rrjedhëse nr. AL* në “Alpha Bank”, me gjendje në datën 23.12.2016, në vlerën 256.74 lekë, në emër të djalit të subjektit E.R**

50.1. Burimi sipas deklaratës Vetting: subjekti nuk ka deklaruar burim për këtë llogari.

Hetimi⁵⁴ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

50.2. Nga nxjerrja e llogarisë në “Alpha Bank” rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është në vlerën 256.74 lekë.

50.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

51. Llogari nr. AL* në “Alpha Bank”, me gjendje në datën 23.12.2016, në vlerën 16,595.60 lekë, e personit fizik “E.R”**

⁵⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

51.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti nuk ka deklaruar burim për këtë llogari.

Hetimi⁵⁵ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

51.2. Nga nxjerrja e llogarisë së personit fizik në “Alpha Bank” rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është në vlerën 16,595.60 lekë.

51.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

52. Llogari bankare nr. * AGJ I, në BKT, me gjendje në datën 23.12.2016 në vlerat 6,392 lekë dhe 167.60 euro, në emër të djalit E.R**

52.1. Burimi sipas deklaratës *Vetting*: subjekti nuk ka deklaruar burim për këtë llogari.

Hetimi dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni

52.2. Nga nxjerrja e llogarisë së personit fizik në “Alpha Bank” rezulton se gjendja në datën 23.1.2017 është në vlerën 167.60 euro.

52.3. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me këtë llogari.

53. Hetimi⁵⁶ dhe vlerësimi i kryer nga Komisioni lidhur me aktivitetin tregtar të djalit E. R.

53.1. Në DVP/2015 djali i subjektit të rivlerësimit E.R ka deklaruar se është regjistruar si person fizik me NIPT L***H, me datë regjistrimi 15.1.2015, me objekt veprimtarie “agjenci imobiliare, shitje dhe dhënie me qira të pasurive të paluajtshme”. Ai ka deklaruar të ardhura neto të krijuara nga ky aktivitet në formën e pagave vjetore në masën 240,000 lekë. Për ushtrimin e këtij aktiviteti shtetasi E.R ka deklaruar në DVP/2015 se ka lidhur kontratë qiraje me shtetasen H.K për qiramarrjen e ambientit me sip. 40 m². Vlera e qirasë deklarohet 300 euro/muaj. Për këtë qiramarrje djali i subjektit deklaroi se ka paguar vlerën 3,600 euro për vitin 2015.

53.2. Qendra Kombëtare e Biznesit konfirmon regjistrimin e shtetasit E.R si person fizik, me NIPT L***H, me datë regjistrimi 5.1.2015 dhe fushë veprimtarie “agjenci imobiliare, shitje dhënie me qira të pasurive të paluajtshme, kryerja e veprimtarive të sigurimit dhe risigurimit të jo-jetës” dhe vend të ushtrimit të aktivitetit Lagjja nr. *, rruga “S”, Durrës. QKB-ja informon se E.R figuron i regjistruar si person fizik edhe për NIPT L***E, me të njëjtin objekt veprimtarie, por me status çregjistruar në datën 11.10.2019.

53.3. DRT-ja Durrës informon se shtetasi E.R rezultoi i regjistruar me NIPT L***H. Nga verifikimet e kryera nga ky institucion rezultoi se ky tatimpagues ka deklaruar si më poshtë vijon:

- për periudhën 15-A, të ardhura 946,000 lekë, shpenzime 1,158,409 lekë, humbje 212,409 lekë;
- për periudhën 16-A, të ardhura 1,857,325 lekë, shpenzime 1,786,080 lekë, fitimi 71,245 lekë;
- për periudhën 17-A, të ardhura 4,707,580, shpenzime 3,272,846 leke, fitimi 1,434,734 lekë;
- për periudhën 18-A, të ardhura 3,328,627 lekë, shpenzime 2,143,081 lekë, fitimi 1,185,546 lekë;

⁵⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar Bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.1.2020, e “Alpha Bank”.

⁵⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 4.10.2021, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2021, e ISSH-së; shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar DPT-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.1.2020, e DPT-së.

- për periudhën 19-A, të ardhura 3,245,894 lekë, shpenzime 3,546,490 lekë, humbja 300,596 lekë.

53.4. ISSH-ja konfirmon kontribute të paguara mbi pagën nga shtetasja J.R, për periudhën janar 2015 – gusht 2021.

53.5. Në përfundim, konkludohet se nuk lindin dyshime apo paqartësi në lidhje me aktivitetin tregtar të djalit të subjektit të rivlerësimit E.R.

KONSTATIME TË TJERA

54. Lidhur me të ardhurat e përfituara ndër vite nga qiradhënia e apartamentit me sip. 70.7 m², të ndodhur në rrugën “M. Gj”

Për të vërtetuar qiradhënien dhe të ardhurat e ligjshme të krijuara nga marrëdhënia e qirasë ndër vite të apartamentit me sip. 70.7 m², të ndodhur në rrugën “M.Gj”, subjekti i ka bashkëlidhur pyetësorit standard dhe pyetësorit të datës 25.10.2021 dokumentet: (i) kopje të kontratave të qirasë; (ii) kopje të pagesave të kryera ndër vite për tatimin në burim të të ardhurave të përfituara nga qiradhënia e kësaj pasurie; (iii) kopje të transaksioneve të kryera në BKT nga subjektet qiramarrëse për pagesat e kryera prej tyre; si dhe (iv) shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2021, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në lidhje me pagesat e tatimit në burim për kontratat e qirasë të lidhura nga bashkëshortja e subjektit F.R.

54.1. Nga shqyrtimi i këtij dokumentacioni rezulton se bashkëshortja e subjektit ka lidhur kontrata qiraje me subjekte të ndryshme, nga viti 2000 e në vijim. Të ardhurat e këtyre kontratave të dokumentuara, dhe për të cilat janë paguar tatimet përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, janë përfshirë në analizën financiare të subjektit.

Komisioni ka evidentuar kontratat e qirasë, për të cilat subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion apo nuk ka provuar pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara prej tyre, si më poshtë vijon:

i) Kontratë qiraje e lidhur me qiramarrësin F.L, drejtor i agjencisë së reklamave “M”, për periudhën shtator 2000 – shtator 2001, me vlerë qiraje mujore 350 USD.

Subjekti nuk ka depozituar kontratën e qirasë me këtë qiramarrës, si dhe nuk ka paraqitur dokumentacion provues mbi pagimin e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga qiradhënia, për rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara nga qiradhënia për këtë kontratë nuk janë marrë në konsideratë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me këtë kontratë, në përgjigje të pyetësorit nr. 1, datë 25.10.2021, subjekti ka sqaruar se nuk disponon asnjë dokumentacion për pagimin e tatimit mbi të ardhurat gjatë kësaj periudhe, pasi bazuar në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, neni 33, pika 1, germa “dh”, subjekti qiramarrës, në rastet kur ai është person juridik, për ambientet e marra me qira mbart detyrimin për të mbajtur dhe paguar tatimin në burim.

Në përgjigje të rezultateve të hetimit, subjekti ka vendosur në dispozicion të Komisionit shkresën nr. *** prot., datë 28.6.2021, përmes së cilës ky institucion konfirmon se nuk mund të identifikojë pagesat e tatimit në burim të kryera nga shtetasi F.L.

Për sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka mundur të provojë të ardhurat e përfituara nga kjo kontratë qiraje, si dhe pagesën e detyrimeve tatimore. Për pasojë, të ardhurat e pretenduara nga kjo qiradhënie nuk mund të përfshihen në analizën financiare.

ii) Kontratë qiraje e lidhur me qiramarrësin A.F, për periudhën janar 2006 – 31 dhjetor 2011, me vlerë qiraje 30,000 lekë/muaj dhe për periudhën janar 2012 – dhjetor 2014, me vlerë qiraje 40,000 lekë/muaj. Tatimi i fitimit mbi çmimin e qirasë është paguar nga qiramarrësi.

Nga hetimi i kryer në lidhje me këto kontrata qiraje, Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues mbi pagimin e tatimit mbi të ardhurat e

përfituara nga qiradhënia për periudhat 2006 – 2007 dhe 2008 – 2011, si dhe nuk ka paraqitur kontratat e qiradhënies për periudhën 2008 – 2011.

Në prapësimet e tij, subjekti ka pretenduar se gjatë kohës që ka vazhduar kjo marrëdhënie kontraktore, kontrata është ripërtërirë në disa vite me shkrim dhe në disa vite të tjera me veprime konkludente, mbështetur në parashikimin e nenit 821 të Kodit Civil. Ai pretendon se subjektet qiramarrës kanë qenë subjekte që ushtronin veprimtari tregtare dhe, për rrjedhojë, kanë paguar edhe tatimin mbi qiranë si një formë tatimi në burim. Referuar shpjegimeve të subjektit, shtetasi A.F figuron i regjistruar si “person fizik” nga data 25.7.2008.

54.2. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se pretendimet e tij nuk qëndrojnë, për arsye të mëposhtme:

- Në vitin 2006 bashkëshortja e subjektit dhe shtetasi A.F kanë lidhur kontratë qiraje me afat 1.1.2006 – 1.1.2007. Në përmbajtje të saj, kjo kontratë përmban klauzolën e “ripërtëritjes” në rast se palët kontraktuese do të zbatojnë kushtet e kontratës. Për këtë kontratë qiraje subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion që vërteton pagesën e tatimit në burim nga qiramarrësi, i cili në këto vite nuk rezulton të jetë regjistruar si “person fizik”.

Në datën 20.1.2007 palët kanë nënshkruar një kontratë të re qiraje, me afat 1.1.2007 – 1.1.2008. Kjo kontratë nuk përmban klauzolën e ripërtëritjes automatike të qirasë, në rast dakordësie mes palëve. Rrjedhimisht, efektet e saj ligjore përfundojnë në datën 1.1.2008. Në këto kushte, pretendimi i subjektit se marrëdhënia e qirasë është ripërtërirë, nuk qëndron. Gjithashtu, në prapësimet e tij subjekti nuk ka depozituar dokumentacion që vërteton pagesën e tatimit në burim nga qiramarrësi, për të ardhurat e përfituara nga kjo marrëdhënie qiraje, por ka paraqitur shkresën e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, përmes së cilës konfirmohen pagesat e tatimit në burim të kryera nga shtetasi A.F nga viti 2012 e në vijim. Si rrjedhojë, të ardhurat e pretenduara nga subjekti për vitet 2006 – 2011 nuk mund të merren në konsideratë.

55. Pasuri “truall” me sip. 78.33 m², e padeklaruar në deklaratimet vjetore dhe në deklaratën *Vetting*

55.1. Konstatimi i ILDKPKI-së: mosdeklarim në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës të vitit 2003 dhe në deklaratën e pasurisë *Vetting*, të tokës truall me sip. 78.33 m², Lagjja nr. *, Kavajë, ku subjekti zotëron 1/24 pjesë, pasuri kjo e fituar me vendimin të KKK Pronave Kavajë të vitit 1999 dhe me vendim gjykate për pjesëtim pasurie të vitit 2012.

Hetimi⁵⁷ i kryer nga Komisioni

55.2. ZVRPP-ja Kavajë, me shkresën nr. *** prot., datë 3.10.2017, ka konfirmuar për ILDKPKI-në se në emër të shtetasit Shpëtim A.Reka rezulton e regjistruar pasuria “truall” me sip. 78.33 m², me nr. ***, ndodhur në zonën kadastrale ***, në bashkëpronësi. Kjo pasuri vjen nga pjesëtimi i pasurisë nr. ***, e fituar me vendim të kthimit dhe kompensimit të pronës.

55.3. Referuar dokumentacionit të dërguar nga ASHK-ja, rezulton se Komisioni për Kthimin e Kompensimin e Pronës, me vendimin nr. ***, datë 18.2.1999, ka njohur pronësisë mbi truallin me sip. 470 m², me vendndodhje në Lagjen nr. *, Kavajë dhe kthimin e kësaj prone trashëgimtarëve të shtetasit H.Ç⁵⁸. Ndërsa pasuria “truall” me sip. 80 m², me vendndodhje në të njëjtën adresë, i kompensohet trashëgimtarëve të shtetasit H.Ç me tokë tjetër.

55.4. Përmes vendimit datë 24.3.1998, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për trashëgimtarët e H dhe R.Ç, ku si trashëgimtar ligjor i tyre rezulton

⁵⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 21.9.2021, drejtuar ASHK-së Kavajë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 27.9.2021, e ASHK-së Kavajë; shkresë nr. *** prot., datë 28.6.2017, e ILDKPKI-së drejtuar ASHK-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.10.2017, e ASHK-së Kavajë.

⁵⁸ Shtetasi H. Ç është gjyshi nga nëna i subjektit të rivlerësimit.

edhe subjekti i rivlerësimit, i cili përfiton 1/24 pjesë takuese të pasurisë trashëgimore. Mbi bazën e kësaj dëshmie, ai ka përfituar 1/24 pjesë takuese të pasurisë nr. ***.

55.5. Në vijim, me vendimin nr. ***, datë 27.9.2002, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, është vendosur pjesëtimi i pasurive të trashëguara. Përmes këtij vendimi⁵⁹ shtetasit Shpëtim, Sh, S dhe T.R kanë përfituar së bashku 1/6 pjesë të pasurisë truell me sip. 470 m², të barabartë me 78.33 m².

55.6. Sipas procesverbalit të mbajtur nga Zyra Përmbartimore Kavajë, rezulton se në datën 12.9.2003 kjo zyrë ka ekzekutuar vendimin gjyqësor për pjesëtimin e truallit të mësipërm, duke përcaktuar pjesët takuese të bashkëpronarëve. Ky procesverbal nuk rezulton i nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit.

55.7. Pas pjesëtimit të pasurisë së trashëguar, bashkëpronarët Shpëtim, Sh, S dhe T.R kanë kryer regjistrimin e kësaj sipërfaqeje trualli në bashkëpronësi të tyre, me numërtim ***. Referuar kartelës së pasurisë së paluajtshme, gjeneruar nga sistemi elektronik⁶⁰ i ASHK-së, rezulton se kjo pasuri është regjistruar në datën 11.2.2004.

55.8. Në përgjigje të pyetësorit datë 25.10.2021, në lidhje me këtë pasuri, subjekti ka sqaruar: *“Në lidhje me pasurinë truell me nr. pasurie ***, me sipërfaqe 470 m², në bashkëpronësi të Shpëtim Reka dhe 10 shtetas të tjerë, nuk kemi pasur dijeni deri në momentin që na është prezantuar ky fakt nga ana e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave në muajin korrik 2021. Për të sqaruar në lidhje me sa sipër, i jemi drejtuar me kërkesë ASHK-së Kavajë. Më përgjigjen e datës 16.7.2021, Drejtoria Vendore ASHK Kavajë më informon se në emër të Shpëtim Reka dhe bashkëpronarëve Sh, S, T.R rezulton e regjistruar pasuria truell me sipërfaqe 78.33 m², e ndodhur në qytetin Kavajë. Kjo pasuri vjen nga pjesëtimi i pasurisë nr. ***, vol. *, f. *, z. k. ***, e llojit ‘truall’ me sipërfaqe 470 m², në emër të bashkëpronarëve Ç dhe R... Unë, Shpëtim R, jam trashëgimtar i trashëgimlënësës I.R (nëna), e cila është trashëgimtare e z. H.Ç, sipas dëshmisë së trashëgimisë nr. ***, datë 1.4.1998. Pasuria është pjesëtuar me vendimin e Gjykatës Shkallës së Parë Kavajë, nr. ***, datë 27.9.2002, mbi padinë e paraqitur nga z. A.Ç, ku një nga personat e paditur është edhe Shpëtim Reka. Sikurse rezulton nga vendimi, gjykimi është zhvilluar në mungesë të të paditurit Shpëtim Reka dhe disa të paditurve të tjerë, arsye kjo për të cilën nuk kam pasur dijeni për këtë pasuri. Pasi e kam verifikuar, statusi i kësaj pasurie është i pandryshuar, sikurse ka qenë në momentin e regjistrimit të pjesëtimit të pasurisë. As unë dhe as trashëgimtarët e tjerë të trashëgimlënësës I.R nuk kemi përdorur këtë pasuri dhe nuk kemi bërë asnjë shpenzim për të”.*

55.9. Subjekti i ka bashkëlidhur përgjigjes së pyetësorit: (i) shkresë datë 16.7.2021, të ASHK-së Kavajë, (ii) aplikim për regjistrim dhe lëshim dëshmie e certifikatë, datë 26.5.2000, të nënshkruar nga shtetasi A.Ç; (iii) vendim nr. ***, datë 1.4.1998, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me objekt “lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë së H dhe R. Ç”; (iv) procesverbal datë 24.1.2000, i Bashkisë Kavajë, për njohjen dhe zbatimin e pronës së shtetasit H.Ç në mbështetje të vendimit nr. ***, datë 10.2.1999, të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave; (v) vendim nr. ***, datë 10.2.1999, i Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave; (vi) plan rilevimi dhe plan vendosje e pronës së pronarit H.Ç; (vii) kartela e pasurisë, datë 18.6.2001, në të cilën subjekti rezulton bashkëpronar me 1/24 pjesë takuese mbi truallin me sip. 470 m² me nr. pasurie ***; (viii) vendim nr. ***, datë 27.9.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kavajë, me objekt “pjesëtimin e pasurisë truell me sip. 470 m²”, ku subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë palë e paditur në gjykim; (ix) kartela e pasurisë nr. ***, me sip. 78.33 m²; si dhe (x) foto aktuale të kësaj pasurie.

⁵⁹ Në vendimin gjyqësor citohet se z. Shpëtim Reka është në mungesë.

⁶⁰ Kopje kartele printuar nga sistemi i ASHK-së në datën 23.9.2021.

55.10. Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me mosdeklarimin e kësaj pasurie në deklaratën *Vetting*.

55.11. Në prapësimet e tij, subjekti ka paraqitur të njëjtat argumente të paraqitura edhe gjatë hetimit. Ai ka depozituar gjithashtu kopje të dosjes së gjykimit, me objekt “pjesëtim pasurie që i përket vendimit nr. ***, datë 27.9.2002”. Subjekti pretendon se gjykimi i kësaj çështjeje është bërë pa dijeninë e trashëgimtarëve të I.R dhe se fletëthirrjet e gjykatës në emrin e tij nuk janë të nënshkruara. Fletëthirrjet e dërguara me postë janë kthyer me shënimin “adresë e pasaktë”, ndërsa të gjitha fletëthirrjet e tjera nuk janë dërguar me postë, por nëpërmjet ftuesit të gjykatës dhe nuk janë të firmosura prej tij. Fletëthirrjet e dërguara me ftuesin e gjykatës nuk kanë të shënuar asnjë adresë, çka do të thotë që asnjëra prej tyre nuk ka mbërritur tek subjekti dhe nuk është firmosur ana e tij, e motrave dhe të vëllait. Ai pretendon se firmat e vendosura në fletëthirrjet në emër të tij nuk janë të tijat. Procesverbalet e seancave gjyqësore, gjithashtu, tregojnë qartë se gjykimi është zhvilluar në mungesë të subjektit.

55.12. Pasi analizoi shpjegimet e subjektit, Komisioni vlerëson se ato janë bindëse dhe se ka qenë në kushtet e pamundësisë për deklarimin e pjesës takuese të kësaj pasurie.

56. Automjet tip “M-B”, deklaruar në DVP/2003, blerë në vlerën 2,500 USD dhe shitur në vlerën 10,000 euro

56.1. Burimi i deklaruar në DVP/2003: të ardhurat nga puna, si dhe të ardhurat nga shitja e automjetit tip “V.G”, me targa DR *** C.

Hetimi⁶¹ i kryer nga Komisioni

56.2. Në DVP/2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pronësinë e automjetit tip “M-B”, me vlerë 2,500 USD, pjesë takuese 100%, me burim të ardhurat nga punësimi dhe të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit tip “V.G”, me targa DR *** C. Në DVP/2005 subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti në vlerën 10,000 euro.

56.3. Me kontratën e shitblerjes së automjetit datë 9.5.2003, subjekti i rivlerësimit ka blerë nga shtetasi B.Z automjetin tip “M-B” për çmimin 200,000 lekë. Në përmbajtje të kontratës blerësi deklaron se ka kryer pagesën në favor të shitësit dhe se merr përsipër të kryejë zhdoganimin e mjetit. Referuar deklaratës doganore Import 4 shuma totale të faturuar për këtë automjet është 200,000 lekë. Sipas kësaj deklarate si dhe mandatit të Bankës së Kursimeve rezulton se vlera e zhdoganimit të automjetit prej 345,098 lekësh është paguar nga shitësi B. Z në datën 6.6.2003.

56.4. Për sa më sipër, rezulton se çmimi i caktuar në kontratën e shitjes nuk përputhet me çmimin e deklaruar nga subjekti në DVP/2003. Në lidhje me këtë konstatim, në përgjigje të pyetësorit të datës 25.10.2021, subjekti ka sqaruar: *“Në lidhje me automjetin tip ‘Benz’ të blerë në datën 9.5.2003 nga shtetasi B.Z, disponoj kontratën e lidhur përpara noterit nr. *** rep., nr. ***kol. Në këtë kontratë, vlera e blerjes së mjetit nga ana ime është në shumën 200,000 (dyqind mijë) lekë. Disponoj kopje të DVP/2003 që kam dorëzuar dhe nuk konstatoj të kem shënuar as vlerë të mjetit dhe as burim të të ardhurave. Nuk kam pasur asnjë arsye për të deklaruar çmim të ndryshëm nga ai i blerjes. Vlera e blerjes së këtij automjeti është ajo që është e pasqyruar në kontratë”*.

56.5. Pasi Komisioni ka vënë në dispozicion të subjektit kopje të DVP/2003 të përcjellë nga ILDKPKI-ja, subjekti ka deklaruar⁶² se: *“Në lidhje me plotësimin e DVP periodike ndër vite dua të shpjegoj se gjatë gjithë periudhës së deklarimit është marrë kryesisht bashkëshortja. Nga ana juaj u njoha me DVP/2003, që është vënë në dispozicion nga autoritetet përgjegjës dhe konstatohet qartë se, në ndryshim nga ajo që unë disponoj, është e plotësuar me disa*

⁶¹ Shkresë nr. *** prot., datë 4.20.2021 drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.10.2021, e DPSHTRR-së.

⁶² Përgjigje e pyetësorit, datë 11.11.2021.

shënime të bëra me dorë. Me sa kujtoj, shënimet e shtuara me shkrim dore në atë DVP mund të jenë bërë në zyrat e ILDKPKI-së në një rast që jam thirrur nga inspektorja përkatëse për të saktësuar të dhënat e pasqyruara. Të dhënat e pasqyruara në këto shënime dore janë thënë prej meje në mënyrë të përgjithshme, nxitimthi dhe pa u mbështetur në dokumentacion shoqërues”.

56.6. Me kontratën e shitjes datë 22.9.2005, subjekti i rivlerësimit e shet këtë automjet në favor të shtetasit H.L, për çmimin 10,000 euro, shumë e cila deklarohet e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

56.7. I pyetur nga Komisioni lidhur me transaksionet e kryera për këtë automjet, subjekti ka sqaruar: *“Në lidhje me detyrimin e zhdoganimit të mjetit, të dy palët kontraktore i jemi përmbajtur kontratës. PAGESA e zhdoganimit është bërë nga ana ime, ashtu sikurse është parashikuar në kontratë. Nuk kujtoj nëse kam shkuar ose jo së bashku me shtetasin B.Z për të bërë këtë pagesë. Në lidhje me vlerën e shitjes së mjetit, dua të sqaroj se gjatë përdorimit nga ana ime, atij mjeti i janë bërë disa shërbime që e kanë përmirësuar cilësinë e tij dhe kanë rritur vlerën e mjetit (ndërrim i disqeve, gomave, tapicerisë, lyerja etj.). Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes, sqaroj se fitimi që realizohet nga shitja e automjeteve nuk është e ardhur e tatueshme. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 155 përcakton se: ‘taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare dhe vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pagesve, si dhe mënyra e mbledhjes të tyre, caktohen me ligj’. Në zbatim të saj, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’ dhe udhëzimi nr. 5, datë 18.1.2005, i Ministrisë së Financave nuk parashikojnë pagesë të tatimit mbi të ardhurat për shitjen e automjeteve në asnjë nen apo paragraf të tyre. Gjithashtu, ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, ‘Për tatimin mbi të ardhurat’, nuk parashikon që fitimi i realizuar nga individët prej shitjes së automjeteve të jetë e ardhur e tatueshme. Përveç sa sipër, unë, sikurse shpjegova, nuk kam realizuar asnjë fitim nga shitja e mjetit në fjalë, pasi investimet që kam kryer në këtë mjet për mirëmbajtjen dhe përmirësimet e tij janë të barabarta ose edhe më të larta se diferenca ndërmjet çmimit të shitjes me atë të blerjes. Nuk disponoj dokumentacionin e blerjes dhe shitjes së automjetit ‘V.G’ me targa DR ***, dhe për shkak të kohës së gjatë nga blerja dhe shitja nuk kujtoj të dhëna specifike në lidhje me këtë automjet”.*

56.8. Komisioni konstaton se shpjegimet e subjektit nuk janë bindëse në lidhje me vlerën e shitjes 10,000 euro. Ai nuk ka depozituar dokumentacion provues për të provuar pretendimet e tij në lidhje me vlerën e investimit dhe kohën e kryerjes së tyre. Subjekti ka deklaruar se ka kryer investime në automjet, por pa specifikuar tipin, kohën dhe vlerën e tyre. Gjithashtu, këto shpenzime të pretenduara si të kryera, nuk janë deklaruar në deklaratat periodike vjetore.

56.9. Komisioni kreu analizën financiare për automjetin tip “M-B”, nga e cila rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e këtij automjeti në vlerën 200,000 lekë, si dhe për pagesën e shpenzimeve doganore në vlerën 345,098 lekë.

56.10. Në përfundim, në lidhje me këtë automjet, rezultoi se: (i) në DVP/2003 subjekti ka kryer deklaram të pasaktë të vlerës së blerjes së automjetit dhe burimit të ligjshëm; (ii) subjekti nuk provoi me dokumentacion shërbimet që i janë kryer automjetit, të cilat kanë ndikuar në rritjen e vlerës së tij dhe shitjes në një vlerë shumë më të lartë se vlera e blerjes, pas më tepër se 2 vitesh përdorim; (iii) subjekti nuk provoi pagimin e detyrimeve tatimore për diferencën e çmimit të blerjes dhe të shitjes së automjetit. Si rrjedhojë e këtyre konstatimeve, Komisioni ngriti dyshimin e arsyeshëm se subjekti ka kryer veprime fiktive lidhur me përcaktimin e çmimit të blerjes dhe të shitjes së këtij automjeti dhe i kaloi barrën e provës, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

56.11. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti, në prapësimet e paraqitura, ka pretenduar se:

a) Në DVP/2003 nuk ka pasur asnjë arsye për të deklaruar çmim të ndryshëm nga ai i blerjes. Vlera e blerjes së këtij automjeti është ajo që është e pasqyruar në kontratë. Pas blerjes së automjetit janë paguar edhe detyrimet për zhdoganimin e tij. Në lidhje me vlerën e shitjes së automjetit, i janë bërë disa shërbime që e kanë përmirësuar cilësinë e tij dhe kanë rritur vlerën (ndërrim i disqeve, gomave, tapicerisë, lyerja etj.). Për këtë arsye, vlera e shitjes së automjetit përfshin si vlerën e zhdoganimit të paguar prej tij, ashtu edhe investimet e kryera për përmirësimin e cilësisë. Subjekti ka sqaruar se shpenzimet për shërbimet e kryera në këtë automjet janë kryer menjëherë pas blerjes së tij në vitin 2003 dhe nuk ka pasur shkak për të deklaruar në DVP-të pasardhëse shpenzime për të.

b) Në lidhje me pagimin e detyrimeve tatimore për diferencën e çmimit të blerjes me atë të shitjes, subjekti ka pretenduar se fitimi që realizohet nga shitja e automjeteve nuk është e ardhur e tatueshme. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” dhe udhëzimi nr. 5, datë 18.1.2005, i Ministrisë së Financave, nuk parashikojnë pagesë të tatimit mbi të ardhurat për shitjen e automjeteve në asnjë nen apo paragraf të tyre. Gjithashtu, ky ligj nuk parashikon që fitimi i realizuar nga individët prej shitjes së automjeteve të jetë e ardhur e tatueshme. Përveç sa sipër, subjekti sqaron se nuk ka realizuar asnjë fitim nga shitja e automjetit, pasi investimet që ka kryer në të janë të barabarta, ose edhe më të larta, se diferenca ndërmjet çmimit të shitjes me atë të blerjes.

56.12. Subjekti i ka bashkëlidhur prapësimeve të tij: (i) deklaratë noteriale nr. ***, datë 17.2.2022, të shtetasit Xh.P, përmes së cilës ky shtetas deklaroi se rreth 15 vjet më parë ka kryer shërbime riparimi dhe mirëmbajtjeje të mjetit, të cilat kanë kushtuar rreth 100,000 - 150,000 lekë. Deklaruesi ka paraqitur edhe ekstrakt të QKB-së, ku rezulton i regjistruar si “person fizik” nga data 1.1.2003; (ii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.2.2022, e shtetasit E.K, përmes së cilës ky shtetas deklaroi se ushtron prej vitesh aktivitetin si llamarinist dhe bojaxhi për automjete dhe se përpara disa vitesh ka riparuar automjetin e subjektit dhe shërbimet e kryera kanë kushtuar rreth 100,000 - 150,000 lekë.

56.13. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga ana e tij nuk është vënë në dispozicion dokumentacioni i kohës për të provuar shpenzimet e kryera për të rritur vlerën e automjetit. Deklaratat noteriale të depozituar nga subjekti do të merren me rezervë, pasi ato janë hartuar gati 15 vjet më vonë nga koha e kryerjes së shërbimeve të pretenduara nga ana e deklaruesve, të cilët nuk kanë specifikuar se çfarë lloji shërbimi kanë kryer. Vlera maksimale e shpenzimeve të deklaruara në këto deklarata është 300,000 lekë, duke mos u justifikuar çmimi i shitjes prej 10,000 euro. Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin që shuma 10,000 euro nuk është deklaruar si burim për ndonjë pasuri të subjektit, vlerëson se vendosja e kësaj shume në kontratë, për sa kohë nuk ndikon në procesin e rivlerësimit të subjektit, nuk mund të klasifikohet si deklarim i pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

57. Hetimi i kryer nga Komisioni në lidhje me automjetin me targa DR * C, i cili ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit tip “M-B”**

57.1. Sipas dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRR-ja⁶³, rezulton se automjeti i regjistruar me këtë targë është i markës “M-B” dhe jo “V. G”, siç është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit. Nga verifikimi i dokumentacionit të këtij automjeti rezulton se:

- i. Automjeti ka qenë i regjistruar në shtetin gjerman, në pronësi të shtetasit Shpëtim Reka, i datëlindjes 23.9.1962, me vendbanim në rrugën nr. ***, D, Gjermani.

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 14.10.2021, drejtuar DPSHTRR-së; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.10.2021, e DPSHTRR-së.

- ii. Nga kartela për të dhënat e patentës rezulton se automjeti është blerë nga shtetasi Shpëtim Reka, me banim në D, në datën 1.7.1994, nga shitësi W.W, me adresë Munich, Gjermani.
- iii. Ky automjet, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 28.12.1999, është shitur nga subjekti tek bashkëshortja e tij F.R, për çmimin 500,000 lekë. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, pronësia e shitësit mbi këtë automjet vërtetohet në bazë të vërtetimit të hyrjes në doganë dhe librezës së mjetit nr. ***.
- iv. Në datën 10.1.2000 ky automjet, nëpërmjet dokumentit në gjuhën gjermane “kontratë për blerjen e automjetit të përdorur”, datë 10.1.2000, është shitur nga një shtetas me emrin Shpëtim Reka me banim në D tek shtetasja L.R me banim në Durrës, për çmimin 2,000 DM (marka gjermane). Kontrata duket se është nënshkruar nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e shitësit, dhe e bashkëshortes së tij F.R, në cilësinë e blerëses.
- v. Bazuar në deklaratën doganore të zhdoganimit Import 4 (e cila ka të mbivendosur datën 16.2.2000) është kryer zhdoganimi i këtij automjeti me eksportues z. Shpëtim Reka, me adresë: rruga nr. ***, D, Gjermani dhe marrëse znj. F.R. Sipas përmbajtjes së kësaj deklarate, automjeti është shitur në vlerën 2,000 marka gjermane dhe është paguar taksa doganore në vlerën 88,787 lekë.
- vi. Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 10.2.2000, znj. F.R e shet këtë automjet tek subjekti i rivlerësimit për çmimin 700,000 lekë.
- vii. Referuar inventarit fizik të dosjes, automjeti u pajis me targën DR *** B. Më tej, referuar vërtetimit datë 27.12.2000, rezulton se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e pronarit të këtij automjeti, ka denoncuar pranë Komisarariatit të Policisë Durrës për humbjen e targës. Në vijim, automjeti u pajis me targën DR *** C.
- viii. Me kontratën e shitjes nr. ***, datë 5.6.2003, subjekti i rivlerësimit e shet këtë automjet në favor të blerësit I.H, për çmimin 200,000 lekë, shumë të cilën blerësi deklaroi se e ka likuiduar.

57.2. Lidhur me konstatimet e mësipërme të konstatuara nga Komisioni, në përgjigje të pyetësorit, datë 11.11.2021, subjekti ka sqaruar: *“Në muajin dhjetor të vitit 1999 kam kontaktuar me z. V.Xh, i cili në atë kohë ushtronte aktivitetin si tregtar automjetesh. Me këtë shtetas kam rënë dakord për blerjen e një automjeti tip ‘M-B’ në shtetin gjerman. Shtetasit V. Xh i kam dhënë autorizim për blerjen e automjetit dhe e kam pajisur me fotokopjen e pasaportës time. Automjeti që është blerë në emrin tim ka mbërritur në Shqipëri në muajin dhjetor 1999. Kujtoj që automjeti ka qenë i pajisur me librezë të përkohshme gjermane në emrin tim (praktikë që shteti gjerman ndjek në çdo rast në blerjet e automjeteve për të mundësuar qarkullimin në shtetet e BE-së provizorisht). Automjeti ka qenë gjithashtu i targuar me targën D-PW***. Automjeti ka hyrë në PKK Durrës në emrin tim me vërtetim hyrje dhe pasi kam rënë dakord me shtetasin V. Xh kam bërë pagesën e vlerës së mjetit dhe transportit. Më tej, me procedurat e zhdoganimit dhe targimit kam autorizuar një shtetas me emrin M, ish-punonjës i agjencive doganore, që merrej me përpunimin e dokumenteve, pagesat e detyrimit doganor në vlerën 169,593 lekë, rezulton se janë bërë në muajin shkurt 2000 dhe targimi i mjetit po ashtu në këtë periudhë. Zhdoganimi i mjetit dhe regjistrimi i tij është bërë nga personi i autorizuar prej meje (M) të cilit në mirëbesim i kam dhënë dokumentet dhe lekët për detyrimin doganor dhe procedurat e tjera.*

Fakti që deklarata doganore dhe mandati bankar pranë Bankës së Kursimeve Durrës, të datës 8.2.2000, nuk janë nënshkruar nga ana ime dhe as nga ana e bashkëshortes time, janë evidente dhe provojnë faktin që këto procedura nuk janë kryer nga ana ime dhe as nga bashkëshortja. Nuk di të them se çfarë përfitimi ka pasur personi (M) që ka kryer të gjitha veprimet e parregullta gjatë targimit të këtij mjeti.

Dua të sqaroj se ndonëse jam treguar i pakujdesshëm në lidhje me lënien e dokumentacionit të mjetit tek persona të tjerë, nga parregullsia e krijuar nuk ka ardhur asnjë pasoje juridike apo

shmangie nga detyrimet prej meje, pasi vlera e detyrimit doganor, sikurse rezulton nga deklarata doganore, është përlllogaritur në bazë të çmimit të referencës”.

57.3. Në përgjigje të pyetësorit datë 11.11.2021, subjekti ka depozituar: (i) deklaratë noteriale nr. ***, datë 16.11.2021, përmes së cilës shtetasi V.Xh deklaroi se është autorizuar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e automjetit; (ii) fotokopje të faqes së pasaportës së shtetasit V. Xh, për të vërtetuar hyrjen dhe daljen e tij nga Gjermania në periudhën e blerjes së automjetit; (iii) shkresë nr. *** prot., datë 16.11.2021, e Degës së Doganës Durrës, e cila informon se automjeti nuk rezulton në listën e subjekteve debitore apo me shkelje doganore; si dhe (iv) shkresë nr. *** prot., datë 16.11.2021, e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, e cila informon se automjeti nuk rezulton të jetë shpallur në kërkim kombëtar apo ndërkombëtar.

57.4. Komisioni ka pyetur subjektin lidhur me arsyen përse bashkëshortja e tij pas zhdoganimit të automjetit ia ka shitur sërish subjektit me një çmim më të lartë se çmimi i blerjes. Lidhur me këtë pyetje, subjekti ka deklaruar se *të dy kontratat e përpiluara në gjuhën shqipe ndërmjet tij dhe bashkëshortes pasqyrojnë të dhëna të sakta. Arsyeja për shitjen e automjetit nga ana e tij tek bashkëshortja në muajin dhjetor 1999 dhe nga bashkëshortja tek ai në muajin shkurt 2000 ka ndodhur për shkak të mosmarrëveshjeve familjare që kanë pasur në lidhje me blerjen e mjetit.*

57.5. Lidhur me çmimin e blerjes së automjetit me targa DR *** C, në përgjigje të pyetësorit datë 11.11.2021, subjekti ka deklaruar: *“Nuk disponoj dokumentacionin e blerjes dhe shitjes së automjetit ‘V. G’, me targa DR ***, dhe për shkak të kohës së gjatë nga blerja dhe shitja nuk kujtoj të dhëna specifike në lidhje me këtë automjet.”*

57.6. Në vijim, në përgjigje të pyetësorit datë 22.11.2021 në lidhje me çmimin e blerjes së automjetit, subjekti ka deklaruar se *kontrata e datës 28.12.1999 në vlerën e përcaktuar 500,000 lekë pasqyron vlerën e blerjes së mjetit, si dhe të gjitha detyrimet e paguara tek personat e autorizuar për transportin e mjetit, zhdoganimin e tij (të mundshëm, pra që do të kryhej), riparimet e mundshme deri në pajisjen e plotë me dokumentacionin shqiptar. Pra, vlera e plotë e këtij mjeti do të ishte përafërsisht 500,000 lekë, nga të cilat një pjesë ka qenë e paguar dhe pjesa tjetër do të paguhej, por është pasqyruar si shpenzim i mundshëm, sikurse dhe ndodhi më pas.*

57.7. Në pyetësorin e datës 11.11.2021, në lidhje me dokumentacionin e automjetit me targa DR *** C, subjekti ka deklaruar se *automjeti ka qenë i pajisur me një librezë të përkohshme gjermane në emrin e tij. Automjeti ka hyrë në PKK Durrës në emrin e tij me vërtetim hyrje dhe pasi ka rënë dakord me shtetasin V. Xh ka bërë pagesën e vlerës së mjetit dhe transportit. Kontrata në gjuhën gjermane nuk është përpiluar e nënshkruar prej tij e bashkëshortes.*

57.8. Komisioni konstatoi se dokumenti i regjistrimit të automjetit (dokument në gjuhën gjermane me emërtim “F”) nr. ***, i cili mban datën 20.9.1999, nuk rezulton të jetë një librezë e përkohshme gjermane, siç është deklaruar nga subjekti. Për këtë dokument, subjekti ka qenë në dijeni, sikundër ka deklaruar në pyetësorin e datës 11.11.2021.

Nga shqyrtimi i këtij dokumenti, vërehet se automjeti me targa D-PW *** ka qenë i regjistruar në shtetin gjerman, në pronësi të subjektit, me vendbanim në rrugën nr. ***, D, Gjermani, dhe është blerë prej tij në datën 1.7.1994.

Ky automjet, me kontratën e shitjes nr. ***, datë 28.12.1999, është shitur prej tij tek bashkëshortja F.R për çmimin 500,000 lekë. Në këtë kontratë subjekti deklaroi se librezja e automjetit ka nr. ***, si dhe targa D-PW**. Në datën 10.1.2000 ky automjet, nëpërmjet dokumentit në gjuhën gjermane “kontratë për blerjen e automjetit të përdorur”, datë 10.1.2000, është shitur nga një shtetas me emrin Shpëtim Reka, me banim në D, tek shtetasja L.R, me banim në Durrës, për çmimin 2,000 DM (marka gjermane). Në këtë kontratë është vendosur

nr. ***, i cili është i njëjtë me numrin e dokumentit të regjistrimit të automjetit në emrin e subjektit.

57.9. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit lidhur me automjetin tip “Mercedes-Benz” dhe automjetin me targa DR *** C, konstatoi se ato nuk janë bindëse. Dokumentacioni i gjendur në dosjen e automjetit me targa DR ***C, i cili konfirmohet edhe nga vetë subjekti që është i parregullt, ngarkon me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit, i cili ka pasur dijeni të plotë për këtë dokumentacion. Bazuar mbi këto konstatime, subjektit iu kaluar barra e provës, pasi:

i. Veprimet e tij në lidhje me automjetin me targa DR *** C, duke përdorur dokumentacion jo të rregullt zhdoganimi, nuk janë në përputhje me etikën dhe sjelljen e duhur për një gjyqtar.

ii. Automjeti tip “M-B”, i deklaruar në DVP/2003, është blerë në datën 9.5.2003. Shitja e automjetit me targa DR *** C është realizuar një muaj më pas, në datën 5.6.2003, për pasojë, të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij autmjeti nuk mund të kenë shërbyer për blerjen e automjetit tip “M-B”, deklaruar në DVP/2003. Si rrjedhojë, subjekti nuk ka deklaruar saktë burimin e krijimit të automjetit tip “M-B”.

57.10. Pas kalimit të barrës së provës, subjekti, në prapësimet e tij sqaron se në periudhën e blerjes së automjetit me targa DR *** C nuk ka qenë i orientuar me dokumentacionin e shitblerjes së automjeteve. Automjeti është blerë në emrin e tij dhe ka mbërritur në Shqipëri nëpërmjet Portit të Durrësit në dhjetor të vitit 1999. Me procedurat e zhdoganimit dhe targimit është marrë një shtetas i autorizuar prej tij. Subjekti sqaron se ndonëse është treguar i pakujdesshëm në lidhje me lënien e dokumentacionit të automjetit tek persona të tjerë, nga parregullsia e krijuar nuk ka ardhur asnjë pasojë juridike apo shmangie nga detyrimet, pasi vlera e detyrimit doganor është përlllogaritur në bazë të çmimit të referencës.

57.11. Komisioni konstaton se subjekti, edhe pas kalimit të barrës së provës, nuk arriti të provonte pretendimet e tij lidhur me parregullsinë e dokumentacionit përmes së cilit ka fituar pronësinë e automjetit me targa DR *** C. Si rrjedhojë, vlerësohet se veprimet e subjektit nuk janë në përputhje me etikën dhe sjelljen e duhur për një gjyqtar dhe duhen të jenë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

DETYRIME FINANCIARE

58. Në lidhje me kredinë në vlerën 31,000 euro, marrë nga subjekti dhe bashkëshortja në BKT

58.1. Nga hetimi⁶⁴ ka rezultuar se në datën 17.12.2004 bashkëshortja e subjektit, në cilësinë e kredimarrëses, dhe subjekti, në cilësinë e dorëzanësit, kanë lidhur kontratë kredie bankare nr. ***, me BKT-në, për vlerën 31,000 euro, me afat 10 vjet.

58.2. Referuar lëvizjeve bankare, kredia në vlerën 30,380 euro është lëvruar në llogarinë e bashkëshortes së subjektit F.R në datën 13.1.2005, e cila ka kryer tërheqje të shumës 30,000 euro në datën 14.1.2005. Bashkëshortja e subjektit F.R në datën 14.11.2008 ka depozituar *cash* shumën 5,450 euro, që ka shërbyer si shlyerje e pjesshme e kredisë.

58.3. Komisioni kreu një analizë mbi mundësitë financiare të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e kësaj pagese dhe nga analiza rezultoi se subjekti ka pasur pamundësi financiare për

⁶⁴ Shkresë nr. *** prot., datë 14.1.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.1.2020, e BKT-së.

kryerjen e pagesës së pjeshme të kredisë në vlerën 327,818.94 lekë. Subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

58.4. Në prapësimet e tij, subjekti pretendoi se Komisioni nuk ka marrë parasysh mbetjen e vlerës *cash* të pasqyruar në blerjen e automjetit tip “O. C” në datën 10.6.2008. Ai citon se përgjatë viteve 2006 - 2007 ka deklaruar gjendje *cash* në masën 600,000 lekë, prandaj vlera negative e analizës është mbuluar në vlerën *cash*.

58.5. Komisioni, pasi analizoi prapësimet e subjektit në tërësinë e tyre, vlerësoi të përfshijë në analizën financiare të subjektit gjendjet e likuiditeteve të tij bankare dhe të bashkëshortes në BKT dhe “Alpha Bank”. Për pasojë, analiza financiare për shlyerjen e pjeshme të kredisë së marrë nga subjekti në BKT rezultoi pozitive.

58.6. Në përfundim, në lidhje me pagesën pjesore të kredisë së marrë nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja në BKT, konkludohet se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e kësaj pagese.

Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë

59. Në përfundim të vlerësimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues konkludon se subjekti u gjend me probleme në drejtim të verifikimit dhe kontrollit të kriterit të pasurisë, të cilat konsistojnë në:

- a) mungesën e burimeve të ligjshme për pasuritë në pronësi të tij dhe personave të lidhur;
- b) deklarin jo të saktë e në përputhje me ligjin;
- c) gjendjen në kushtet e konfliktit të interesit;
- d) kryerjen e veprimeve që nuk janë në përputhje me etikën dhe sjelljen e duhur për një gjyqtar.

Në këto kushte, Komisioni çmon se këto çështje mjaftojnë për të arritur në konkluzionin se subjekti nuk arriti një nivel të besueshëm për kriterin e pasurisë dhe, sipas nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, do të vlerësohen nga Komisioni në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj subjektit.

B. VLERËSIMI I FIGURËS

60. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuar në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

60.1. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 26.5.2021, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 26.5.2021, të KDZH-së. Sipas këtij raporti, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, si dhe nuk ka informacione se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar.

60.2. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës.

60.3. Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, rezultoi si më poshtë vijon:

i. Komisioni, gjatë verifikimit të sistemit TIMS të subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar, ndër të tjera, se subjekti ka udhëtuar me automjetin me targa AA *** AG, me dalje nga territori

shqiptar nëpërmjet pikës kufitare të Qafë Botës në datën 21.7.2012 dhe hyrje në datën 30.7.2012 nëpërmjet pikës kufitare të Kakavijës.

ii. Nga verifikimi në sistemin e AMF-së të targës AA *** AG, ka rezultuar se automjeti tip “M-B”, vit prodhimi 2009, ka qenë në pronësi të shtetasit Xh.T.

iii. Komisioni ka verifikuar në rrjetin internet me mjetin e kërkimit *google* dhe ka konstatuar se nga informacionet e publikuara në media ky shtetas rezulton që në vitin 2006 të jetë arrestuar dhe dënuar për trafikim ndërkombëtar të lëndëve narkotike.

iv. Komisioni, në kuadrin e dyshimeve mbi mundësinë e kontaktit të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit, ka pyetur subjektin lidhur me marrëdhënien e tij me pronarin e automjetit me targa AA *** AG.

v. Në pyetëtorin e datës 22.11.2021, subjekti ka deklaruar: *“Udhëtimi i datës 21.7.2012 është kryer me dy automjete, atë me targa TR *** M dhe automjetin tjetër, të cilin mesa kujtoj e kemi marrë më qira. Automjetin e marrë me qira e kam përdorur unë. Nuk kam dijeni se cili ka qenë apo është pronari i automjetit. Për të siguruar automjetin me qira, janë interesuar prindërit e fëmijëve që ne do të merrnim në udhëtim, T. K dhe C. M, dhe pagesa gjithashtu është bërë prej tyre për të gjitha ditët e përdorimit. Nevoja për të përdorur dy automjete në atë udhëtim ishte pikërisht fakti që ishim gjashtë persona. Unë në atë kohë kam përdorur automjetin të shoqëruar me dokumentacionin e nevojshëm të përdorimit”.*

vi. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar:

- deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.7.2012, e shtetasve M e N.K, prindër të T.K, përmes së cilës deklarojnë dakordësinë që djali i tyre të udhëtojë jashtë vendit i shoqëruar nga subjekti dhe bashkëshortja e tij;
- mesazh elektronik nga shtetasi N.K, në të cilin citohet se automjeti i marrë me qira për këtë udhëtim, si dhe pagesa përkatëse, është kryer nga ana e tij. Më pas është hartuar prokura dhe siguracioni ndërkombëtar për përdorimin e automjetit nga subjekti i rivlerësimit.

vii. Komisioni, në kuadrin e dyshimeve mbi mundësinë e kontaktit të papërshtatshëm të subjektit të rivlerësimit, me pyetëtorin e datës 22.12.2021, i ka kërkuar shpjegime lidhur me njohjen me shtetasin Xh.T. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Automjetin me targa AA *** AG, i cili është marrë me qira, e kam përdorur unë. Për përdorimin e tij jam pajisur edhe me dokumentacionin e nevojshëm të huapërdorjes, me datë 19.7.2012. Për të siguruar automjetin me qira, janë interesuar prindërit e fëmijëve që ne do të merrnim në udhëtim, T K dhe C.M dhe pagesa gjithashtu është bërë prej tyre (konkretisht prej N) për të gjitha ditët e përdorimit, arsye kjo për të cilën unë nuk disponoj dokumentacion për marrje me qira të mjetit. Me shtetasin Xh.T nuk kam asnjë njohje apo marrëdhënie farefisnie. Gjatë karrierës time si gjyqtar nuk kam rastisur të gjykoj çështje me palë shtetas me emër Xh.T, fakt të cilin e provoj me përgjigjen e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjithashtu, as bashkëshortja ime nuk ka trajtuar materiale apo procedime penale në lidhje me ndonjë person me emër Xh. T”.*

viii. Në mbështetje të shpjegimeve të tij, subjekti ka depozituar shkresën nr. *** prot., datë 28.12.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përmes së cilës ky institucion informon se nuk rezultojnë çështje të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, në të cilat të ketë qenë palë ndërgjyqëse shtetasi Xh.T. Subjekti ka paraqitur gjithashtu kopje të kontratës së huapërdorjes se automjetit nr. ***, datë 19.7.2012, hartuar pranë noteres M.N. Referuar përmbajtjes së kësaj kontrate, rezulton se shtetasi Xh.T e ka dhënë automjetin në përdorim të subjektit të rivlerësimit për një periudhë kohe pa afat, pa kundërshtim dhe me të drejtë përdorimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

60.4. Gjatë hetimit të kryer, Komisioni ka administruar përgjigjet e institucioneve si vijon:

a) Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit⁶⁵ informon se me automjetin me targa AA***AG ka dalë nga territori i Republikës së Shqipërisë shtetasi Shpëtim A.Reka, si drejtues i automjetit, në datën 21.7.2012, ora 15:00, nga pika kufitare e Qafë Botës.

b) Ministria e Drejtësisë⁶⁶ informon se *pranë këtij institucioni është regjistruar shkresa e Ministrisë së Drejtësisë së Italisë, nr. *** prot., datë 5.12.2005, me objekt “ushtrimin e ndjekjes penale ndaj shtetasit Xh.T”, e transmetuar në Prokurorinë e Përgjithshme Tiranë me lëndë “Kërkesë për ndihmë juridike e autoriteteve italiane të drejtësisë”.*

Referuar akteve që i bashkëlidhen përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë, rezulton se shtetasi Xh. T është shpallur fajtor për transportin në Itali të lëndëve narkotike dhe për këtë shkak Gjykata e Barit Itali në datën 6.5.2005 ka vendosur masën e sigurisë “arrest me burg” ndaj këtij shtetasi. Kjo masë nuk është ekzekutuar për shkak të fshehjes së Xh. T.

Në kushtet kur shteti shqiptar nuk kryen ekstradimin e qytetarëve të tij në shtete të tjera, aktet e procedimit penal i kanë kaluar Prokurorisë së Përgjithshme të Shqipërisë me qëllim fillimin e procedimit penal ndaj këtij shtetasi për veprën penale të trafikimit të narkotikëve parashikuar nga neni 283/a i Kodit Penal.

60.5. Referuar dokumentacionit të administruar, rezultoi se shtetasi Xh.T është “person i përfshirë në krimin e organizuar”, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, edhe “kontakt i papërshtatshëm” i subjektit të rivlerësimit.

60.6. Lidhur me shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit sa i përket njohjes së tij me shtetasin Xh. T, duket se qëndrimi i subjektit nuk është bindës, për arsyet e mëposhtme:

- Në përgjigje të pyetësorit datë 22.11.2021, subjekti ka deklaruar se nuk ka dijeni se cili ka qenë pronari i automjetit, por në vijim në përgjigje të pyetësorit datë 22.12.2021 ka paraqitur kontratën e huapërdorjes së lidhur me pronarin e automjetit Xh.T, të nënshkruar në prani të noterit nga të dyja palët.
- Subjekti ka deklaruar qiramarrjen e automjetit, ndërkohë që nga hetimi ka rezultuar se automjeti është përdorur nga subjekti përmes një kontrate huapërdorjeje me afat të papërcaktuar, pa kundërshpërblim dhe me të drejtë përdorimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.
- Faktet e mësipërme diktojnë për një marrëdhënie të posaçme mes subjektit të rivlerësimit dhe pronarit të automjetit me targa AA *** AG, pasi ky mjet nuk rezultoi të jetë përdorur nga pronari i tij Xh.T me qëllim qiradhënieje, por është “huazuar” me të drejta të papërcaktuara e pa kundërshpërblim nga subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, tagrat e përcaktuara në kontratën e huapërdorjes krijojnë bindjen e një marrëdhënieje njohjeje dhe mirëbesimi mes pronarit të automjetit dhe huamarrësit, çka nuk përputhet me qëndrimin e subjektit, i cili pretendon të ketë pasur marrëdhënie qiraje me pronarin e automjetit.
- Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur një akt, përmes së cilit të jetë revokuar apo përfunduar marrëdhënia e huapërdorjes, çka ngre dyshime të arsyeshme se subjekti mund të ketë kryer përdorim të mëtejshëm të këtij automjeti për shkak të marrëdhënies së dyshuar të njohjes apo miqësisë me shtetasin Xh.T.

60.7. Si pasojë e fakteve të sipërcituara, Komisioni ngriti dyshimin e arsyeshëm për lidhje jorastësore të subjektit të rivlerësimit me shtetasin Xh.T, i cili konsiderohet “kontakt i papërshtatshëm”, në kuptim të nenit 3, pika 15 e ligjit nr. 84/2016. Nga hetimi i kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar saktë deklaratën për kontrollin e

⁶⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 18.11.2021, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Shtetit; shkresë kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 18.11.2021, e DPSH-së.

⁶⁶ Shkresë nr. *** prot., datë 18.11.2021, drejtuar Ministrisë së Drejtësisë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 17.12.2021, e Ministrisë së Drejtësisë.

figurës, duke fshehur kontaktin e papërshtatshëm me shtetasin Xh.T, si person i përfshirë në krimin e organizuar. Bazuar mbi këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës.

60.8. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti ka prapësuar se kontakti me shtetasin Xh. T ka ndodhur në kushte krejt rastësore dhe normale. Ai ka cituar shpjegimet e dhëna gjatë hetimit, ndërsa në lidhje me tagrat e kontratës së huapërdorjes ai sqaron se *kjo kontratë është bërë pa afat të përcaktuar, për shkak se në momentin e nënshkrimit të saj subjekti nuk kishte përcaktuar nëse në Parga do të qëndronin 5 apo 10 ditë. Gjithashtu, për shkak të problematikës që mund të paraqisnin organet kufitare në shtetin grek, kontrata e huapërdorjes është bërë e përgjithshme, kontratë tip dhe pa specifikime të hollësishme.*

Subjekti kërkon që Komisioni të vlerësojë situatën, duke konsideruar faktin që marrëdhënia me shtetasin Xhevdet Troplini nuk ka qenë e vazhdueshme, automjeti është përdorur vetëm në një rast dhe ai nuk e ka pasur palë në gjykim këtë shtetas. Subjekti pretendon se këto elemente e vendosin në situatën e parashikuar nga neni 38, pika 5, germa “d” e ligjit nr. 84/2016.

60.9. Komisioni vlerëson se argumentet dhe sqarimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kontaktin e tij me shtetasin Xh.T nuk janë të mjaftueshme për të përmbysur rezultatet e hetimit dhe barrën e provës. Nga të dhënat e sistemit TIMS rezulton se shtetasi N.K nuk ka qenë në Shqipëri në datën që është nënshkruar kontrata e huapërdorjes, duke mbetur i pambështetur edhe pretendimi i subjektit se me marrjen me qira të automjetit është marrë ky shtetas.

60.10. Bazuar në analizën e provave dhe fakteve të parashtruara më lart, trupi gjykues arrin në përfundimin se:

i. Subjekti i rivlerësimit nuk ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi, në përgjigje të pyetjes të germave “c” dhe “e”, të pjesës nr. 5, të “shtojcës 3”, “Të dhëna për sigurinë”, të ligjit nr. 84/2016, pasi nuk ka deklaruar faktin se në vitin 2012 ka marrë në huapërdorje automjetin e një personi të përfshirë në krimin e organizuar, rrethanë e cila klasifikohet sipas nenit 38/4 të ligjit nr. 84/2016.

ii. subjekti i rivlerësimit, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 4 të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës së Shqipërisë, ka bërë deklarime të pasakta, duke fshehur fakte të ndodhura deri ditën e deklaramit, sipas nenit 39/2 të ligjit nr. 84/2016.

Në përmbledhje të sa më sipër, duke qenë se nga hetimi nuk rezultoi që subjekti të ketë patur kontakte të vazhdueshme me z. Xh.T, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklaramit për kontrollin e figurës, duke mos deklaruar fakte dhe rrethana të ndodhura para dorëzimit të këtij formulari. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka arritur një nivel të besueshëm për kriterin e figurës dhe, sipas nenit 59, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, do të vlerësohet në një vlerësim të përgjithshëm për të tria kriteret e procesit të rivlerësimit që është kryer ndaj tij.

C. VLERËSIMI PROFESIONAL

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- i) raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- ii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- iii) denoncimet e paraqitura pranë Komisionit.

61. Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe vlerësimi i Komisionit

61.1. Nga shqyrtimi i tri dokumenteve ligjore të paraqitur nga subjekti, Komisioni nuk konstatoi problematika.

61.2. Nga studimi i pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, Komisioni ka konstatuar problematikë vetëm në dosjen nr. 3.

61.3. Dosja nr. 3 i përket çështjes civile nr. (***) *** regjistri themeltar, datë 4.7.2013 regjistrimi, që ju përket palëve: paditësit F.M, kundër të paditurit Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Durrës, me objekt “kundërshtim i akteve administrative...”.

Çështja u depozitua në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës në datën 4.7.2013 dhe me shortin elektronik të zhvilluar në datën 5.7.2013 iu caktua për gjykim gjyqtarit Shpëtim Reka. Gjyqtari Reka, me vendimin e datës 11.7.2013, caktoi seancën përgatitore në datën 11.9.2013, ora 13:00. Me vendimin e datës 18.11.2013 subjekti i rivlerësimit ka vendosur “Pranimin e kërkesëpadisë së paditësit F.M”.

61.4. KLGJ-ja ka konstatuar se gjykimi i çështjes nga subjekti i rivlerësimit ka zgjatur 4 muaj e 13 ditë, në intervalin kohor 5.7.2013 – 18.11.2013, kohëzgjatje e cila është në shkelje të afatit standard 1-mujor, të përcaktuar nga pika 5, germa “c” e Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit.

Në lidhje me këtë konstatim, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime, i cili prapësoi se gjatë veprimeve përgatitore është konstatuar se natyra e mosmarrëveshjes nuk ishte vetëm administrative por edhe civile, që do të thotë se objekti i kërkesëpadisë kishte dy kërkime. Ai citon se nuk jemi vetëm në rastin e gjykimit administrativ, që ka të bëjë me anulimin e vendimeve, por edhe në gjykimin civil, që ka të bëjë me njohjen e vjetërsisë në punë. Sipas tij, shkelja e afatit 1-mujor nuk ka ardhur për faj të gjyqtarit të çështjes, por si rezultat i natyrës së mosmarrëveshjes, pasi shtyrja e seancave gjyqësore është bërë me kërkesën e vetë palës paditëse, duke kërkuar edhe marrjen e provës me dëshmitar, konform neneve 231 dhe 233/b të Kodit të Procedurës Civile, për zgjidhjen e pikës tjetër të objektit të padisë, atë civile. Subjekti mendon se në gjykimin e kësaj çështjeje është brenda afatit 6-mujor, duke e konsideruar jo si çështje administrative, por si gjykim i një çështjeje civile për shkak të objektit të gjykimit, ku është kërkuar edhe marrja e provës me dëshmitarë.

61.5. Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, si dhe aktet e dosjes gjyqësore, vlerëson se ato janë bindëse dhe, për rrjedhojë, në lidhje me dosjen nr. 3 konstaton se subjekti ka arritur të provojë bindshëm konstatimet e KLGJ-së në lidhje me afatin e shqyrtimit të kësaj çështjeje gjyqësore.

62. TË DHËNA NGA BURIME ARKIVORE TË KLGJ-së

62.1. Sipas të dhënave nga databaza e ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 – 8 tetor 2016”, për subjektin e rivlerësimit Shpëtim Reka janë paraqitur 9 ankesa (1 në vitin 2013, 1 në vitin 2014, 4 në vitin 2015 dhe 3 në vitin 2016) në Inspektoratin e ish-KLD-së.

Pesë ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit paraprak, me arsyetimin se 3 prej tyre (1 e vitit 2013, 1 e vitit 2014 dhe 1 e vitit 2015) zgjidhen përmes apelimit gjyqësor në gjykatat më të larta, 2 ankesa (1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) janë ankesa të përsëritura më parë.

Katër ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si më poshtë vijon:

- 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për mosrespektim formal të ligjit, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje;
- 1 ankesë e vitit 2015, verifikuar për shkelje etike, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje;
- 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për shkelje etike, është arkivuar pasi nuk rezultuan shkelje;
- 1 ankesë e vitit 2016, verifikuar për zvarritje gjykimi, mbajtur në vijim verifikim deri në përfundim të gjykimit në gjykatat më të larta.

62.2. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për subjektin e rivlerësimit Shpëtim Reka, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj tij të ketë ardhur ndonjë kërkesë për procedim disiplinor dhe të jetë dhënë ndonjë masë disiplinore nga ish-Këshilli i Lartë i Drejtësisë.

Denoncimet e publikut të depozituara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimi

63. Për subjektin e rivlerësimit janë administruar 21 denoncime të paraqitura në Komision, ku pas shqyrtimit të tyre i janë kërkuar shpjegime për denoncimin e mëposhtëm.

Denoncim i av. F.Gj⁶⁷

Denoncuesi pretendon se gjatë gjykimit të çështjes civile nr. *** subjekti i rivlerësimit ka vendosur mungesën e kompetencës dhe dërgimin e çështjes për kompetencë në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Durrës. Ai pretendon se mungesa e kompetencës është shpallur në seancë gjyqësore dhe jo gjatë veprimeve paraprake.

Komisioni ka administruar dosjen gjyqësore, nga e cila rezultoi se në datën 18.9.2018, në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës është regjistruar kërkesa me objekt “vërtetim i faktit të lindjes së kërkuarit S.C”. Në seancën gjyqësore të datës 30.10.2018 subjekti ka vendosur moskompetencën lëndore për shqyrtimin e kërkesës dhe dërgimin e akteve për kompetencë gjykimi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës.

Nga aktet e administruara rezultoi se vendimi për “mungesën e kompetencës” dhe dërgimi i çështjes për gjykim pranë gjykatës kompetente është kryer gjatë seancës gjyqësore, në kundërshtim me përcaktimet e nenit 158/a të Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilit mungesa e kompetencës dhe juridiksionit vendoset gjatë veprimeve paraprake. Lidhur me këtë konstatim, subjektit iu kërkuar shpjegime.

Në prapësimet e tij, subjekti sqaroi se: *“Me shortin elektronik të datës 19.9.2018 është shortuar çështja civile nr. ***, datë 19.9.2018, me palë ndërgjyqëse, paditës S.Ç dhe palë e paditur Zyra e Gjendjes Civile, Nënprefektura Kavajë, me objekt ‘vërtetim fakti të lindjes së paditësit S. Ç’. Nga shortimi i kësaj çështjeje, për gjykimin e saj jam caktuar unë Shpëtim Reka. Me marrjen e dosjes nga ana ime është dhënë urdhër për caktimin e seancës përgatitore në datën 30.10.2018, për të sqaruar natyrën e mosmarrëveshjes, si dhe përcaktimin e provave. Në seancën e veprimeve përgatitore është mbajtur edhe procesverbali përkatës, ku me vendim kam përcaktuar moskompetencën lëndore për shqyrtimin e kësaj çështjeje, duke ia dërguar për kompetencë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Durrës, në referim të neneve 41, 61 e 62 të Kodit të Procedurës Civile”.*

Subjekti ka paraqitur akte të dosjes gjyqësore, sipas të cilave rezultoi se përmes urdhrit “për caktimin e seancës përgatitore”, datë 5.10.2008, subjekti ka vendosur të thërrasë palët në seancë përgatitore për sqarimin e natyrës së mosmarrëveshjes dhe përcaktimin e provave. Më tej, me vendimin datë 30.10.2008, subjekti ka vendosur moskompetencën lëndore në shqyrtimin e kërkesëpadsë. Aktet e paraqitura nga subjekti nuk gjenden në dosjen gjyqësore të vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës. Në dosjen e paraqitur nga gjykata gjendet vendimi gjyqësor i panënshkruar nga subjekti i rivlerësimit (por i pajisur me vulë të gjykatës), sipas së cilit shqyrtimi i kërkesës është bërë në “seancë gjyqësore” dhe jo në “seancë përgatitore”.

Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit janë bindëse dhe se ai ka vepruar në përputhje me përcaktimet e nenit 158/a të Kodit të Procedurës Civile.

64. Konstatime të tjera

⁶⁷ Denoncimet nr. *** prot., datë 2.11.2018, dhe nr. *** prot., datë 7.11.2018.

64.1. Bazuar në hetimin e kryer nga Komisioni për kriterin e pasurisë, ka rezultuar se gjatë ushtrimit të detyrës së tij, subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje gjyqësore në kushtet e konfliktit të interesit, si më poshtë vijon:

i. Gjykimi i çështjes gjyqësore me kërkues shoqërinë “I.K” sh.p.k., me objekt “lëshimin e urdhrin të ekzekutimit” për vendimin nr. ***, trajtuar në pikat 27.10 – 27.14 të këtij vendimi.

ii. Nga të dhënat e sistemit TIMS ka rezultuar se në datat 21.11.2011 dhe 27.9.2015 subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar së bashku me shtetasin R.K, administrator i shoqërisë “K” sh.p.k., me automjetet me targa AA *** AL dhe AA *** CU, të regjistruar në pronësi të këtij shtetasi.

Sipas informacionit të administruar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar 7 (shtatë) çështje gjyqësore me shtetasin R.K. Nga shqyrtimi i dokumentacionit që lidhet me këto gjykime ka rezultuar se në datat e udhëtimeve të kryera nga subjekti këtë shtetas ai ka pasur në shqyrtim e sipër çështjet gjyqësore të mëposhtme:

- a) Çështjen gjyqësore me paditës shoqërinë “K” sh.p.k., të paditur “Z.g F.K.T” sh.a., me objekt “detyrimi i të paditurit t’i paguajë paditësit shumën 60,000 dollarë amerikanë dhe marrjen e masës për sigurimin e padisë, duke bllokuar anijen e të paditurit”, regjistruar në datën 23.3.2011. Me vendimin datë 1.12.2011, subjekti i rivlerësimit ka vendosur “pushimin e gjykimit”, për shkak se paditësi nuk është paraqitur në seancë gjyqësore.
- b) Çështjen gjyqësore me paditës A, L e Y.K dhe të paditur shoqërinë “K” sh.p.k., me objekt “detyrimin e të paditurit të dorëzojë pasuritë e përcaktuara në kontratën e sipërmarrjes, të kryejë regjistrimin e tyre në regjistrat hipotekorë në emër të paditësve etj.”, regjistruar në datën 5.11.2014. Në këtë gjykim subjekti ka pasur cilësinë e kryesuesit të trupës gjyqësore, e cila, me vendimin datë 10.3.2017, ka vendosur “rrezimin e kërkesëpadisë” si të pambështetur në prova dhe në ligj. Ky vendim rezulton të jetë prishur nga Gjykata e Apelit Durrës.

64.2. Faktet e administruara gjatë hetimit tregojnë për një marrëdhënie shoqërore mes subjektit të rivlerësimit dhe shtetasit R.K, e cila ndikon, mund të ndikojë, ose duket sikur ndikon në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të subjektit. Si rrjedhojë e këtyre konstatimeve, duket se subjekti i rivlerësimit ka gjykuar çështje gjyqësore në kushtet e konfliktit të interesit, parashikuar nga neni 3, pika 1 e ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, si dhe në kushtet e konfliktit të interesit të parashikuar nga neni 72 i Kodit të Procedurës Civile.

64.3. Lidhur me këtë konstatim, Komisioni i ka kaluar subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

64.4. Në prapësimet e tij, subjekti ka shpjeguar se në lidhje me njohjen dhe gjykimet me shtetasin R. K ka pretenduar: *“Për shkak të përkatësisë time si qytetar i Durrësit, me këtë shtetas kam njohje po aq sa edhe me qindra qytetarë të tjerë durrsakë. Me z. K nuk kam marrëdhënie shoqërore dhe as familjare. Subjekti ‘K’ sh.p.k., ose R.K, ka zhvilluar gjithsej 137 gjykime në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, prej të cilave unë si pjesë e trupës gjyqësore kam gjykuar vetëm 7 prej tyre. Në bazë të shkresës së datës 2.11.2021, e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, rezulton se të gjitha gjykimet e zhvilluara prej meje i përkasin shoqërisë ‘K’ dhe jo shtetasit konkret R.K. Udhëtimet e rastësishme me shtetasin R. K nuk kanë ndikuar aspak në vendimmarrjet e mia*

Nga ana e Komisionit është vlerësuar se, unë në gjykimin e Çështjes gjyqësore me paditës shoqërinë “K” shpk, të paditur “Z.g.F.K.T” sh.a, me objekt “Detyrimi i të paditurit t’i paguaj paditësit shumën prej 60,000 dollarë amerikanë dhe marrjen e masës për sigurimin e padisë” regjistruar më datë 23.03.2011 kam gjykuar në kushtet e konfliktit të interesit për shkak se kam udhëtuar më këtë shtetas në datën 21.11.2021. Gjithashtu komisioni ka konstatuar se për këtë

çështje civile, me Vendimin datë 01.12.2011 unë kam vendosur “pushimin e gjykimit” për shkak se paditësi nuk është paraqitur në seancë gjyqësore.

Dua të sqaroj se vendimmarja e mësipërme është e mbështetur në nenin 179 të K.Pr.Civile dhe se vendimi i pushimit të gjykimit është vendim që nuk ka sjellë asnjë pasojë për palët. Ky vendim prezumon se padia nuk është paraqitur dhe nuk mund të konsiderohet si gjykim në favor të asnjërës prej palëve pasi mosparaqitja e palës në gjykim passjell domosdoshmërisht pushimin e gjykimit. Pushimi i gjykimit sjell si pasojë anulimin e të gjitha veprimeve procedurale, duke përfshirë edhe vendimet që jepen gjatë gjykimit. . . neni 300 i K.Pr.Civile.Edhe në rastin konkret, ndonëse unë kam udhëtuar së bashku me shtetasin R.K, në mënyrë të rastësishme, kjo nuk ka ndikuar aspak në vendimarrjen apo anësinë në dhënien e vendimit dhe për më tepër nuk mund të konsiderohet aspak si vendimarrje në favor të paditësit, shoqërisë “Kërçuku”shpk... Në datën 27.9.2015 kam udhëtuar me këtë shtetas nga Prizreni në Kukës. Unë kisha shkuar në Prizren së bashku me shtetasin A.L, të cilin e kam shok prej vitesh. Kur kam qenë atje, fëmijët më kanë njoftuar në telefon se bashkëshortja ishte e sëmurë (me probleme të pankreasit) dhe për këtë shkak jam detyruar të kthehem menjëherë. Jam kthyer deri në një pjesë të rrugës me shtetasin R.K, të cilin e pamë rastësisht në pikën e kalimit të kufirit në Prizren. Rrugës, pranë Kukësit, më ka dalë përpara i fejuari i vajzës me automjetin e tij dhe jemi kthyer menjëherë në Durrës”.

64.5. Subjekti i ka bashkëlidhur shpjegimeve të tij: (i) të dhëna nga sistemi i menaxhimit të çështjeve gjyqësore; (ii) dokumente shëndetësore të bashkëshortes F. R; (iii) deklaratë noteriale nr. ***, datë 20.2.2022, nga shtetasi A. L; si dhe (iv) vendim gjykate nr. ***, datë 4.10.2021 (nga sistemi).

64.6. Në analizë të parashtrimeve, Komisioni vlerëson se në rastin e shqyrtimit të kërkesës për “lëshimin e urdhrit të ekzekutimit” ndaj shoqërisë “I.K” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit ka gjykuar duke qenë në konflikt interesi, bazuar në faktin se ka qenë ende debitor për shlyerjen e plotë të çmimit të pasurisë së tij “apartament” ndaj kësaj shoqërie. Gjithashtu, gjendja e konfliktit të interesit përforcohet nga fakti se objekti i gjykimit të çështjes së themelit të këtij “urdhër ekzekutimi” ka qenë objekti i banimit ku ndodhej pasuria e blerë nga vetë subjekti i rivlerësimit.

64.7. Në lidhje me gjendjen e “konfliktit të interesit” lidhur me gjykimet e çështjeve me palë ndërgjyqëse shoqërinë “K” sh.p.k., apo z. R.K, Komisioni konstaton se norma e zbatueshme për rastin konkret është neni 72, pika 6 e Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilës: “Gjyqtari është i detyruar të heqë dorë nga gjykimi i një çështje konkrete kur [...] në çdo rast tjetër kur vërtetohen arsye serioze njëanshmërie”. Në rrethanat konkrete të rastit, sipas vlerësimit të Komisionit, subjekti ishte i detyruar, për shkak të parashikimeve ligjore, të hiqte dorë nga gjykimi i çështjeve në fjalë, me qëllim shmangien e një situatë të konfliktit të interesit, duke qenë se mes tij dhe shtetasit R.K ekzistonte një marrëdhënie njohjeje, e cila mund të konsiderohej se do të ndikonte në vendimarrjet e subjektit. Për më tepër subjekti në dy raste ka udhëtuar me z. K ndërkohë që kishte në gjykim ccështje me palë ndërgjyqëse shoqërinë e këtij shtetasi.

64.8. Në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave të rezultuara gjatë hetimit në raport edhe me shpjegimet e subjektit, si dhe në referencë edhe të praktikës së Kolegjit të Posaçëm të Apelitit, trupi gjykues çmon se tërësia e veprimeve të subjektit të rivlerësimit tregojnë një raport të tillë të përkujdesjes së subjektit me zbatimin e ligjit, i cili është i papranueshëm për të pasur besimin e publikut. Rëndësia e sjelljes jashtëgjyqësore të gjyqtarit dhe ndikimi i saj në besimin e publikut te sistemi i drejtësisë është objekt rregullimi i normave të etikës gjyqësore në Shqipëri dhe pjesë e standardeve ndërkombëtare për sjelljen e gjyqtarëve.

64.9. Në vlerësim të rrethanave të sipërcituara, trupi gjykues vlerëson se këto rrethana janë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit,

e cila duhet të jetë pjesë e vlerësimit tërësor të procedurave, sipas parashikimit të paragrafit 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoji subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti në përgjigje të pyetësorëve, konkludon se në një analizë të përgjithshme të të gjitha konkluzioneve të arritura e të arsyetuara në vendim, subjekti dhe personat e lidhur me të jo vetëm kanë disponuar e gëzuar pasuri të cilat rezultojnë me problematika në drejtim të legjitimitetit të burimeve të tyre, por edhe ka rezultuar se subjekti gjendet në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe nuk ka plotësuar në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, duke mos deklaruar faktin që i ka marrë në huapërdorje automjetin shtetasit Xh.T. Në këtë këndvështrim, Komisioni, nga vlerësimi tërësor, në

kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, vlerëson se përgjatë ushtrimit të detyrës së tij si gjyqtar subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, duke u plotësuar kushtet dhe rrethanat për zbatimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Branko Hrvatin, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “c”, si dhe në nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Shpëtim Reka, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 25.2.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Lulzim HAMITAJ
Kryesues

Alma FASKAJ
Anëtare

Genta Tafa (BUNGO)
Relatore

Sekretare gjyqësore
Etmonda Hoxha